



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRI PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATEN PUBLIKE



Ky projekt financohet nga BE



TRAJNIMI PËR TRUPËN E NIVELIT TË LARTË DREJTUES

KATALOGU I TRAJNIMIT TË ASPA-S



TIRANË, SHQIPËRI



TRAJNIMI PËR TRUPËN E NIVELIT TË LARTË DREJTUES

KATALOGU I TRAJNIMIT TË ASPA-S

TIRANË, SHQIPËRI

"Ky publikim është realizuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e autoriteteve zbatuese dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian."



Autorët e këtij katalogu janë nëpunës civilë të administratës publike franceze dhe polake. Përfshirja e tyre u realizua në kuadër të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje në Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri”, projekt i zbatuar nga Shkolla Kombëtare Franceze e Administratës Publike (ENA), Shkolla Kombëtare Italiane e Administratës Publike (SNA) dhe Departamenti i Administratës Publike (DAP).

Autori kryesor:

• **Zj. Anne Azam-Pradeilles**

Me kontributin e:

- Zj. Aleksandra Kowalik
- Z. Jean-Michel Eymeri Douzans
- Zj. Violeta Moskalu
- Z. Pavel Ivanov
- Z. Jacques Skowron

Ky katalog u financua nga Bashkimi Evropian përmes projektit të binjakëzimit “Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil”

Për informacion mbi Bashkimin Evropian ju lutem vizitoni: <http://ec.europa.eu>.

TABLE OF CONTENTS

Parathënie	6
Lista e akronimeve dhe shkurtimeve	8
Hyrje	10
Kurrikula dhe modulet për TND-në	12
Nga Strategjia Kombëtare RAP 2015-2020 tek Moduli i Trajnimit për TND-të	14
Një kalendar i përkohshëm i planit të trajnimit për TND-të	15
Metodologjia e trajnimit të TND-ve	17
MODULI TND1: POLITIKAT E BE-SË DHE ÇËSHTJET NDËRKOMBËTARE	18
• TND1.1 Marrëdhëniet ndërkombëtare "klasike": Organizatat ndërkombëtare dhe negociatat	19
• TND1.2 Institucionet dhe qeverisja e BE-së	20
• TND1.3 Politikat e BE-së	22
• TND1.4 Menaxhimi i çështjeve të BE-së dhe koordinimi i brendshëm	23
• TND1.5 Ligji administrativ i BE-së	24
• TND1.6 Menaxhimi i fondeve të BE-së	25
TND2 PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE FORMULIMI I POLITIKAVE	27
• TND2.1 Prioritetet e Qeverisë	28
• TND2.2 Planifikimi strategjik	29
• TND2.3 Menaxhimi i ciklit të politikave	30
• TND2.4 Menaxhimi institucional	32
TND3 KOMPETENCAT PËR MENAXHIMIN STRATEGJIK DHE ORGANIZACIONAL	33
• TND3.1 Menaxhimi i burimeve njerëzore	34
• TND3.2 Udhëheqja	36
• TND3.3 Menaxhimi i komunikimit dhe informacionit, marrëdhëniet me publikun	37
• TND3.4 Menaxhimi i Ndryshimit	38
• TMC3.5 Menaxhimi i Krizës	40
• TND3.6 Kompetencat Personale	41

TMC4 ÇËSHËTJET E FINANCAVE PUBLIKE	42
• TND4.1 Menaxhimi i Financave Publike	45
• TND4.2 Prokurimi Publik	47
• TMC4.3 Partneriteti Publik Privat (PPP)	49
TMC5 INOVACIONI I ADMINISTRATËS	51
• TND5.1 Qeverisja Elektronike	52
• TND5.2 Siguria në lidhje me Teknologjinë e Informacionit	54
• TMC5.3 Mbrojtja e të Dhënave	55
SHTOJCAT:	56
Shtojca 1: Kuadri institucional dhe ligjor i trajnimit të TND	57
Shtojca 2: Struktura e Kompetencave për Nivelin 5 apo TND	61
Shtojca 3: Një rast studimor mbi metodologjinë bazuar në raste reale	65
Shtojca 4: Raporti i OSBE-së mbi trajnimin anti-korrupsion për AP	68
Shtojca 5: Lexime të mëtejshme mbi monitorimin dhe zhvillimin në karrierë	70
Shtojca 6: Raporti PNUD 2016- Integrimi Gjiner dhe Trajnimi i TND-ve	71
Shtojca 7: Kapitujt e acquis të BE-së	76

PARATHËNIE

Marrja e statusit të vendit kandidat të Shqipërisë në 24 Qershor, 2014 nga Këshilli Evropian bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian, shënon një hap të rëndësishëm në procesin e integritimit evropian të vendit. Për këtë arsye, forcimi i kapaciteteve të përgjithshme të administratës shqiptare përmes modernizimit të administratës publike dhe forcimit të institucioneve kryesore është prioritet si për qeverinë ashtu edhe për procesin e zgjerimit të BE-së.

Për të mbështetur forcimin e kapaciteteve të administratës, Shqipëria miratoi ligjin për shërbimin civil (Nr. 152/2013, i ndryshuar), i cili përbën kuadrin ligjor për themelimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP), veprimtaria e të cilës është në vazhdimësi të Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) i krijuar nga parashikimet e ligjit të vitit 1999.

Ligji i shërbimit civil i jep ASPA-s autonomi administrative dhe akademike. Qëllimi i saj është trajnimi profesional i nëpunësve civilë. Ajo bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike, i cili është institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore të shërbimit civil. Ajo ofron trajnim fillestar për nëpunësit civilë të cilët kanë hyrë rishtazi në shërbimin civil dhe trajnim profesional të vazhduar për nëpunësit civilë dhe për individë jashtë shërbimit civil.

Ligji i shërbimit civil parashikon një program trajnimi të thelluar për kandidatët e kategorisë të nivelit të lartë drejtues (TND), i cili përmban 280 orë trajnimi të shtrirë në një periudhë 6 mujore. Për anëtarët e TND-

së të rekrutuar në bazë të nenit 28 dhe 29 të ligjit 152/2013, programi i trajnimit është i detyrueshëm dhe pa pagesë. Në fund të programit, të trajnuarit testohen për njohuritë e përfutuara.

Qëllimi i këtij katalogu është prezantimi i kursit të trajnimit për TND. Kursi është ndarë në 5 module, si vijon:

1. Politikat e BE-së dhe çështjet ndërkombëtare;
2. Planifikimi strategjik dhe formulimi i politikave;
3. Kompetencat për menaxhimin strategjik dhe organizues të burimeve njerëzore;
4. Çështjet e financave publike;
5. Inovacioni në administratë.

Secili modul do të zhvillohet në 3-6 seanca trajnimi 1.5 ditësh. Trajnimet do të zhvillohen në fundjavë duke filluar të premtën pasdite dhe të shtunën gjithë ditën, përgjatë një periudhe 6 mujore.

Disa seanca trajnimi me zgjedhje mund të organizohen për të mbështetur politikat e Qeverisë Shqiptare të ndërmarra në kuadrin e procesit të anëtarësimit në BE. Gjithashtu, trajnime shtesë mund të organizohen në bazë të nevojave për trajnim dhe për të përmirësuar aftësitë në gjuhët e huaja apo kompjuterike. Me vlerë për trajnimin e TND-ve mund të jenë edhe vizita studimore në vendet anëtare apo ato që aderojnë për anëtarësim. Për të realizuar këto vizita studimore mund të përdoret instrumenti TAIEX i BE-së. Nëse është e mundur, disa module mund të zhvillohen edhe jashtë Tiranës. Temat e ndërlidhura si ato të barazisë gjinore¹ dhe mjedisit do të merren në konsideratë e trajtohen në module të ndryshme sa herë që lind nevoja.

¹Aneksi 6: Ekstrakt nga Raporti I PNUD «Integrimi Gjinor në Projekt- Programin e Trajnimit të ASPA-s të TND- ve», Qershor 2016

Për më tepër, ASPA është anëtare e ReSPA-s² (Shkolla Rajonale e Administratës Publike), një rrjet i shkollave të administratës publike që synon të mbështesë krijimin e një sistemi të administratës publike të përgjegjshëm, efektiv dhe profesional për ato vende të Ballkanit perëndimor që janë drejt rrugës së aderimit në BE. ReSPA organizon dhe zhvillon aktivitete trajnuese, konferenca të nivelit të lartë, aktivitete bashkëpunimi dhe publikime me synim të transferojë njohuri dhe aftësi të reja si dhe të lehtësojë shkëmbimin e përvojës si brenda rajonit ashtu edhe në vendet anëtare të BE-së. Në këtë këndvështrim, TND-të mund të përfitojnë nga aktivitetet e ReSPA-s.

Në Strategjinë Ndër-sektoriale të Reformës në Administratën Publike (RAP) 2015-2020³ citohet:

“Në vitin 2013, SIGMA ka publikuar një dokument, i cili identifikon si prioritetet të reformës për administratën publike në Shqipëri deri në vitin 2020, pikat si vijon: zhvillimi i kapaciteteve për hartimin politikave dhe legjislacionit në mënyrë që të hartohen dhe zbatohen politika efektive dhe në përputhje me acquis; institucione efçente dhe efikase; shërbim civil profesional që siguron ligjshmërinë dhe parashikueshmërinë e administratës, pavarësinë dhe paanësinë e akteve, që ndihmon në harmonizimin e legjislacionit me acquis dhe zbatimin e tij; krijimi i strukturave adekuate për zbatimin e procedurave administrative dhe i strukturave të përshtatshme që sigurojnë përgjegjshmërinë administrative dhe politike të administratës.”⁴

Ky katalog synon të kontribuojë në arritjen e objektivave të mësipërm të Strategjisë RAP duke u ofruar nëpunësve civilë të nivelit të lartë një mundësi për të forcuar kapacitetet e tyre menaxheriale në të gjitha

fushat administrative të nevojshme në procesin e aderimit në BE, proces në të cilin TND-të do të jenë aktorët kryesorë. Për të arritur këtë synim ASPA do të mbështetet në përvojën akademike dhe profesionale të trajnerëve më të mirë dhe do të organizojë trajnim të trajnerëve me synim inkurajimin e punës në grup, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe rasteve studimore.

Ky program trajnimi për TND-të do të pilotohet vitin e parë të zbatimit dhe do të shërbejë për të përcaktuar indikatorët bazë për vitet në vijim. Në fund të pilotimit do të bëhet një vlerësim dhe mësimet e nxjerra nga viti i parë do të reflektohen në hartimin e programit në vazhdimësi. Ndikimi në cilësinë e ofrimit të shërbimit do të matet gjithashtu në vitet në vijim.

I urojmë gjithë anëtareve të TND-së suksese në kryerjen e këtij kursi dhe i falënderojmë për pjesëmarrjen në këtë 'aventurë' të rëndësishme për modernizimin e vendit dhe aderimin e suksesshëm në BE.

Fatmir DEMNERI
Drejtor i ASPA-s

² <http://www.respaweb.eu/>

³ Dokumenti mund të gjendet në: http://www.sigmaweb.org/publications/Albania_Priorities_2013.pdf

⁴ http://dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/PAR_Strategy_2015-2020_English.pdf

Lista e akronimeve dhe shkurtimeve

Akronimi	Emri i plotë
AB	Auditi i Brendshëm
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BNJ	Burimet Njerëzore
CeP	Konferenca e Palëve (CeP 21 Paris, CeP 22 Marrakech)
DAP	Departamenti i Administratës Publike
FEZHR	Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FP	Financat Publike
FSE	Fondi Social Evropian
GJDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
GJED	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës

Akronimi	Emri i plotë
IPA	Instrumentet e Para-anëtarësimit
IPEF	Instrumentet e Politikës Evropiane të Fqinjësisë
IT	Teknologjia e Informacionit
ITAP	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
KKBNK	Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
LBO	Ligji për Buxhetin Organik
LDB	Lufta e Dytë Botërore
LPB	Lufta e Parë Botërore
LSHC	Ligji për Shërbimin Civil
MBNJ	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MPTT	Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë dhe Tarifat
MRP	Menaxhimi i Ri Publik

Lista e akronimeve dhe shkurtimeve

Akronimi	Emri i plotë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OBU	Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit
OBZHE	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PEF	Politika Evropiane e Fqinjësisë
PKK	Pika Kombëtare e Kontaktit
PP	Prokurimi Publik
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore
PPJS	Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë
PPP	Partneriteti Privat Publik
PPSM	Politika e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen
PPT	PowerPoint

Akronimi	Emri i plotë
PRAG	Udhëzues Praktik për Procedurat Kontraktuese për Veprimet e Jashtme të BE-së
PVT	Plani i Veprimit për Trajnim
RAP	Reforma në Administratën Publike
SIGMA	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020
SWOT	Pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë, rreziqet
TAIEX	Instrumenti i Asistencës Teknike për Shkëmbim Informacioni
TNA	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
TND	Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues
ToT	Trajnim i Trajnerëve
UNDP	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Kombet e Bashkuara
VA	Vendet Anëtare
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNT	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim

HYRJE

Konteksti dhe problematika

Bazuar në aktet nënligjore për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka përgjegjësinë e hartimit, zhvillimit dhe zbatimit të një program trajnimi të posaçëm dhe me cilësi dedikuar trupës së nivelit të lartë drejtues, të cilët aktualisht i përkasin apo dëshirojnë t'i bashkohen TND-së të sapo krijuar.

Trupa e TND-së shqiptare përmban *“Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore që ka përgjegjësinë për formulimin e politikave dhe këshillimin rreth tyre; që përcakton objektivat dhe formulon programet, standardet dhe procedurat përkatëse për zbatimin; që siguron përdorimin efikas të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe arrijten e objektivave; që planifikon dhe drejton veprimtarinë e përditshme administrative të institucionit dhe përfaqëson atë në takime dhe forume brenda dhe jashtë vendit”*⁵.

Sipas kuadrit ligjor aktual, pozicionet e nivelit të lartë drejtues klasifikohen si më poshtë⁶:

Klasa I/1:	Klasa I/2:	Klasa I/3:
Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Ministrave, Presidencë, Kuvend dhe institucione kushtetuese të pavarura.	Sekretar i Përgjithshëm në ministritë e linjës, institucionet e pavarura të krijuara me ligj, njësitë e qeverisjes vendore/ drejtor departamenti/ titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrive të linjës.	Sekretar i Përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore, drejtor i Drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, ministritë e linjës, institucionet e pavarura të krijuara me ligj, njësitë e qeverisjes vendore/ titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës.

Pranimi në programin e formimit të thelluar për TND në ASPA bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, i cili është i hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese dhe të nivelit të lartë drejtues, në institucionet e pavarura dhe që përbëjnë jo më pak se 80% të pranimeve si dhe çdo individ tjetër, që nuk është pjesë e shërbimit civil dhe që plotëson kërkesat specifike për pranimin në TND dhe që përbëjnë deri në 20% të pranimeve

Në këtë kontekst, ndryshimet politike apo qarkullimi i stafit në pozicionet e TND-së kushtëzojnë parashikimin e madhësisë së grupit për tu trajnuar në këtë program të ASPA-s. Faza e pilotimit mund të adresojë vetëm ata kandidatë që kanë nisur procedurën e ngritjes në detyrë.

Kohëzgjatja e programit të trajnimit për TND-të është parashikuar nga aktet nënligjore: 280 orë trajnimi për një periudhë kohore 6 muaj, duke përfshirë testimin e të trajnuarve në fund të trajnimit. Certifikimi i pjesëmarrësve në këtë program trajnimi është i bazuar në pjesëmarrjen dhe rezultatin e testimit përfundimtar. Duke marrë në konsideratë nivelin e përgjegjësisë si dhe përkushtimin profesional të vazhdueshëm që kërkohet në këtë program, puna e parashikuar për pjesëmarrësit në këtë kurs është shumë ambicioze.

⁵ Vendimi Nr. 262, datë 25.3.2015 për disa ndryshime të Vendimit e Këshillit të Ministrave Nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

⁶ Vendimi Nr.142, datë 12.3.2014 i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

Në këtë kuadër, plani i trajnimit të ASPA-s synon t'i japë përgjigje çështjes së kompetencave kryesore të kërkuara për një pozicion drejtimi të nivelit të lartë:

Njohuri	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kupton gjerësisht kompetencat ndër- sektoriale; ➤ Njohuri të fenomeneve ekonomike dhe sociale; ➤ Njohuri të sistemit ligjor evropian.
Aftësi	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Aftësi të drejtë dhe menaxhojnë një gamë të gjerë veprimesh; ➤ Aftësi komunikimi; ➤ Aftësi të menaxhimit strategjik; ➤ Ndërtimi i marrëdhënieve ndër-personale; ➤ Atësi për të punuar në grup; ➤ Të jetë efektive.
Karakter	<ul style="list-style-type: none"> ➤ I besueshëm; ➤ Vizionar; ➤ Krijues; ➤ Me integritet.

Bazuar në eksperiencën e mëparshme të ASPA-s, zhvillimi i seancave të trajnimit çdo fundjavë për një kohëzgjatje 6 mujore duke zhvilluar trajnimin për 3 orë ditën e premte dhe 6 orëve të shtunën (280 orë të kërkuara trajnimi), do të jetë sfidë. Për të lehtësuar këtë proces do të zhvillohen klasa në distancë, përmes metodave inovative të mësimin përmes internetit (e-learning), të ndërthurura me seancat e trajnimit në klasë. Për të forcuar bashkëpunimin në grup, pjesëmarrësve do t'u kërkohet të sjellin për diskutim raste aktuale nga përvoja e përditshme e tyre. Metoda e simulimit gjithashtu do të ndihmojë në diversifikimin e kontributit përmes shkëmbimit të njohurive dhe aftësive praktike, duke sjellë gjallëri në seancat e trajnimit.

Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit "Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri", i financuar nga programet IPA të BE-së, u krye një Vlerësimi i Nevojave për Trajnim i zyrtarëve shqiptarë të nivelit drejtues, veçanërisht për temat e nën-modulit TND1. Nevojat e identifikuar ishin:

Zgjedhja e një grupi të mirë trajnerësh, veçanërisht ekspertë shqiptarë dhe të huaj me njohuri mbi çështjet e BE-së, për të garantuar cilësinë e trajnimit dhe për të siguruar legjitimitetin e trajnimit te zyrtarët e nivelit të lartë;

Teknika pedagogjike inovative dhe ndër-aktive me theks tek përfshirja aktive e pjesëmarrësve përmes seancave "brainstorming", punës në grup, studimet e rastit, simulimeve, dhe nëse është e mundur, vizitave studimore (përmes instrumenteve TAIEX të BE-së);

Duke qenë se ekspertët e rinj dhe zyrtarët e nivelit të mesëm mund të kenë më shume njohuri mbi çështjet e BE-së dhe problemet e lidhura me procesin e aderimit krahasuar me zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, kursi për TND do të synojë rritjen e njohurive mbi BE-në;

TND-të e komanduar mund të mos jenë plotësisht në dijeni për kriteret e procesit të aderimit dhe vështirësive të mundshme që mund të dalin: "rregullat e lojës" duhet të prezantohen sidomos përmes shkëmbimit të përvojës me vendet anëtare që kanë praktikant më të mira, si p.sh. Kroacia;

TND-të duhet të familjarizohen me fjalorin specifik të përdorur nga delegacionet dhe ekspertët e BE-së ("Eurospeak", akronimet, etj.); do të vlerësohet zotërimi i gjuhëve të huaja dhe nevoja për përmirësim, veçanërisht në anglisht, gjuha "globale" dhe frëngjisht, gjuha për çështjet ligjore dhe jetën e përditshme në Bruksel;

E fundit, por jo për nga rëndësia, aftësitë administrative dhe kompetencat e TND-ve në përbërjen e sukses të bashkëpunimit ndërministror midis ministrive shqiptare dhe institucioneve të tjera, në veçanti 35 gupet e punës që do të përfshihen në negociatat e kapitujve të *acquis* janë thelbësore dhe duhen adresuar.

Prezantimi i përgjithshëm i Planit të Trajnimit për TND-të, tani i plotësuar dhe me disa dokumente dhe kontribute të rëndësishme, ofron një perspektivë globale të re për trajnim. Trajnimi i TND-ve është kusht për zhvillimin e suksesshëm të procesit të anëtarësimit në BE. Cikli i plotë i trajnimit duhet të jetë shumë i qartë dhe i mirë-strukturuar, duke lejuar një shkallë fleksibiliteti për ndryshime pedagogjike, nëse lind nevoja.

Konteksti dhe sfondi shqiptar: nga analiza SWOT dhe vlerësimi i nevojave për trajnim tek korniza e kompetencave të OBZHE

1. Analiza SWOT për Administratën Publike Shqiptare, Shërbimin Civil dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)
2. Vlerësimi i Nevojave për Trajnim të TND-ve
3. Korniza e kompetencave për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND)

Nga Strategjia Kombëtare për Reformën në Administratën Publike, Plani i Veprimit dhe Buxheti, te Plani i Veprimit për Trajnimin e TND-ve

1. Strategjia Ndër- sektoriale RAP 2015 – 2020
2. Plani i Veprimit dhe Treguesit e RAP
3. Buxheti i Planit të Veprimit të RAP
4. Plani paraprak i trajnimit për TND-të
5. Plani paraprak i veprimit për trajnimin e TND-ve
6. Buxheti paraprak i planit të veprimit për trajnim

Zbatimi i planit të veprimit për trajnim nga ASPA për TND-të

1. 5 Module Trajnimi për TND-të
2. Metodologjia e Trajnimit
3. Raste studimore

KURRIKULA DHE MODULET PËR TND-NË

1. TND₁ Politikat e BE-së dhe çështjet ndërkombëtare

1. Marrëdhëniet ndërkombëtare: Organizatat ndërkombëtare dhe negociatat
2. Institucionet dhe qeverisja e BE-së
3. Politikat e BE-së
4. Menaxhimi i çështjeve të BE-së dhe koordinimi i brendshëm
5. Ligji administrativ i BE-së
6. Menaxhimi i fondeve të BE-së dhe përthithja e fondeve strukturore të BE-së nga vendet e reja anëtare

2. TND₂ Planifikimi strategjik dhe formulimi i politikave

1. Prioritetet e qeverisë
2. Planifikimi strategjik
3. Menaxhimi i ciklit të politikave
4. Menaxhimi institucional

3. TND₃ Kompetencat për menaxhimin strategjik dhe organizativ

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore
2. Udhëheqja (lidhshipi)
3. Menaxhimi i komunikimit dhe informacionit, marrëdhëniet me publikun
4. Menaxhimi i ndryshimit
5. Menaxhimi i krizave
6. Kompetencat personale

4. TND4 Çështjet e financave publike

1. Menaxhimi i financave publike
2. Prokurimi publik
3. Partneriteti Publik Privat (PPP)

5. TNDs Inovacioni në administratë

1. Qeverisja Elektronike
2. Siguria e IT- së
3. Mbrojtja e të dhënave (atyre personale dhe më gjerë)

Skema e zbatimit të 5 moduleve të trajnimit: 280 orë brenda periudhës 6 mujore ose 26 javësh

TND1 dhe TND3 kanë 6 nën- module dhe zgjasin 9 ditë ose 6 fundjava.
TND2 ka 4 nën- module dhe zgjat 9 ditë ose 6 fundjava.
TND4 ka 3 nën- module dhe zgjat 7.5 ditë ose 5 fundjava.
TND5 ka 3 nën- module dhe zgjat 4.5 ditë ose 3 fundjava.

Secili modul i katalogut do të përmbajë një prezantim të përgjithshëm të modulit dhe një fishë 1-faqëshe për secilin nën-modul. **Mesatarisht secili modul është i bazuar në sesione trajnimi një ditë e gjysmë, i shtrirë në fundjavë: e premte pasdite 3 orë dhe e shtunë 6 orë, 3 orë paradite dhe 3 orë pasdite.** Shtrirja standarde e kohëzgjatjes për secilin modul është 3 segmente, 3 orë secili bazuar në një kalendar të detajuar nga ASPA.

Testimit dhe vlerësimit të progresit të arritur do t'i caktohet kohë shtesë.


Disa nën-module mund të ofrohen në distancë (e-learning). Do të inkurajohet përdorimi i internetit. Disa nga modulet mund të ofrohen jashtë Tiranës. Përmes përdorimit të instrumentit TAIEX të BE-së, mund të organizohen disa vizita studimore.

Tek ASPA do të përdoret e gjithë gama e metodave ndër- aktive pedagogjike sipas përmbajtjes së trajnimit dhe formatit të grupit të synuar. Për të sjellë vlerë të shtuar, do të përdoren studime reale rasti bazuar në kontekstin shqiptar dhe secilit TND do t'i kërkohet të përgatisë, individualisht apo në grup⁷ të vogël, një rast nga struktura e punës e tij/saj. Do të përdoren gjithashtu edhe simulimet.

Në total, 26 javë x 9 orë bëjnë 234 orë. Pjesë tjetër e kohës së detyrueshme, 46 orë, nën mbikëqyrjen e trajnerit do t'i kushtohet prezantimit të rasteve studimore, shkrimit të raporteve apo shkresave të tjera, si dhe bërjes së "detyrave të shtëpisë" në platformën e internetit midis sesioneve të trajnimit.

⁷ Shiko në Aneks disa element të Metodologjisë së Rasteve Studimore

NGA STRATEGJIA KOMBËTARE RAP 2015-2020 TEK MODULI I TRAJNIMIT PËR TND-TË



NJË KALENDAR I PËRKOHSHËM I PLANIT TË TRAJNIMIT PËR TND-TË

280 orë në 6 muaj= 39 ditë të ndara të 26 fundjava të ASPA (26 sesione me 1.5 ditë, në total 234 orë) + 46 orë jashtë ASPA-s (punë parapërgatitore e cila nuk është përfshirë në kalendarin e mëposhtëm)

TND Kurrikula dhe Modulet	Java Nr.																										
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	
1. TND1 Politikat e BE-së dhe çështjet ndërkombëtare																											
1. Marrëdhëniet ndërkombëtare: Organizatat ndërkombëtare dhe negociatat																											
2. Institucionet dhe qeverisja e BE-së																											
3. Politikat e BE-së																											
4. Menaxhimi i çështjeve të BE-së dhe koordinimi i brendshëm																											
5. Ligji administrativ i BE-së																											
6. Menaxhimi i fondeve të BE-së dhe përthithja e fondeve strukturore të BE-së nga vendet e reja anëtare																											
2. TND2 Planifikimi strategjik dhe formulimi i politikave																											
1. Prioritetet e Qeverisë																											
2. Planifikimi strategjik																											
3. Menaxhimi i ciklit të politikave																											
4. Menaxhimi institucional																											

METODOLOGJIA E TRAJNIMIT TË TND-VE

Seancat e trajnimit, grupet e punës, rastet studimore, raportet personale dhe interneti

TND-të janë një grup unik, e për rrjedhojë trajnimi i tyre kërkon një metodologji të veçantë. Ata janë nëpunës civilë me shumë përgjegjësi dhe një program pune shumë të ngjeshur. Zakonisht ata kanë një formim akademik solid dhe karrierë profesionale të suksesshme, kështu që u duhet ofruar informacion i përditësuar dhe me rëndësi për punën e tyre. Gjithashtu materiali i përgatitur për ta duhet të përzgjidhet për të përmbushur në mënyrë specifike nevojat e tyre. Materiali mund të përmbajë të njëjtat tema dhe çështje si ai i ofruar nëpunësve të tjerë civil por perspektiva duhet ndryshuar duke qenë se TND-të janë vendimmarrës dhe udhëheqës⁸. Bazuar në kornizën e kompetencave të hartuar nga OBZHE-ja, TND-të i përkasin familjes 'Udhëheqës Ekzekutivë', e cila përfshin organizimin, drejtimin dhe udhëheqjen e institucioneve dhe stafit të tyre për të arritur objektivat strategjikë. Më konkretisht, pozicionet e punës në këtë familje përfshijnë Sekretar i Përgjithshëm, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtor Departamenti apo pozicione të barazvlefshme me to. Në këtë kontekst, trajnimi në formë leksioni duhet të kufizohet në minimum dhe i fokusuar në dhënën e materialeve të reja dhe të transferimit të informacionit. Seminare ndërvepruese dhe puna në grup janë formatet më efikase; rastet e studimit dhe shkrimi i raporteve janë metodat më efektive. Simulimi është një instrument trajnimi interesant, sidomos për përgatitjen e negociatave të ardhshme për 35 kapitujt gjatë fazës aderuese, e cila do të zgjasë disa vjet.

Shpeshherë TND-të delegojnë shkrimin e raporteve tek vartësit e tyre dhe ekspertët pranë tyre. Shkrimi i raporteve do tu mundësojë atyre të kontrollojnë nivelin e zotërimit të programeve (software) për shkrim dhe prezantim dhe të vlerësojnë aftësinë në gjuhët e huaja, sidomos në anglisht dhe frëngjisht. E para është kthyer në një lloj Eurospeak (gjuhë e folur anembanë Evropës) dhe e dyta një gjuhë thelbësore për çështjet ligjore, veçanërisht në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë në Luksemburg.

E fundit, por jo për nga rëndësia, rastet studimore janë një mjet thelbësor trajnimi për TND-të. Rastet teorike duhet të përdoren në minimum pasi është vështirë të nxjerrësh mësimet dhe ti kthesh ato mësimet të zbatueshme në jetën praktike. Një praktikë e mirë e përdorur nga ENA është përdorimi i rasteve reale përgatitur nga trajnerët të cilët janë gjithashtu nëpunës civilë të nivelit të lartë dhe përgjegjës për zgjidhjen e situatave reale të përmendura në këto raste studimi⁹. Raste studimi nga praktika shqiptare, të sjella për diskutim nga TND-të në një qasje që inkurajon shkëmbimin e eksperiencës, do të rezultojë me përfitim për të gjithë.

Trajnerët duhet të inkurajohen të përdorin qasjen pedagogjike të përzierë: përdorimi i shpesh të internetit dhe faqeve zyrtare shqiptare, atyre të BE-së dhe ndërkombëtare. Për sa i përket informacionit mbi BE-në, nga Komisioni Evropian janë hartuar mjete pedagogjike në shumë gjuhë të huaja si p.sh. video të shkurtra dhe libra me përmbajtje të thelluar. Përdorimi i këtyre mjeteve i shërben dy qëllimeve: përfitim i informacionit mbi BE-në dhe përmirësimi i gjuhëve të huaja¹⁰. Libërthi 40-faqësh "Si funksionon Bashkimi Evropian", që mund ta marrësh falas, është i disponueshëm në 22 gjuhët zyrtare të BE-së, plus në gjuhën

⁸ Aneksi 2 OBZHE Familjet e punëve në Strukturën e Kompetencave. http://www.oecd.org/careers/competency_framework_en.pdf

⁹ Aneksi 3 Metodologjia e një rasti studimor.

¹⁰ https://europa.eu/european-union/about-eu_en, <http://bookshop.europa.eu/en/how-the-european-union-works-pbNA0414810/> dhe <http://bookshop.europa.eu/en/europe-in-12-lessons-pbNA0213714/>

katalanase dhe uellse. Falë këtij ekspozimi ndaj materialeve multi-gjuhësore të BE-së, TND-të do të kuptojnë shpejt rëndësinë e përkthimit të *Acquis* në gjuhën shqipe. Kjo është një punë intensive që përfshin përkthimin e mijëra direktivave dhe rregulloreve. Rregulloret do të zbatohen direkt ashtu sikur se janë hartuar nga gjithë vendet anëtare ndërsa direktivat duhet të transpozohen në ligje nga Parlamenti shqiptar. Në këtë punë do të përfshihen të gjitha ministratë, dhe rrjedhimisht gjithë TND-të gjithashtu!

MODULI TND1: POLITIKAT E BE-SË DHE ÇËSHTJET NDËRKOMBËTARE

Bashkimi Evropian (BE) është një Bashkim sui generis i Shteteve dhe Njerëzve, i cili ka rendin e vet ligjor dhe është mbi sistemin ligjor kombëtar të secilit vend anëtar. BE-ja ka strukturën e vet institucionale, të dallueshme/veçantë dhe autonome. BE është shumë ndryshe nga Organizata e Kombeve të Bashkuara si dhe organizata të tjera ndërkombëtare klasike, të ngritura mbi bazën e ligjeve ndërkombëtare dhe marrëdhënieve ndër-qeveritare.

Nevoja më e madhe që kanë TND-të për sa i përket procesit të anëtarësimit në BE, është përmirësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave që lidhen me procesin e aderimit dhe ndikimi që ky proces do të ketë në administratën publike dhe në shoqërinë shqiptare. Vlerësimi i nevojave të ndryshme për trajnim i kryer nga organizata evropiane dhe ndërkombëtare si dhe nga Projekti i Binjakëzimit, tregojnë se një nga problemet me të ndjeshme duket se është cilësia e

koordinimit ndërministror për çështjet e BE-së. Nuk është ngritur ende asnjë mekanizëm solid ndër-sektorial brenda strukturave qeverisëse për koordinimin e politikave të lidhura me BE-në. Praktikata më të mira nga vendet anëtare, si ajo e Francës SGAE¹¹ apo Britanisë "Sekretariati Evropian"¹², mund t'u prezantohen të trajnuarve.

Plani i veprimit të ASPA-s për trajnimin e vazhduar ofron një kurrikul ambicioze që përmban kapitujt më të rëndësishëm të BE-së të cilët do të negociohen. Moduli TND1 adreson këto problematika me një vizion global gjithëpërfshirës në mënyrë që të ndihmojë TND-të të kuptojnë më mirë çfarë pritet nga Shqipëria në vitet në vijim, çfarë do të thotë konkretisht të jesh vend kandidat për në BE-në dhe çfarë do të ndodhë kur qeveria shqiptare të hapë negociatat për 35 kapitujt.

Moduli ka si qëllim gjithashtu t'i bëjë TND-të të vetëdijshëm për rolin e tyre qendror në këtë proces, pasi ata janë udhëheqësit, vendimmarrësit dhe mbikëqyrësit e gjithë procesit. Sukseset e procesit të aderimit varet kryesisht nga përkushtimi dhe kompetenca e tyre.

Teknikat për negociim duhet të fuqizohen. Klasifikimi, arkivimi dhe monitorimi i informacionit të vlefshëm i cili do të kërkohet vazhdimisht përgjatë procesit të aderimit duhet të zotërohet mirë. Një kulturë për raportime të rregullta dhe transparente tek institucionet e BE-së mbi ecurinë e progresit, përfshirë këtu menaxhimin e kohës, një qasje e orientuar ndaj rezultateve, me 'gurë kilometrikë' dhe afatet kohore të përcaktuara qartë për arritjen e rezultateve, duhet të përfshihen në 'hartën e njohjes' dhe praktikata e përditshme të TND-ve.

Përveç detyrimit për të përafuar legjislationin shqiptar me *acquis* e

¹¹ SGAE *Secrétariat Général pour les Affaires Européennes*, Sekretariati i Përgjithshëm i Çështjeve Evropiane.

¹² Për shkak të votës së BREXIT, mund të zgjidhen shembuj të tjerë.

BE-së, duhet rritur ndërgjegjësimi i TND-ve mbi ndikimin e parimeve, normave dhe praktikave më të mira të ligjit administrativ të BE-së mbi tërësinë e akteve nënligjore të brendshme shqiptare dhe procedurave administrative.

Pamje e përgjithshme: 9 ditë, 6 module nga 1,5 ditë, duke përfshirë vlerësimin dhe informacionin paraprak

TND1.1	Marrëdhëniet ndërkombëtare "klasike"
TND1.2	Institucionet dhe qeverisja e BE-së
TND1.3	Politikat e BE-së
TND1.4	Menaxhimi i çështjeve të BE-së dhe koordinimi i brendshëm
TND1.5	Ligji administrativ i BE-së
TND1.6	Menaxhimi i fondeve të BE-së

TND1.1 MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE "KLASIKE": ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NEGOCIATAT

Prezantimi dhe objektivat

Në të shkuarën, konfliktet zgjidheshin me forcë, pra përmes luftës. Negociatat dhe dialogu kanë çuar në lindjen e organizatave ndërkombëtare. Objektivi parësor i krijimit të këtyre organizatave ka qenë paqja, si p.sh. pas luftës së parë botërore u krijua organizata Société des Nations dhe pas luftës së dytë botërore Organizata e Kombeve të Bashkuara. Që prej kohës së krijimit, fusha e veprimtarisë së tyre është zgjeruar. Zhvillimi i diskutimeve, negociatave, bisedimeve, konferencave, tryezave të rrumbullakëta, etj., kanë çuar në krijimin e organizatave ndërkombëtare në shumë fusha si p.sh. financiare (Bretton Woods, FMN, Banka Botërore, BERZH etj.), tregtare (MPTT, WTO), të punës (ILO/ BIT), shëndetit (WHO), ushqimit dhe bujqësisë (OBU), kulturës (UNESCO), etj.

Kursi do të ofrojë një vështrim në thellësi të ligjit ndërkombëtar, veçanërisht disa shembuj bashkëkohorë të traktateve të rëndësishme, p.sh. Traktati i Parisit për Ndryshimet Klimatike, i firmosur gjatë konferencës CeP21 në vitin 2015. Në formën e vet tradicionale negociatat shprehin marrëdhënien midis shteteve ose, shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, dhe janë të lidhura gjithashtu me diplomacinë. Në marrëdhëniet me këto organizata ndërkombëtare, TND-të kanë për të luajtur një rol të përcaktuar. Negociatat janë pjesë e pandarë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Gjatë kursit do të analizohet edhe një lloj tjetër organizate ndërkombëtare, organizatat jo-qeveritare, të cilat po marrin një rol gjithmonë e më në rritje në marrëdhëniet ndërkombëtare. Praktika e negocimit kërkon kombinimin e njohurisë së kulturës dhe ndryshme ndër-veprojnë midis tyre, me njohurinë e teknikave dhe

strategjive specifike. Të dyja këto cilësi duhen fituar ose forcuar. Cilësitë e një negociatori qëndrojnë në njohuritë, aftësitë praktike dhe personale, ndjeshmëria sociale, përlujta, përshtatshmëria, kapaciteti për të dëgjuar dhe ai për të qenë mendje hapur.

Temat kryesore

Ndryshimi midis ligjit ndërkombëtar dhe atij të BE-së; ndryshimi midis traktatit ndërkombëtar e ndër-qeveritar dhe traktatit të BE-së

Institucionet, aktorët dhe çështjet kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare bilaterale dhe multilaterale

Llojet kryesore të organizatave ndërkombëtare, historia dhe objektivi i tyre, mënyrat e qeverisjes, ndikimi i tyre mbi Shqipërinë dhe qytetarët e saj, roli i TND-ve në marrëdhëniet që ka vendi me këto organizata;

Roli gjithnjë e më në rritje i OJQ-ve;

Teknikat e komunikimit dhe negocimit: zgjedhja e strategjisë, llojet e negociatës dhe procedurave; përgatitja e negociatës; dimensionet psikologjike dhe kulturore të negociatës.

Metodologjia

Teknikat dhe mjetet e nevojshme për të zhvilluar negociata ndërkombëtare do të studiohen përmes përdorimit të rasteve konkrete të studimit, shembujve dhe simulimeve. Do të inkurajohet përdorimi i faqeve të internetit të organizatave ndërkombëtare që do të studiohen gjatë kursit, për tu informuar mbi zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

TND1.2 INSTITUCIONET DHE QEVERISJA E BE-SË

Prezantimi dhe objektivat

TND1.2 synon të ofrojë një pamje të kuadrit institucional të BE-së dhe sistemit të saj të qeverisjes, p.sh. cilat janë institucionet e BE-së, si janë të organizuara ato, si punojnë dhe si ndërveprojnë me njëra-tjetrën. BE u krijua në vitin 1957 me 6 vende anëtare; në vitin 2016 numëron 28 vende dhe vazhdon të jetë në proces zgjerimi. Shqipëria është tani një vend kandidat dhe së shpejti do të fillojë procesin e anëtarësimit me negocimin e 35 kapitujve të acquis. TND-të do të jenë aktorët kryesorë të kësaj 'aventure' evropiane prandaj duhet të jenë të mirë përgatitur për të përballuar sfidat e shumta që priten.

Temat kryesore

1. Institucionet e BE-së, një balancim dinamik i fuqisë

Historia e procesit të integritimit në BE që prej Kongresit të Hagës dhe Traktatit të Parisit

Logjika e dyfishtë e integritimit mbi-kombëtar dhe bashkëpunimit ndërqeveritar, "tre shtyllat"

Natyrë origjinale e rendit të institucioneve të BE-së: një "komunitet ligjor" i bazuar mbi traktatet e nënshkruara midis vendeve sovraane dhe mbi parimin e subsidiaritetit

Balancimi i fuqive midis institucioneve të BE-së (Këshilli, Komisioni, Parlamenti, Gjykata e Drejtësisë, etj.)

Roli i presidencës, i zhvilluar me rotacion 6-mujor

Procesi vendimmarrës dhe ai legjislativ (vendimet e përbashkëta, etj.)

Shërbimi Civil i BE-së

Roli i qytetarëve, shoqërisë civile, OJQ-ve të BE-së

Ndryshimi dhe e përbashkëta me Këshillin e Evropës dhe Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut

2. Si ta përballojmë procesin e aderimit?

Statusi i një vendi kandidat dhe pasojat që sjell ky status

Kushtet për para-aderim, kriteret e Kopenhagës, etj.

Acquis i BE-së dhe harmonizimi ligjor

‘Gurët kilometrikë’ në këtë proces

Pritshmëritë e BE-së dhe delegacionet e BE-së në 139 shtete¹³

Përshtatja e procedurave administrative kombëtare: koordinim më i mirë ndërministror dhe një qasje e orientuar ndaj rezultateve, kontrolli i cilësisë, monitorim, vlerësimi, etj.

Teknikat e negocimit

Një hap me tej...

Përdorimi i faqeve të internetit të BE-së ose analiza e materialeve në internet mbi temat/rastet të cilat do të diskutohen me trajnerët, p.sh. moduli online E.1 “Funksionimi i Bashkimit Evropian”, i cili po hartohet aktualisht nga stafi IT i ASPA-s dhe projekti gjerman “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar”.

Metodologjia

Përmbledhja e shkurtër nga trajneri do të kombinohet me punën në grup për të diskutuar raste studimore, e ndjekur nga një seancë plenare, teknika “brainstorming” dhe simulimi. Do të jetë një seminar online, ku detyrat do të bëhen në kompjuter, i cili do të përfundojë me një test vetëvlerësimi dhe një takim përmbledhës me trajnerin dhe pjesëmarrësit.

¹³ https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/area/geo_en

TND1.3 POLITIKAT E BE-SË

Prezantimi dhe objektivat

TND1.3 synon të prezantojë mënyrën si BE-ja zbaton prioritetet politike të identifikuar në strategjitë e saj.

Temat kryesore

1. Politikat e BE-së, një proces i shtresëzuar

Materialet që duhet të gjenden online dhe lexohen janë të fokusuar në këto çështje:

Historia e politikave të KEE dhe BE-së: nga një bashkim doganor me disa politika të integruara (PPB) te krijimi i një Tregu të Përbashkët të integruar

Një zonë për krijimin e një tregu ekonomik të drejtë dhe të lirë

Katër liritë e lëvizjes (personat, kapitali, mallrat dhe shërbimet)

Pamje e përgjithshme e buxhetit të BE-së dhe prioritetet financiare relative (pësha specifike që i caktohet Politikës së Përbashkët Bujqësore, Politikës Rajonale, Politikës së Kohezionit, etj.)

Strategjia e rritjes së BE-së, Evropa 2020 ¹⁴

2. Politikat që synojnë integrimin ekonomik dhe monetar të BE-së

Bashkimi ekonomik dhe monetar i unionit

Politika e konkurrencës, politika industriale, politika e përbashkët Tregtare

Tregu i përbashkët dhe qarkullimi i lirë i personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve (Traktati i Maastricht, 1992)

Politikat madhore të BE-së: PPB (Politika e Përbashkët Bujqësore), Politika Rajonale dhe koncepti i Kohezionit Ekonomik, Social dhe Territorial, fondet strukturore (EARDF, FSE, etj.)

Shembuj të politikave sektoriale: Kërkimi Shkencor, Arsimi, Inovacioni, Shëndetësia, etj.

3. Politikat që synojnë "thelimin" e projektit Evropian

Një BE më afër qytetarëve të vet: një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie; politika sociale; politika mjedisore dhe lufta kundër ndryshimeve klimatike; një Evropë me kulturë dhe arsim

Marrëdhëniet e jashtme të BE-së: Politika e jashtme dhe ajo e sigurisë e përbashkët

Politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes

Politika Evropiane për zhvillim dhe bashkëpunim

¹⁴ http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

Politika e zgjerimit dhe fqinjësisë

Këto lista treguese dhe politikave e reja mund të kërkojnë vëmendje për prezantim.

Metodologjia

Metodologjia do të përshtatet nga trajnuesi duke përfshirë temat e renditura me sipër dhe materialet e disponueshme.

Për sesionin 1: një sesion online do të kryhet nga pjesëmarrësit në kompjuter/laptop, përfshirë dhe një test vetëvlerësimi dhe një përmbledhje të shkurtër nga trajnuesi.

Për sesionin 2 dhe 3: do të kombinohet përmbledhje e shkurtër nga trajnuesi me punën në grup duke përdorur materiale konkrete të rasteve studimore, ndjekur nga një seancë përmblyëse.

TND1.4 MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE TË BE-SË DHE KOORDINIMI I BRENDSHËM

Prezantimi dhe objektivat

TND1.4 synon të theksojë rëndësinë e menaxhimit të çështjeve të brendshme të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve me status kandidat, si dhe rolin që kanë TND-të në koordinimin e brendshëm.

Temat kryesore

Përgatitja dhe përmirësimi i politikave të BE-së

Mekanizmat e përgatitjes dhe prezantimit të prioritetëve

COREPER I dhe COREPER II

Komitetet sektoriale dhe teknike

Prioritetet kombëtare dhe mandatet sektoriale kombëtare në mekanizmat e BE-së

Strukturat organizative dhe koordinuese kombëtare

Gjatë procesit të aderimit, vendet kandidatë krijojnë një Zyrë apo Ministri të Integritimit Evropian dhe dërgojnë një përfaqësi zyrtare në Bruksel. Shqipëria ka ngritur Ministrinë e Integritimit Evropian¹⁵ dhe në faqen online të saj qartësisht dhe vazhdimisht paraqiten përpjekjet për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe përmirësimin e strukturës aktuale institucionale: *"Në vend të një koordinimi institucional ku informacioni qarkullon midis elementeve përbërës, do të ngremë një mekanizëm ndër-institucional [...]".*

Në këtë kontekst disa praktika nga vendet e anëtarësuar hershëm dhe nga ato rishtazi mund të jenë një subjekt i dobishëm studimi. P.sh. struktura franceze SGAE *Secrétariat Général aux Affaires Européennes* u krijua pas luftës së dytë botërore në 1948, atë kohë SGCI- sekretariati i përgjithshëm i koordinimit ndërministror, e ngritur për të menaxhuar fondet e rindërtimit¹⁶. Disa nga Zyrat e Integritimit Evropian të vendeve të reja anëtare kanë rezultuar struktura shumë efektive në përgatitjen për aderim. Mësimet mund të nxirren edhe nga ato eksperiencat që kanë

¹⁵ <http://www.integrimit.gov.al/en/program/european-union-integration>

¹⁶ <http://www.sgae.gouv.fr/cms/sites/sgae/accueil/le-sgae.html> (Plani Marshall)

rezultuar më pak të suksesshme. Gjithashtu mund të studiohet puna e Pikës Kombëtare të Kontaktit (PKK), e cila luan një rol të rëndësishëm sidomos për projektet e binjakëzimit. Koordinimi ndërministror kombëtar bëhet sidomos i rëndësishëm gjatë presidencës së BE-së, pasi vendi bëhet kryeqyteti politik i Evropës për 6 muajt e presidencës dhe administrata e vendit menaxhon gjithë aktivitetet e BE-së¹⁷ përmbi ato të vendit të vet.

Metodologjia

Përmbledhje e shkurtër nga trajneri të informacionit më të fundit mbi BE-në, raste studimore për vendet anëtare të BE-së, simulim i koordinimit ndërministror, përmes përdorimit të internetit në faqet e internetit të BE-së, presidencës së BE-së dhe vendeve anëtare.

TND1.5 LIGJI ADMINISTRATIV I BE-SË

Prezantimi dhe objektivat

Për juristët moduli i ligjit administrativ të BE-së do të jetë më i rëndësishmi, për të tjerët do të jetë një mundësi për të kuptuar rëndësinë e *acquis* të BE-së dhe ndikimin e tij kryesor në kuadrin ligjor kombëtar. I krijuar nga Traktati i Romës në vitin 1957, sistemi ligjor administrativ i BE-së është pasuruar nga një jurisprudencë konstruktive nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, e cila ka përparësi mbi gjykatat kombëtare të vendeve anëtare dhe rrjedhimisht ka rolin e Gjykatës së Lartë të BE-së. Gjykata Evropiane është e vendosur në Luksemburg. Arkitektura e sistemit ligjor është e bazuar në sistemin latin, me influencë të konsiderueshme nga Franca dhe Gjermania. Bazuar në faktin e ekzistencës të 22 gjuhëve zyrtare në BE, çdo vendim duhet të përkthehet në të gjitha këto gjuhë

për të garantuar akses të gjithë qytetarët. Cilësia e përkthyesve dhe juristëve të BE është e garantuar për qytetarët dhe provimet për tu bërë pjesë e kësaj trupe përkthyesish janë shumë konkurruese.

Temat kryesore

1. Parimi 'administrim i mirë' dhe qasja e orientuar ndaj qytetarit për shërbimet publike.

Traktati i Bashkimit Evropian dhe kategoritë e legjislacionit të BE-së

Karta Themelore e të Drejtave të Njeriut dhe parimi "administrim i mirë"

Roli i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, praktikatat e saj gjyqësore (parimet e përgjithshme)

Rezultati: një administratë publike e orientuar ndaj qytetarit

2. Çfarë mësojmë nga krahasimi i traditave ligjore të ndryshme të vendeve anëtare të BE-së?

Ky sesion do të bazohet në rastet studimore. Lista e mëposhtme është vetëm sugjeruese.

Francë: parimet e shërbimit publik, pushtetit publik, interesat e përgjithshme, etj.

Gjermani: parimi i subsidiaritetit, proporcionalitetit, administrimi indirekt/deleguar (*Bund/Länder*)

¹⁷ Shembulli i Presidencës Sllovaqe nga 1 Korriku deri më 31 Dhjetor, 2016, website në Frëngjisht <http://www.eu2016.sk/fr>

Itali: përgjegjësia e administratës publike, marrëdhënia publik-privat, etj.

Britania e Madhe: tradita e një ligji të përbashkët, analiza kosto-përfitim dhe vlerësimi i ndikimit që ka prodhimi i legjislacionit, etj.

Spanja: një ligj administrativ i riformuluar plotësisht gjatë demokratizimit për të përbashkuar kuadrin ligjor të BE-së, parimi i decentralizimit.

3. Rëndësia e transparencës dhe e drejta e aksesit te dokumentet administrative: implikimet direkte për Shqipërinë

Ky sesion do të bazohet në rastet studimore dhe simulim. Lista e mëposhtme është vetëm sugjeruese.

Përputhja e ligjit shqiptar dhe zbatimi efektiv i tij

Rastet e studimit, si shembull, procesi i vendimmarrjes dhe delegimi i procesit të vendimmarrjes; e drejta për të pasur akses në informacionin publik dhe transparenca, qasja e re për "rihapjen e procedurave" (Kodi i Ri i Procedurave Administrative): oportunitetet, sfidat, rreziqet dhe vështirësitë, etj.

Simulim: kur hartohet një akt ligjor i ri, procesi i konsultimit me institucionet të tjera qendrore, aktorët, grupet e interesit, shoqëria civile, etj.

Metodologjia

Një kombinim i përmbledhjes së shkurtër nga trajneri me teknika 'brainstorming' midis pjesëmarrësve, grupe të vogla pune, seanca plenare, raste studimore dhe simulim. Përdorimi i internetit do të jetë një mjet plotësues shumë i dobishëm, sidomos <http://eur-lex.europa.eu/homepage.html>.

TND1.6 MENAXHIMI I FONDEVE TË BE-SË

Prezantimi dhe objektivat

Buxheti i BE-së krijohet nga kontributi i secilit vend anëtar: 1% e buxhetit kombëtar. Shpenzimet e BE-së ndahen në dy degë kryesore: (1) personeli i shërbimit civil i BE-së dhe funksionimi i institucioneve, dhe (2) shpenzimet për "investime" të BE-së për të gjitha programet dhe veprimet që rrjedhin nga politikat e BE-së. Prej dekadash buxheti i dedikuar Politikës së Përbashkët Bujqësore është më i madhi. Që prej aderimit të 14 vendeve të reja nga blloku lindor, Politika Rajonale dhe ajo e Kohezionit janë bërë politikat më të mëdha. Këto fonde njihen si "fonde strukturore".

Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal (FEZHR) u krijua në vitin 1975. Ky fond synon forcimin ekonomik dhe kohezionin social në BE përmes korigjimit të pabarazisë midis rajoneve¹⁸. Rregullorja nr. 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (datë 17 dhjetor 2013) për Fondet Evropiane për Zhvillim Rajonal dhe dispozitat specifike në lidhje me investimet për rritje dhe punësim, që shfuqizon Rregulloren

¹⁸ http://ec.europa.eu/regional_policy/en/funding/erdf/

nr. 1080/2006¹⁹, përkufizojnë parimet, rregullat dhe standardet për zbatimin e Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal si dhe fushën e investimeve për zhvillim, punësim dhe bashkëpunim rajonal për periudhën 2014-2020. Fushat prioritare të FEZHR janë inovacioni dhe kërkimi shkencor, agjenda dixhitale, mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe një ekonomi që nuk dëmton ambientin (që emeton karbon në nivele të ulëta).

Fondi Social Evropian²⁰ u krijua nga Traktati i Romës i vitit 1957, dhe është Fondi Struktural më i vjetër. U themelua për të kompensuar fundin e proteksionizmit nacionalist në prag të lindjes së Komunitet Ekonomik Evropian (KEE). Sot qëllimi kryesor i Fondit Social Evropian është të nxitë punësimin, ulë përjashtimin social dhe investim në aftësi. Pas rënies së murit të Berlinit dhe bazuar në dëshirën e shprehur nga shtetet e ish-bllokut komunist, veçanërisht Polonia dhe Hungaria (shkronja P dhe H në fjalën PHARE), për t'iu bashkuar Komunitetit Evropian, Komisioni krijoi fondet e para-aderimit në mes të viteve 90. Që prej janarit 2007, Instrumenti për Asistencën Para-Aderimit (e njohur si IPA), zëvendësoi një sërë programesh të BE-së dhe instrumentet financiare për vendet kandidatë apo ato potenciale për tu bërë kandidatë, siç janë programet PHARE, PHARE CBC, ISPA, SAPARD, CARDS, dhe instrumentet financiare për Turqinë²¹.

Në Shqipëri është ngritur një strukturë institucionale për të menaxhuar fondet IPA e cila ka një Koordinator Kombëtar për IPA-n (i njohur si NIPAC) në Ministrinë e Integritimit Evropian, një Zyrtar Autorizues Kombëtar (i njohur si NAO) në Ministrinë e Financave, dhe një agjenci për zbatimin e operacioneve, që është Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontratave (CFCU). Duke qenë se TND-ja është në qendër të këtij sistemi, struktura

do të prezantohet dhe testohet nëse është gati për të menaxhuar fondet strukturore të ardhshme të BE-së. Do të prezantohen edhe shembuj të praktikave të mira p.sh. sistemi i informacionit francez DATAR/CGET, sistemi polak, sistemi lituanes, mësimet e nxjerra nga projektet e binjakëzimit të BE-së për zhvillimin rajonal në vendet e përfshira në Politikën e Fqinjësisë (Moldavi), etj. Kjo listë është sugjeruese dhe do të rifreskohet sipas nevojave.

Temat kryesore

Buxheti i BE-së

Fondet strukturore evropiane dhe ato të para-aderimit

Rregullat për menaxhimin financiar dhe lidhja me politikat Evropiane dhe kombëtare

Metodologjia

Përmbledhje e shkurtër, raste studimore nga vendet anëtare të BE-së, përdorimi i faqeve të internetit të BE-së dhe vendeve anëtare.

¹⁹ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/LSU/?uri=CELEX:32013R1301>

²⁰ http://ec.europa.eu/regional_policy/en/funding/social-fund/

²¹ http://ec.europa.eu/regional_policy/en/funding/ipa/

TND2 PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE FORMULIMI I POLITIKAVE

Planifikimi Strategjik dhe Formulimi i Politikave janë dy shtyllat kryesore për qeverisje të mirë dhe janë në qendër të punës profesionale të përditshme të TND-ve. Ky modul do të adresojë 4 pika:

Pamje e përgjithshme: 9 ditë, 4 module 1.5 ditore, përfshirë vlerësimin dhe përmbledhjen

TND2.1	Prioritetet e qeverisë
TND2.2	Planifikimi strategjik
TND2.3	Menaxhimi i ciklit të politikave
TND2.4	Menaxhimi institucional

Nën-moduli TND2.1 "Prioritetet e qeverisë", do të analizojë mënyrën se si këto prioritetet lindin, bëhen të vlefshme dhe miratohen nga koncepti në letër i një këshilltari deri tek miratimi nga një ministër. Modul do të adresojë si dimensionin politik ashtu dhe atë teknik pasi disa zgjedhje politike duhet të justifikohen nga pikëpamja teknike dhe disa zgjedhje teknike duhet të justifikohen nga pikëpamja politike për tu bërë prioritet të qeverisë. Do të theksohet rëndësia e konceptit në letër dhe disa shembuj të hartimit të tyre mund të organizohen në grupe të vogla. Për shkak të mungesës së kohës shumë prej TND-ve do të delegojnë këtë detyrë tek këshilltarët e tyre apo bashkëpunëtorët e besuar. Por në procesin e aderimit, TND-të do të jenë në frontin e parë dhe mbase do të duhet të hartojnë konceptet në letër dhe tekstin për negociatat,

ndonjëherë direkt në gjuhën angleze.

Nën-modul TND2.2 "Planifikimi strategjik", është një nga detyrat kryesore të TND-ve aktualë, atyre të komanduar dhe kandidatëve për tu bërë TND. Shqipëria është e pasur me shumë strategji të hartuara, sektoriale dhe ndër-sektoriale. Afati kohor i këtyre strategjive po i afrohet në mënyrë progresive kohëzgjatjes së strategjive të BE-së, sidomos ajo e 2014-2020. Nën-moduli do të analizojë disa nga strategjitë kombëtare, në veçanti atë të aderimit, të reformës në administratën publike, dhe të menaxhimit të financave publike. Këto strategji shpesh janë hartuar me mbështetjen e jashtme të asistencës teknike, BE, OBZHE/SIGMA, FMN, BB, etj. TND-të padyshim që ishin bashkë-hartues në këtë proces me qëllim që të mësonin në mënyrë progresive të bëheshin më të pavarur. Planifikimi strategjik gjithashtu është një punë e përditshme për TND-të pasi ata janë drejtues të veprimtarive të zbatuara në njësitë e tyre dhe ata punojnë çdo ditë për të planifikuar strategjinë më të mirë për të arritur me sukses synimet dhe objektivat e ditës. Do të punohet në grup për të vlerësuar funksionimin e strukturës për të përmirësuar proceset dhe procedurat nëse është e nevojshme.

Nën-moduli TND2.3 "Menaxhimi i ciklit të politikave", si nga vlerësimi ex-ante dhe nga ai ex-post, rregullojnë të gjitha politikat. Ky nën-modul mund të ndihmojë për të ndarë gjithë ciklin në faza përbërëse për të kuptuar pjesët e tij, cilat janë objektivat dhe rezultatet e pritshme, sfidat dhe çfarë është në lojë, cilët janë treguesit për sukses, aktorët, korniza kohore, 'gurët kilometrikë', indikatorët fillestarë, burimet e referencës, kontributet potenciale dhe ato të nevojshme, rreziqet dhe supozimet, etj. I gjithë zinxhiri, që nga platforma politike nga e cila ka lindur e gjithë politika deri në vlerësimin ex-post i rezultateve dhe ndikimeve të fazës së zbatimit, do të analizohet. Rastet e studimit nga BE-ja do të rezultojnë të dobishme dhe raste reale nga vendi mund të prezantohen nga trajnerët.

Nën-moduli TND2.4 "Menaxhim Institucional", është çelësi për zbatimin e gjithë sistemit të qeverisjes. Procesi i aderimit në BE do të kërkojë fuqizim të kuadrit institucional shqiptar, sidomos koordinimi ndërministror. Negocimi i kapitujve të acquis do të kërkojë një rrjet nëpunësish civilë të nivelit të lartë me eksperiencë të gjatë dhe me njohje në të gjitha ministrinë, të aftë dhe të gatshëm të punojnë bashkë. Disa kapituj me dimension financiar janë ndër-sektorialë dhe nënkuptojnë e kërkojnë punë në grup. Juristë të fushave të ndryshme nga të gjitha ministrinë duhet të mësojnë të punojnë së bashku. Gjithashtu brenda ministrive, specialistë ligjorë do të duhet të punojnë me kolegë të specializuar në ekonomi, menaxhim, çështjet sociale, financat publike, etj. Fryma bashkëpunuese, hartimi i përbashkët i teksteve, shkëmbimi i informacioneve, etj. mund të konfliktuohen me metoda të së shkuarës, si p.sh. mbajtja e informacionit sekret, qasje burokratike, etj. Transparenca dhe të qenit i hapur duhet të bëhen rregullat e reja të lojës dhe TND-të duhet të udhëheqin ndryshimin e qasjes.

TND2.1 PRIORITETET E QEVERISË

Prezantimi dhe objektivat

Shqipëria ka një sistem parlamentar. Çdo 5 vjet, anëtarët e zgjedhur të parlamentit zgjedhin presidentin. Çdo 4 vjet, menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme, shumica parlamentare propozon kryeministrin. Platforma politike jep orientimin e politikave që do të zbatohen në të ardhmen nga qeveria. Kryeministri i emëruar formon qeverinë dhe harton një program politik bazuar në platformën politike. Strategjia e Qeverisë përcakton prioritetet e saj, të cilat janë edhe objektivat e identifikuar në programin politik të kryeministrit. Siguria, arsimit, punësimi, shëndeti, mjedisi, kultura, etj., mund të jenë disa nga pikat më të rëndësishme të programit dhe tradicionalisht janë prioritetet e qeverisë. Në këto prioritetet mund të bëjë pjesë dhe kërkimi shkencor dhe inovacioni.

Pasi prioritetet qeveritare janë identifikuar qartësisht, ato përkthehen në politika dhe plane veprimi.

Planet e veprimit përkthehen në programe me një buxhet të dedikuar dhe programet ndahen në projekte. TND-të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces transformimi nga një platformë politike në prioritetet qeveritare të zbatueshme.

Temat kryesore

Programi politik i Qeverisë;

Prioritetet qeveritare;

Strategjitë sektoriale dhe lidhja me prioritetet qeveritare;

Roli i TND-ve: koncepti në letër- miratimi-zbatimi-monitorimi i aktiviteteve

Në mënyrë që të kuptohet qartë se si funksionojnë këto mekanizma, instrumente, metoda dhe mjete, do të përdoren raste studimore, simulime dhe përdorimi i faqeve të internetit në mënyrë që të analizohen prioritetet e BE-së në vite, sidomos gjatë presidencave 6-mujore, periudhë në të cilën prioritetet përcaktohen.

Prioritete për instrumentet e para-aderimit IPA II' për 2014-2020 (649.4 milion €) janë:

- Demokracia dhe qeverisja
- Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore
- Mjedisi dhe çështjet e lidhura me klimën
- Transporti

- Aftësia për të konkurruar dhe inovacioni
- Arsimi, punësimi dhe politikat sociale
- Bujqësia dhe zhvillimi rural
- Bashkëpunimi rajonal dhe territorial

Gjithashtu në një qasje ndërvepruese çdo pjesëmarrësi do t'i kërkohet të identifikojë disa shembuj të prioriteteve të qeverisë shqiptare në strukturën ku ai/ajo bën pjesë dhe të bëjë një prezantim të shkurtër se si u zgjodh dhe zbatua prioriteti dhe çfarë mësimesh mund të nxirren nga ky proces. Në të njëjtën mënyrë, prioritetet aktuale qeveritare do të krahasohen me prioritetet e financuara përmes IPA II dhe do të identifikohen mangësitë si dhe burimet financiare për të adresuar këto mangësi si dhe alternativat për të arritur rezultatet për qeverinë pa mbështetjen e buxhetit të BE-së. Ky nën-modul do të analizojë kështu mënyrën si prioritetet qeveritare lindin, vlerësohen, nga koncepti teknik në letër, te miratimi politik nga ministri. Ndonjëherë zgjedhjet politike duhet të justifikohen në mënyrë posteriori nga pikëpamja teknike dhe disa zgjedhje teknike duhen testuar para se të caktohen si prioritetet qeveritare.

Metodologjia

Informacion "teorik" mund të sigurohet nga trajnerët, megjithatë ky nën-modul do të mbështetet kryesisht në raste studimi, nga vendi ashtu dhe BE-ja, dhe përmes navigimit në internet. Mund të zhvillohen disa ushtrime për hartim tekstesh, disa në anglisht (ose frëngjisht) nëse është e mundur.

TND2. 2 PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Prezantimi dhe objektivat

Plani i trajnimit të vazhduar të ASPA-s për nëpunësit civilë propozon një sesion trajnimi 12-ditor mbi Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), i cili shpjegon ciklin e plotë të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit e planifikimit strategjik dhe politikave publike. SPI është një nga mjetet kryesore (së bashku me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim-SKZHI, Programin Buxhetor Afatmesëm- PBA dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian-PKIE) të qeverisë shqiptare për planifikimin e politikës ekonomike dhe për zhvillim. Ky mjet është në përdorim që prej vitit 2007 dhe është i bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, një strategji 6-vjecare gjithëpërfshirëse, si dhe 29 strategji sektoriale dhe ndër-sektoriale zhvillimi. SPI koordinohet nga Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave. Kjo strategji është baza për planifikimin buxhetor 3-vjecar, i cili rezulton në "Programet Buxhetore Afat-mesme", si dhe buxhetet vjetore. Cikli i dytë i planifikimit është 2014-2020, miratuar në 2015. Ai lidh planifikimin strategjik të politikave me planifikimin buxhetor dhe me menaxhimin e financave publike. Ai gjithashtu lidhet me Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe është baza për planifikimin e qeverisë dhe koordinimin e asistencës së huaj në Shqipëri.

Temat kryesore

Sistemi i planifikimit strategjik;

Lidhja midis prioriteteve strategjike dhe buxhetit;

Mekanizmat e monitorimit;

Roli i TND-ve in sistemin e planifikimit strategjik dhe ndikimi i tij në gjithë veprimet e qeverisë.

Në këtë kontekst, TND-të duhet të lexojnë me vëmendje dokumentin "Plani Indikativ Shumë-vjetor për Instrumentet e Asistencës së Paraderimit (IPA) për Shqipërinë, 2011-2013"²² si dhe fishën e hartuar për projektin "Fondi i besuar" (Donatorë të ndryshëm për një periudhë kryesisht 3 vjeçare, të cilët kanë kontribuar që prej krijimit të sistemit SPI "²³ dhe "Dokument i Indikativ Strategjik për Shqipërinë" (2014-2020) miratuar në 18/8/2014²⁴:

"SKZHI ofron një kornizë strategjike për të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndër-sektoriale dhe është shtylla e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), një grup parimesh operuese për të siguruar që planifikimi, buxhetimi dhe monitorimi i politikave qeverisëse është i integruar dhe funksionon në mënyrë efikase. SKZHI udhëheq Programin Buxhetor Afat-mesëm (PBA), si dhe ndarjen buxhetore vjetore, pasi shpalos objektivat e politikës të cilat përfshihen në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit nga të gjitha ministrat dhe agjencitë"

Metodologjia

Përmbledhje e shkurtër nga trajneri për t'u dhënë TND-ve informacionin më të fundit mbi planifikimin strategjik, raste studimore krahasuese nga eksperiencia e vendeve kandidatë për BE në kufi me ne, të cilët kanë hartuar strategji të ngjashme, me të njëjtat objektiva të përgjithshme dhe të veçanta (hryja në BE, përafrimi i *acquis*, RAP, RFP, forcimi i kapaciteteve, etj.). Përpos kësaj, do të analizohen raste studimore

të strategjive aktuale sektoriale/horizontale dhe lidhja e tyre me mekanizmat e zbatimit në nivel qendror dhe sektoriale (si p.sh. njësitet e monitorimit; njësitet e jetësimit të prioriteteve; platformat e raportimit online, etj. si dhe rezultatet e këtyre mekanizmave); A janë ato efçente? Çfarë mund të bëhet për ta bërë fazën e zbatimit funksionale?

*Nëse është e mundur mund të organizohen vizita studimore me mbështetjen e TAIEX.

TND2.3 MENAXHIMI I CIKLIT TË POLITIKAVE

Prezantimi dhe objektivat

Politikat publike janë instrumentet përmes të cilave qeveria zbaton programet e veta politike. Ato janë përkthimi në terma administrative dhe veprime konkrete të vizionit politik dhe prioriteteve qeverisëse. TND-të janë në qendër të politikë-bërjes dhe ata janë përgjegjëse për menaxhimin e suksesshëm të ciklit të politikave.

Një politikë ka nga pas një histori të gjatë; ajo paraqitet në dy forma. E para mund të jetë një përkthim teknokratik i thjeshtë i një programi politikash, i cili me tej zberthehet në plane veprimi. Ajo gjithashtu mund të hartohet e pabazuar në program ekzistues (krijohet nga fillimi), e bazuar në një vizion global, me një ide nga një ministër, këshilltar, drejtor, nëpunës civil, një qytetar, gazetë, ngjarje, në fakt prej çdo gjëje. Pasi zhvillohen shumë diskutime dhe reflektime mbi idenë e propozuar, do të pasojë hartimi i një koncepti në letër. Ky koncept do të diskutohet, ndryshohet, përmirësohet, korrigohet, etj. në një qasje bashkëpunimi

²² http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/mipd_albania_2011_2013_en.pdf

²³ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/ipa/2013/centralised/ipa_2013_024190_multi_donor_trust_fund_to_support_implementation_of_integrated_planning_system_pha.pdf

²⁴ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20140919-csp-albania.pdf

dhe pjesëmarrjeje. Në momentin që arrihet konsensus, drafti dërgohet për miratim politik, dhe nëse kjo arrihet, politika e propozuar vijon rrugën tipike të politikëbërjes.

Koncepti i dokumentit politik duhet të zgjerohet, shpjegohet, ilustrohet dhe transformohet në një raport, duke përfshirë plane veprimi dhe buxhet për zbatimin e programeve dhe projekteve. Në një qasje të orientuar ndaj rezultateve, duhet të hartohet një matricë logjike e cila përmban strukturën kryesore dhe afatet kohore; zbatimi i një politike zakonisht është një ndërmarrje e cila zgjat disa vjet. Në varësi të llojit të politikës, objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të identifikohen dhe miratohen në nivel politik ose administrativ. "Gurë kilometrikë" duhen zgjedhur për të bërë një vlerësim. Indikatorët për të matur progresin e zbatimit të politikës duhet të zgjidhen. Duhet të merret vendim cilat do të jenë indikatorët fillestarë. Duhet të identifikohen supozimet dhe rreziqet e lidhura me këtë politikë. Gjithashtu llogaritet edhe buxheti i nevojshëm për zbatimin e politikës. Nëse kostot e politikës janë përfshirë në buxhetin kombëtar zbatimi i saj do të jetë i thjeshtë në të kundërt, duhet gjetur buxhet prej një politike me fushë zbatimi më të gjerë. Një vlerësim ex-ante do të përmbledhë të gjitha këto veprime përgatitore dhe vendime.

Pasi ka mbaruar faza përgatitore, politika tashmë e miratuar do të publikohet në formën e një raporti, në letër dhe formë elektronike. Një përmbledhje mund të përdoret për 'publicitet' që qytetarët të informohen, reagojnë, marrin pjesë dhe aplikojnë (në rast së është thirrje për dorëzim propozimesh). Gjithashtu mund të printohen fletëpalosje për të informuar publikun. Politika mund të shpallet nga ministri gjatë ndonjë konference për shtyp dhe të njoftohet në media, televizion dhe radio. TND-ja duhet të mbikëqyrë gjithë fazën publicitare, informative dhe aktivitetet.

Ekzekutimi i një politike kërkon kohë dhe mësimet e nxjerra nga një politikë e zbatuar në mënyrë efektive mund përdoren për të filluar një politikë tjetër.

Temat kryesore

Menaxhimi i ciklit të politikës

Roli i TND-së në secilën fazë të politikëbërjes

Marrëdhëniet ndër-institucionale në menaxhimin e ciklit të politikave dhe roli i TND-ve

Mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit si element thelbësor për sukses

Metodologjia

Sjellja e informacionit teorik nga ana e trajnerit, punë në grup për të diskutuar fazat e ndryshme e ciklit të politikës dhe menaxhimi i tyre, bazuar në raste studimi reale të sjella nga vetë TND-të. Përdorimi i faqeve të internetit të BE-së dhe vendeve anëtare, duke i dhënë një avantazh tjetër këtij ushtrimi- praktikën e gjuhës së huaj.

TND2. 4 MENAXHIMI INSTITUCIONAL

Prezantimi dhe objektivat

Cilësia e Menaxhimit Institucional për Planifikimin e Strategjisë dhe Formulimit të Politikave varet shumë nga organizimi i kuadrit institucional të administratës publike. Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike dhe disa raporte vlerësimi nga SIGMA kanë identifikuar një sërë dobësish që ulin efikasitetin e menaxhimit institucional në Shqipëri. Përveç dobësisë që lidhet me kapacitetin administrativ të nëpunësve civilë, i adresuar në kapitullin që vijon mbi Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, fusha kryesore për përmirësim e identifikuar lidhet me komunikimin dhe koordinimin. Kultura e fshehtësisë dhe burokracisë është ende shumë aktuale. Bazuar në këtë kulturë, ndarja e informacionit shihet si humbje e fuqisë. Transparenca mund të perceptohet si një rrezik. Ndikimi i kësaj kulture shumë i madh mbi funksionimin e makinës administrative. 'Fuqia vertikale' është ende rregulli i lojës. Komunikimi nga poshtë-lartë (nga nivelet më të ulëta të ato më të larta) nuk është zhvilluar akoma dhe komunikimi horizontal nuk është inkurajuar. De-koncentrimi nuk është zhvilluar midis administratës qendrore dhe shërbimet rajonale dhe lokale, dhe decentralizimi është vetëm në fillimet e veta.

Në këtë kontekst institucional procesi i aderimit në BE do të sjellë revolucion në jetën e administratës. Secili prej kapitujve që do të negociohen do të kërkojë ngritjen e një grupi pune të dedikuar, shpesh në nivel ndërmintor. Ministria e Financës do të ketë përfaqësues në të gjithë kapitujt pasi ka gjithmonë një dimension financiar për çdo kapitull. Ritmi i negociimit akoma nuk dihet por mund të mendojmë se nuk mund të hapen më shumë se 6 kapituj në të njëjtën kohë. Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Integritimit Evropian do të jenë shumë të ngarkuar. Secila ministri do të identifikojë negociatorët për sektorët që

mbulojnë nga perspektiva sektoriale, ligjore dhe financiare. Negociatorët duhet të kenë njohuri të mira të kontekstit shqiptar, mendje të hapur për të kuptuar dhe integruar komentet e BE-së, aftësi shumë të mira për shkrim dokumentesh dhe raportesh dhe, nëse është e mundur, njohuri të gjuhëve të huaja, sidomos anglisht dhe frëngjisht. Akoma nuk dihet se kur do të fillojë dhe sa do të zgjasë procesi, por negociimi i 35 kapitujve, shqyrtimi analitik i ligjeve dhe akteve nënligjore, rishikimi i tyre nga Parlamenti, nëse është e mundur gjithë acquis të përkthehet në shqip, pjesa teknike e aderimit mund të zgjasë 5, 6 apo më shumë vjet. Askush nuk e di, por cilësia e menaxhimit institucional nga TND-të do të ndikojë në mënyrë domethënëse efikasitetin e procesit, dhe rrjedhimisht kohëzgjatjen e tij.

Temat kryesore

Organizimi dhe kuadri institucional;

Komunikimi zyrtar dhe bashkëpunimi ndër-institucional;

Procesi i konsultimit;

Procesi i vendimmarrjes;

Roli i TND-ve në menaxhimin institucional dhe komunikimin zyrtar.

Ky nën-modul synon rritjen e ndërgjegjësimit të TND-ve për këtë fazë thelbësore në procesin e aderimit dhe për rolin e tyre qendror në këtë proces. Veçanërisht, 'de- materializimi' apo thjeshtësimi i procedurave do të jetë i nevojshëm për të shmangur bllokimin e gjithë sistemit me zakonet e vjetra. Delegacionet e BE-së dhe të Komisionit në Bruksel kanë filluar tashmë të përdorin komunikimin e dematerializuar përmes

faksit (telekopje). Mesazhet elektronike do të jenë forma e rregullt dhe firma elektronike duhet të njihet ligjërisht. Duhet punë e përbashkët për ngritjen e platformave elektronike. TND-të janë vendimmarrës, ata janë udhëheqës dhe nuk duhet as ta bllokojnë sistemin dhe as të mbeten pas tij. Ata duhet të udhëheqin rrugën. TND5 mbi inovacionin është hartuar për të ardhur në ndihmë në këtë situatë.

Metodologjia

Përmbledhje nga trajneri, raste studimore nga vendet anëtare më të hershme dhe ato që kanë aderuar rishtazi, diskutim në grup mbi sfidat që hasin TND-të, bazuar mbi shembuj reale nga ministritë përkatëse, ushtrime për shkrim në ekip, lidhje në internet gjatë seancave do të ishte vlerë e shtuar.

TND3 KOMPETENCAT PËR MENAXHIMIN STRATEGJIK DHE ORGANIZACIONAL

MBNJ mund të realizohet në dy nivele: teknik nga Drejtorët apo Menaxherët e BNJ, dhe strategjik e organizacional nga TND-të. TND-të duhet të kenë një lloj niveli njohurie për menaxhimin e BNJ në mënyrë që të mos marrin vendim që bien ndesh me vendimet teknike. Megjithatë TND-të mbështeten tek menaxheri i BNJ për të gjitha teknikalitetet e lidhura me këtë fushë. Vlera e shtuar e TND-ve është strategjia dhe organizimi.

Pamje e përgjithshme: 9 ditë, 6 module 1.5 ditore, përfshirë vlerësimin dhe përmbledhjen

TND3.1	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
TND3.2	Udhëheqja (lidhshipi)
TND3.3	Menaxhimi i komunikimit dhe informacionit, marrëdhëniet me publikun
TND3.4	Menaxhimi i ndryshimit
TND3.5	Menaxhimi i krizës
TND3.6	Kompetencat personale

Një modul i plotë për MBNJ dhe Zhvillimin është hartuar nga ASPA për menaxheret e nivelit të mesëm. Ky modul është i ndarë në 6 nën-module dhe mund të përbëjë bazën e përmbajtjes për nën-modulin e parë për "Menaxhimin e Burimeve Njerëzore" për TND-të.

TND3.1 do të mundësojë të shohim nëse të gjithë elementet e kontekstit kuptohen nga TND-të. Këto elemente janë: Hartimi i politikave dhe strategjive për menaxhimin e burimeve njerëzore, ligji për shërbimin civil, menaxhimi i stafit/ vlerësimi i performancës individuale, rekrutimi, përshkrimi i punës, analiza e punës, trajnimi dhe zhvillimi profesional, sistemi i regjistrimit të stafit.

TND3.2 mbi "udhëheqjen" do të adresojë çështjen kryesore për 'punën' e TND-ve. Një TND është në esencë një udhëheqës. Disa TND janë 'lider të lindur', ndërsa të tjerët nuk janë! Kështu këta të fundit duhet të trajnohen për të forcuar aftësitë udhëheqëse, qëndrimeve dhe sjelljes. Një literaturë e rëndësishme është publikuar së fundi mbi këtë

temë, veçanërisht në llojet e ndryshme të udhëheqjes. Disa të dhëna akademike mbi temën do të ndihmojnë TND-të të analizojnë specifikën dhe sfidat e këtij pozicioni të veçantë.

TND3.3 "komunikimi, menaxhimi i informacionit dhe marrëdhëniet me publikun" mund të jetë një pikë e dobët për menaxherët e nivelit të lartë, pasi ata shpesh nuk kanë kohë për të komunikuar mbi atë që po bëjnë. Komunikimi dhe menaxhimi i informacionit, si brenda ashtu dhe jashtë institucionit, është thelbësor. Teknika profesionale efikase do të prezantohen dhe testohen.

TND3.4 mbi "menaxhimin e ndryshimit" qëndron në thelb të modernizimit të administratës publike dhe mund të jetë çelësi i suksesit për procesin e aderimit të Shqipërisë në BE. TND-të do të jenë në qendër të këtij procesi. Përkushtimi dhe metodat për menaxhimin e ndryshimit do të kushtëzojnë suksesin e aderimit. Shkëmbimi i praktikave më të mira, si të vendeve anëtare më të hershme dhe ato që kanë aderuar rishtazi, do të rezultojnë mjaft frytdhënëse.

TND3.5 mbi "menaxhimin e krizave" është shumë i rëndësishëm pasi menaxherët e nivelit të lartë rrallëherë janë trajnuar për menaxhimin e krizave. Krizat mund të jenë të brendshme, të jashtme, aksidentale apo të shkaktuara me qëllim. Ekziston një literaturë e gjerë mbi këtë subjekt por mënyra më e mirë për të mësuar si ta menaxhojnë krizën është përmes rasteve të studimit, shqiptare apo vende të tjera, sidomos atyre të BE-së. Simulimi gjithashtu mund të rezultojë i dobishëm.

TND3.6 mbi "kompetencat personale" adreson një aspekt të ndjeshëm të nivelit të njohurive akademike, teknike dhe aftësitë e një menaxheri të lartë. Nëse një TND nuk ka marrë pjesë në trajnim të vazhduar, ai/ajo mund t'i ketë humbur kompetencat e tilla si gjuhët e huaja dhe kompjuterike, përfshirë këtu përdorimin e internetit. Kompetencat mund të jenë edhe në fushën ligjore, ekonomike, financat publike, çështjet sociale, çështjet ndërkombëtare dhe Evropiane. Ky

modul mund të ndihmojë TND-të të identifikojnë fushat në të cilat ata dëshirojnë të zhvillojnë kompetenca dhe aftësi profesionale shtesë. OBZHE-ja ka përgatitur një Kornizë Kompetencash shumë të dobishme me indikatorë kyçë. Niveli 5 korrespondon me nivelin TND²⁵. Shtojca 2 paraqet familjet e punëve dhe llojet e ndryshme të kompetencave për TND-të: kompetencat të kryerjen e punës, kompetenca ndërpersonale dhe kompetenca strategjike.

TND3.1 MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Prezantimi dhe objektivat

TND3.1 synon të shqyrtojë nëse TND-të kanë njohuri të përgjithshme mbi MBNJ, të kuptojnë natyrën e shërbimit civil siç është parashikuar në nenin 1 të Ligjit për Shërbimin Civil "*një shërbim civil i qëndrueshëm dhe profesional, i bazuar në meritë, integritet moral, paanësi politike dhe përgjegjshmëri*" implikimet e këtij ligji në rregullat dhe procedurat për MBNJ, si dhe sfidat e reja që priten të merren përsipër nga shërbimi civil në procesin e aderimit.

Temat kryesore

Hartimi i politikave dhe strategjive për menaxhimin e burimeve njerëzore;

Legjisllacioni për shërbimin civil;

Menaxhimi i stafit/ vlerësimi individual i performancës;

²⁵ Aneksi 2, http://www.oecd.org/careers/competency_framework_en.pdf cf.

Rekrutimi, përshkrimi i punës, analiza e pozicionit të punës;

Trajnimi dhe zhvillimi profesional;

Sistemi i regjistrimit të personelit.

Për teknikalitete të ndryshme TND-të mund të mbështeten tek menaxheret e BNJ. TND-të duhet të kenë njohuri të përgjithshme mbi MBNJ në nivel strategjik dhe politik. Ata duhet të dinë legjislacionin për Shërbimin Civil, në veçanti nenet që lidhen me TND-të²⁶. Ata duhet të punojnë në dy nivele: teorik/ abstrakt dhe praktik/ konkret. Ata duhet të marrin dhe forcojnë njohuri të përgjithshme mbi politikën e sektorit publik të BNJ si dhe evolucionin e tij, si: pjesët e ndryshme të tij (rekrutimi, trajnimi, emërimi, pagat) lidhjen me njëra-tjetrën, cilët janë faktorët që ndryshojnë rregullat e lojës (mundësi të reja të ofruara nga teknologjia e informacionit, konkurrimi për talentet, niveli i lartë i arsimimit për shërbimin civil, barazia gjinore, etj.). Evoluimi i Shërbimit Civil shqiptar do të rezultojë nga perspektiva e drejtë që kanë TND-të, nga puna strategjike, ndryshimet dhe përshtatjet që ata do të propozojnë. Gjithashtu nuk duhet të harrojmë faktin se TND-të janë gjithashtu menaxherë dhe përballen çdo ditë me çështje konkrete të lidhura me menaxhimin e shërbimit civil.

Duke u bazuar në Shërbimin Civil Shqiptar, rekrutimi, lëvizjet paralele dhe ngritja në detyrë, përshkrimi/analiza e punës, rishikimi individual i performancës, menaxhimi i aftësive, menaxhimi i nivelit ekzekutiv, të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve civilë/ disiplina, trajnimi, sistemi i regjistrimit të stafit, paketat e kompensimit, dialogu social dhe gjithë

çështjet e tjera 'teknike' të lidhura me aspektin e MBNJ në Shërbimit Civil mund të diskutohen në grupe pune e me tej. Këto diskutime të përmbledhen në një seance plenare për të siguruar kështu një vizion global. Duke qenë se Shqipëria është tanimë një vend kandidat, rregullat për stafin e Shërbimit Civil të Unionit do të zbatohen direkt për zyrtarët shqiptarë që do të hyjnë në Shërbimin Civil të BE-së në momentin e anëtarësimit, dhe për këtë arsye këto rregulla duhet t'u prezantohen TND-ve²⁷. Shërbimi Civil i BE-së u krijua menjëherë pas nënshkrimit të Traktatit të Romës në 1957 dhe u influencua shumë nga "baballarët themelues të BE-së", në veçanti vendet e Evropës Veriore dhe Lindore. Arkitektura ka mbetur e njëjtë në arenën globale; vlerat dhe parimet e Unionit duhen studiuar, p.sh. kodi i sjelljes, etikës, anti-korrupsionit, barazia gjinore, etj. Rekrutimi bazohet në konkurse të organizuar në mënyrë të centralizuar nga Zyra e Zgjedhjes së Personelit Evropian, EPSO, mbi bazat e kualifikimit dhe nevojave për personel.

Metodologjia

Përmbledhje e shkurtër, raste studimore (Shqipëria, BE-ja, dhe vendet anëtare), diskutim në grup dhe seanca plenare.

²⁶ Aneksi I, ekstrakt nga Ligji nr. 152/2013 për Shërbimin Civil", i ndryshuar nga Ligji nr. 178/2014, Kapitulli VI, Trupa e Nivelit të Lartë Drejtës, Neni 27-32. Të tjera dokumente që krahasojnë Ligjin e Shërbimit Civil 1999 dhe 2014, <http://www.eajournals.org/wp-content/uploads/A-comparative-analysis-of-the-new-civil-service-law-in-Albania-in-view-of-the-commitments-under-of-the-Stabilisation-Association-Agreement-with-the-European-Union---.pdf>

²⁷ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TEXT/PDF/?uri=OJ.L:2013:287:FULL&from=EN>
http://ec.europa.eu/civil_service/docs/to100_en.pdf

TND3.2 UDHËHEQJA

Prezantimi dhe objektivat

Nën-moduli i dytë mbi “udhëheqjen” do të adresojë çështjen kryesore të “punëve” të TND-ve. Një TND është nga natyra një udhëheqës. Disa TND janë “lindur lider”, disa të tjerë duhet të trajnohen për të forcuar kompetencat e tyre të udhëheqjes, sjelljen dhe qëndrimet. Një literaturë e rëndësishme është publikuar së fundmi mbi këtë temë, veçanërisht për llojet e ndryshme të udhëheqjes. Disa të dhëna akademike mbi temën do të ndihmojnë TND-të të analizojnë specifikën dhe sfidat e këtij pozicioni të veçantë.

Temat kryesore

Aftësitë menaxheriale të TND-ve mund të ndahen në tre kategori kryesore të ekspertizës dhe aftësi të lidhura me:

1. Veprimet: aftësi për të vendosur, përfshirje personale dhe përkushtim, përshtatshmëri, rezistencë ndaj stresit;
2. Marrëdhëniet: forcimi i përkushtimit (udhëheqjes), aftësi për të zhvilluar të tjerët dhe për të deleguar, aftësi bashkëpunuese me mjedisin përreth, aftësi këshilluese;
3. Inteligjencë për situatën: ndjeshmëri për të arritur interesin e përbashkët, aftësi për të zhvilluar një vizion dhe pritshmëri strategjike, të qenit i hapur, aftësia për të sfiduar, imagjinuar dhe sjellë inovacion.

Etika, e konsideruar gjithnjë e më shumë si vlera themelore që legjitimon shërbimin civil dhe besimin, pa të cilën udhëheqja nuk do të ishte e mundur, është vlera e cila duhet të vendoset në qendër të programit për ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin e aftësive menaxhuese të TND-ve.

Pilotimi i veprimeve publike kërkon që TND-të të jenë organizues dhe novatorë, rigorozë dhe menaxherë reagues, strategë dhe udhëheqës në mënyrë që ata të:

1. Nxisin menaxherët e nivelit të lartë drejtues të administratave të ndryshme drejt një kulture menaxheriale të përbashkët brenda institucioneve qeveritare;
2. Konsolidojnë dhe zhvillojnë menaxherë potencialë të nivelit drejtues;
3. Zgjerojnë përgjegjësitë e tyre aktuale dhe të ardhme dhe të zhvillojnë vizionin strategjik;
4. Të kuptojnë ndryshimet në fushat ekonomike, teknike, sociale, politike dhe ligjore në mënyrë që të pozicionojnë veprimin publik (vizion strategjik i kombinuar me qasje strategjike);
5. Hartojë strategji për zbatimin e partneriteti publik dhe politikave të lidhura me të në përputhje me projektin politik të administratës (zbatimi i vizionit dhe vendimeve) ;
6. Optimizmi i nivelit të veprimit përmes inkurajimit të sinergjisë dhe ndërveprimit;
7. Zbatimi i ndryshimeve të nevojshme për rigjenerimin e veprimit publik.

TND-të luajnë një rol thelbësor në motivimin e ekipit. Siç do të shohim dhe në nën-modulin vijues, sidomos TND3.3, TND4 dhe TND5, komunikimi, menaxhimi i konfliktit dhe aftësitë negociuese janë elemente të tjera të nevojshme që duhet të ketë "paketa" e TND-ve. Nën-moduli do të përfshijë zhvillime të pritshme në periudhën afat-shkurtër dhe afat-mesme në funksionet menaxheriale publike të reja, veçanërisht ato të lidhura me aderimin në BE. E-administrimi dhe 'open data'²⁸ do të sjellin ndryshime masive të cilat duhet të parashikohen dhe paraprijnë zhvillimin e kapaciteteve të përshtatjes, fleksibilitetit dhe proaktivitetit.

Metodologjia

Do të jepet një bibliografi për lexim shtesë. Megjithatë literatura e shumtë kryesisht analizon, përshkruan dhe kategorizon udhëheqjen. Metodot me e mirë për të fituar aftësi udhëheqësi është praktika përmes rasteve të studimit dhe simulimit. Rastet e studimit do të sillen nga TND-të dhe rasti më i mirë do të jetë ai që ka më shumë zgjidhje të mundshme. Diskutimet në grupe mbi tema të caktuara mund t'i ndihmojnë TND-të të mësojnë nga shkëmbimi i eksperiencës. Suksesi i këtij nën-moduli do të varet nga vetë TND-të.

TND3.3 MENAXHIMI I KOMUNIKIMIT DHE INFORMACIONIT, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Prezantimi dhe objektivat

Komunikimi, menaxhimi i informacionit dhe marrëdhëniet me publikun mund të jenë pika e dobët e disa menaxherëve të nivelit të lartë pasi ata shpesh konsiderohen se nuk kanë kohë për të komunikuar çfarë po bëjnë. Shpesh pranohet se informacioni është fuqi. Kultura e sekreteve dhe burokracisë kanë qenë për një kohë të gjatë rregulli në administratën publike. Ndarja e informacionit dhe transparenca nuk konsideroheshin sjellje e natyrshme. Madje në disa vende, ndarja e informacionit mund të ketë qenë e rrezikshme. Ky modul synon të tregojë se ndarja e informacionit është një sjellje pozitive dhe rezulton me fitim.

Temat kryesore

Komunikimi institucional

Menaxhimi i informacionit

Marrëdhëniet me publikun

Roli i TND-ve në procesin e komunikimit dhe marrëdhënies me publikun.

Menaxhimi i informacionit në një epokë kompjuterizimi të procedurave dhe teksteve dixhitale, imazheve dhe zërit të regjistruar, është kthyer në një problem dhe sfidë njëkohësisht. Ndarja e informacionit për një

²⁸ Cf. TND5 mbi Inovacionin në Administratë

TND nuk është i detyrueshëm. Informacioni mund të ndahet i plotë apo i pjesshëm dhe mund të qarkullojë në qarqe të ndryshëm njerëzish. Disa informacione janë të klasifikuara, veçanërisht në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe komunikimi i këtij informacioni mund të jetë i kufizuar te një grup i caktuar njerëzish. Demokracia nënkupton transparencë. Efikasiteti ndonjëherë nënkupton konfidencialitet. Komunikimi publik dhe publiciteti janë zakonisht të rregulluara me ligj. Dialogu social nënkupton komunikimin e informacionit në një shkallë të caktuar.

Komunikimi është gjithashtu një çështje me rëndësi për TND-të, pasi është një nevojë në botën tonë moderne. Ekzistojnë dy lloje komunikimi, i brendshëm dhe i jashtëm. Komunikimi i brendshëm është thelbësor për një ministri apo organizatë për të siguruar një kulturë 'shtëpie' dhe ndjenjë përkatësie. Punonjësit apo nëpunësit civilë duhet të informohen mbi atë që po ndodh në ministrinë/organizatën e tyre. Komunikimi brenda strukturës ndihmon në qarkullimin e informacionit dhe rrit efikasitetin e saj. Kjo mund të arrihet duke instaluar televizione në disa zona të ndërtesës, përmes posterave, mesazheve me e-mail, letrave individuale, takime informative, shpërndarje të fletëpalosjeve, etj. Komunikimi i jashtëm është i rëndësishëm për dy arsye: lehtëson marrëdhëniet ndërministrore dhe përmirëson kontaktet midis qytetarëve dhe administratës. Në të dyja rastet bën të mundur dialogun, shkëmbimet, e për rrjedhojë është një faktor në rritjen e efikasitetit. Marrëdhëniet me publikun kanë një natyrë tjetër. Ato synojnë vendosjen e strukturës, politikës, programit apo projektit në fjalë në një dritë të favorshme në mënyrë që të bindë audiencën, publikun, taksapaguesit, donatorët potencialë, etj. Marrëdhëniet me publikun synojnë të 'shesin' diçka, qoftë kjo një ide apo koncept dhe arritjen e një marrëveshjeje, mbështetjeje, apo gjetjen e parave dhe fondeve. Marrëdhëniet me median, të shkruar dhe audio-vizuale janë deri diku specifike pasi gazetaret janë

profesionistë dhe mund të duan të destabilizojnë personazhin që po intervistojnë. Ekzistojnë teknika komunikimi për tu zotëruar sidomos në lidhje me gjatësinë e fjalisë, zgjedhjen e fjalëve kyçe, intonacionin dhe mbi të gjitha gjatësinë e fjalimit, në veçanti për intervista në televizion ku hapësira e lajmeve është shumë e shkurtër (e matur me sekonda).

Metodologjia

Tre aftësitë e përkrahura më sipër nuk mund të mësohen në shkollë apo nga librat. TND-të duhet të hartojnë strategjinë personale mësimi të komunikimit me publikut. Grupet e diskutimit mbi shembuj reale dhe 'brainstorming' do të ishin të frytshme. Do të analizohet gjithashtu përdorimi i medias sociale, sidomos Facebook, Twitter, LinkedIn. Një përmbledhje e shkurtër nga trajneri për aspektet teorike, shkëmbimin e eksperiencave, ushtrime në grup (45-60-90 sekonda) dhe simulim (të filmohet ose jo) do të përdoren.

TND3.4 MENAXHIMI I NDRYSHIMIT

Prezantimi dhe objektivat

TND3.4 mbi "menaxhimin e ndryshimit" qëndron në thelb të modernizimit të administratës publike dhe mund të jetë çelësi i suksesit për procesin e aderimit të Shqipërisë në BE. TND-të do të jenë në qendër të këtij procesi. Përkushtimi dhe metodat për menaxhimin e ndryshimit do të kushtëzojnë suksesin e procesit të aderimit. Shkëmbimi i praktikave më të mira, si të vendeve anëtare më të hershme dhe atyre që kanë aderuar rishtazi, do të rezultojnë mjaft frytdhënëse. Për shembull, në Francë, në krah të Kryeministrit është Sekretariati i Përgjithshëm i Modernizimit

të Veprimit Publik SGMAP ²⁹ , i cili është përgjegjës për ofrimin e asistencës për menaxhimin e ndryshimit për ministrat, shërbimet e dekoncentruara dhe vetëqeverisjes së decentralizuar, përmes shërbimit “mbështetje për transformim”.

Temat kryesore

Llojet e ndryshimit

Mjetet që TND-të mund të përdorin për të menaxhuar ndryshimin

Roli i TND-ve për të udhëhequr ndryshimin

Shqipëria është tanimë një vend kandidat, e kjo do të sjellë shumë ndryshime veçanërisht në administratën publike. Për të evituar që ndryshimi të kthehet në problem i cili çon në kundërshti dhe rezistencë, ai duhet planifikuar, menaxhuar dhe monitoruar. TND-të do të hartojnë, menaxhojnë dhe monitorojnë këto plane. Pra ata duhet të dinë për natyrën dhe shkallën e ndryshimit potencial që pritet.

Së pari kuadri ligjor do të ketë ndryshime. Fatmirësisht, ky proces ka filluar që prej nënshkrimit së marrëveshjes së parë të Asociimit dhe procesi i përafritimit të sistemit shqiptar me *acquis* e BE-së është i kuptuar dhe i menaxhueshëm. Negocimi i kapitujve do të kërkojë përkthim të shumë rregulloreve të cilat zbatohen direkt, dhe të direktivave të cilat duhen transpozuar dhe votuar në Parlament. Të gjitha ministritë do të përfshihen në këtë sfidë ligjore-gjuhësore. Përkthyesit zyrtarë jo gjithmonë njohin terminologjinë specifike të sektorit dhe mund të përdorin disa fjalë ndërkohë që ekspertët e sektorit përdorin fjalë të tjera. Disa mësimet të mira mund të nxirren nga eksperiencia e valës së

parë të zgjerimit ku 10 vende u anëtarësuan në 2004. TND-të duhet të monitorojnë punën masive në momentin që volumi i ligjeve të BE-së të detyruara për tu zbatuar do të kërkohej nga Shqipëria.

Procesi i anëtarësimit në BE do të çojë drejt një ndryshimi të kulturës së administratës. Evolucionin e mentalitetit ka filluar dhe Kodi i Ri i Procedurave Administrative është prezantuar te shumica dërrmuese e nëpunësve civilë. Projektet e binjakëzimit do të fillojnë në disa ministri dhe nëpunësit civilë shqiptarë po mësohen të punojnë krah homologëve të tyre evropianë të cilët vijnë nga vende të ndryshme të unionit. Zakonisht TND-të janë Udhëheqës Projektit për këto projekte. Gjithashtu mjete te reja po prezantohen si TAIEX, instrumenti për shkëmbimet, si për vizita studimore jashtë vendit ashtu edhe për seminare në Shqipëri me disa nga ekspertet e BE-së. SIGMA po ofron ekspertizën e vet dhe po propozon draft-korniza institucionale, strategji, plane veprimi, etj. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike propozon qasje inovative për menaxhimin e ndryshimit. Por e gjithë kjo nuk do çojë gjëkund nëse TND-të nuk janë të përfshirë dhe të përkushtuar për suksesin e menaxhimit të ndryshimit. Ndikimi që ka ndryshimi mbi kostot përfshirë pasojat ekonomike, buxhetore, ligjore, njerëzore dhe organizative, duhet të vlerësohet dhe monitorohet.

Metodologjia

Përmbledhje nga trajneri mbi disa aspekte teorike të menaxhimit të ndryshimit, raste studimi për të krahasuar vende të ndryshme të BE-së dhe sektorin publik e privat. Punë në grup për të diskutuar mjete për menaxhimin publik dhe teknikat dhe si dhe eksperiencë reale në Shqipëri në menaxhimin e ndryshimit: fuqizimi i skuadrës dhe motivimi, parandalimi i konfliktit, dialogu social.

²⁹ <http://modernisation.gouv.fr/le-sgmap> dhe <http://modernisation.gouv.fr/l'action-publique-se-transforme>

TMC3.5 MENAXHIMI I KRIZËS

Prezantimi dhe Objektivat

Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues trajnohet rrallë mbi menaxhimin e krizave. Krizat mund të jenë të brendshme ose të jashtme, aksidentale apo të kryera nga dora e njeriut. Krizat mund të jenë individuale ose institucionale. Si udhëheqës dhe vendimmarrës, TND-ja duhet ta zgjidhë atë. Mbi këtë temë ka shumë materiale, por mënyra më e mirë për të mësuar si të menaxhojmë një krizë është nëpërmjet rasteve studimore nga Shqipëria dhe vendet e Bashkimit Evropian. Stimulimi i roleve do të ishte gjithashtu i frytshëm.

Temat Kryesore

Aspektet e ndryshme të menaxhimit të krizës që duhen marrë parasysh janë:

Aspekti organizativ (t'i lejohet subjektit në krizë vazhdimi i kryerjes së detyrave);

Aspekte të lidhura me njerëzit (në mënyrë që punonjësit të marrin mjaftueshëm mbështetje për të mundur sigurinë e tyre dhe të organizatës);

Aspektet financiare (të mbrojnë organizatën ndaj dëmeve që mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e saj);

Aspektet ligjore (të krijuara nga masat e propozuara për zgjidhjen e krizës);

Aspektet e komunikimit (për të ruajtur imazhin e qeverisë dhe udhëheqësve të saj).

Nëse kriza është e jashtme (aksident, katastrofë), TND-ja duhet të thërrasë mbrojtjen civile apo shërbimet përkatëse të emergjencës dhe do të sjellë të gjitha strukturat së bashku për të reaguar dhe përballuar krizën duke përfshirë komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm. Nëse është një ngjarje e shkaktuar nga njeriu apo qoftë edhe një sulm terrorist, TND-ja do të thërrasë policinë dhe shërbimet e sigurisë, por edhe do të udhëheqë reagimin. Të gjitha institucionet duhet të kenë plane dhe procedura për rastet e emergjencave dhe TND-ja duhet t'i njohë dhe të jetë në gjendje të menaxhojë zbatimin e tyre qoftë edhe në kushte kritike.

Nëse kriza është e brendshme, TND-ja duhet të mbledhë bashkëpunëtorët më të afërt për të analizuar situatën, të dëgjojë opinione të ndryshme dhe do të hapë dialog me palët e përfshira (një individ apo një grup, për shembull sindikatat). Teknikat e negociimit ekzistojnë dhe duhet të mësohen dhe të praktikohen. Në rastin e një greve dialogu social është i nevojshëm për të ulur tensionet dhe për të shtruar rrugën e dialogëve të mundshëm. Kontakti duhet të mbahet. Menaxhimi i informacionit të brendshëm (mesazhe elektronike, pika televizive të brendshme, takime etj.) dhe të jashtëm (shtypi i shkruar, TV dhe radio) është një element kyç.

Menaxhimi i medias masive në kohë krize është i nevojshëm për TND-në. Stimulimi i roleve është ideal për trajnime dhe mund të regjistrohet në mënyrë që të analizohen reagimet e TND-së, te cilat mund të përdoren si mësim të nxjerra.

Pas krizës është thelbësore të informohemi dhe të mundohemi të mësojmë nga mësimet e nxjerra prej ngjarjeve të shkuara dhe nga mënyra si ato janë menaxhuar. Për krizat e lidhura me teknologjinë, plani ekzistues i emergjencave dhe i sigurisë duhet të rishikohet dhe nëse

është e nevojshme, të përmirësohet. Për krizat sociale duhet të hartohen mekanizmat e parandalimit, sinjalizuesit, mjetet për identifikimin e pasojave që ka shkaktuar kriza. Çdo lloj krize duhet të analizohet dhe duhet të krijohen strategji parandaluese për të ardhmen. TND- ja do të jetë në vijë të parë. Ata duhet të jenë të përgatitur mirë.

Metodologjia

Një literaturë e gjerë e prodhuar mbi menaxhimin e krizave dhe të dhënave teorike nga trajnuesi, mund të shërbejnë si një hyrje e dobishme për rastet studimore- të Shqipërisë dhe të vendeve të ndryshme anëtare të BE-së dhe të stimulimit të roleve. Nëse është e mundur, stimulimi i roleve duhet të regjistrohet në video, në mënyrë që më pas të ky material të analizohet nga grupet e punës dhe të identifikohen mësimet e nxjerra.

TND3.6 KOMPETENCAT PERSONALE

Prezantimi dhe Objektivat

TND3.6 mbi "Kompetencat personale" trajton aspektin e ndjeshëm të nivelit të njohurive akademike, teknike, dhe aftësie të një drejtuesi të nivelit të lartë. Analiza e Nevojave për Trajnim e kryer në kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së "Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri" ³⁰ përcaktoi që nevojat kryesore të TND-së për trajnim i përkasin fushës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (udhëheqja, komunikimi, negocimi). Nëse një pjesëtar i TND-së nuk ka marrë pjesë vazhdimisht në trajnime, ai/ajo mund të humbas aftësinë e përdorimit të gjuhës së huaj dhe ato kompjuterike (WORD, EXCEL, PPT) – duke përfshirë këtu edhe përdorimin e internetit. Me aftësi mund të kuptohet

aftësi në fushën ligjore, ekonomi, financë publike, çështje sociale, çështje ndërkombëtare dhe evropiane.

Bazuar në kuadrin e kompetencave të OBZHE-së ³¹, Projekti i Binjakëzimit ka hartuar një matricë të kompetencave të TND-së për ASPA-n. Matrica sintetizon organin rregullues përkatës për TND-të, sidomos (1) neni 27 dhe 32 i Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil (i ndryshuar)", e ndryshimet sipas nenit 10 deri në 14 të ligjit nr. 178/2014, (2) VKM nr.118 mbi procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit, dhe përfundimit të marrëdhënies së shërbimit civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe pjesëtarëve të TND-së, (3) Manuali nr. 6, datë 19.09.2014, mbi rekrutimin dhe emërimin e trupës së nivelit drejtues ³². Sipas kapitullit III § 2 të VKM- së n° 118, korniza e kompetencave rendit një numër të cilësive, të cilat janë riorganizuar në tre kategori, përmban renditjen origjinale të ilustruar si më poshtë:

Temat Kryesore

Njohuria	e) Njohuri e gjerë mbi kompetencat ndër-sektoriale; ë) Njohuri mbi fenomenet ekonomike dhe sociale; i) Njohuri mbi sistemin ligjor Evropian."
Aftësitë	a) Aftësia për të drejtuar dhe menaxhuar veprime të ndryshme; b) Aftësitë e komunikimit; c) Aftësitë e Menaxhimit Strategjik; ç) Ndërtimi i marrëdhënieve ndër- personale; dh) Aftësitë e Punës në Grup; d) Efikasiteti;
Karakterit	f) Besueshmëria; g) Vizioni; gj) Të qenit krijues; h) Integriteti;

³⁰ Shiko Aneksin 1

³¹ Shiko Nivelin 5= TND- të në Aneksin 2 http://www.oecd.org/careers/competency_framework_en.pdf

³² Shiko një variant të konsoliduar të legjisllacionit në Aneksin 1

Për të qenë nëpunës i lartë në Shërbimin Civil Shtetëror, kërkohen domosdoshmërisht njohuritë, aftësitë dhe një vizion/kulturë të përbashkët. Në të kundërt, mungesa e kulturës së përbashkët të menaxhimit mund të çojë në përplasjen ndërmjet departamenteve dhe të ngadalësojë mekanizmat e arbitrimit ndërministror. Koha dhe energjia e përdorur për të negociuar midis ministrive të ndryshme me kultura menaxheriale heterogjene, mund të zvogëlojë fleksibilitetin e negociatave me partner të ndryshëm nga jashtë (anëtarë të Parlamentit, partner social, shoqëria civile ose partner të huaj).

Metodologjia

Përmbledhje e shkurtër nga trajnuesi, diskutime në grup mbi Analizën e Nevojave për Trajnim, nevojave individuale dhe kolektive për gjuhët e huaja dhe aftësitë kompjuterike. Raste studimore mbi kompetencat e kërkuara për nëpunësit civil të BE-së dhe VA-ve.

TND3.6 mund të parashikohet si një modul i përshtatur për të ndihmuar TND-në të identifikojë fushat ku ata do të dëshironin të zhvillonin më tepër kompetencat dhe aftësitë e tyre.

TND4 ÇËSHTJET E FINANCEVE PUBLIKE

“Vizioni i strategjisë për reformën e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) është të sigurojë një sistem të financave publike që promovon transparencë, përgjegjshmëri, disiplinë fiskale dhe efikasë në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe zhvillimit ekonomik.”
(MFP Shqipëri 2014-2020 fq. 5)³³

Ashtu si Reforma në Administratën Publike (RAP), strategjia kombëtare e reformës të MFP-së është një pasuri e vërtetë për Shqipërinë dhe do të jetë një udhërrëfyes për TND4. TND-të janë përgjegjës për zbatimin e saj në strukturat përkatëse. Moduli synon t'i ndihmojë ata të përqendrohen në risitë më të rëndësishme të FP-së, midis të cilave edhe Programet e Buxhetit Afat-Mesëm (PBA).

Ashtu sikurse për Kodin e Procedurave Administrative për Administratën Publike, Ligji Organik i Buxhetit (LOB) dhe ndryshimet e ligjit nr.9936 nga 2008 mbi Menaxhimin e Sistemeve Buxhetore në Republikën e Shqipërisë janë gurët e themelit. Moduli synon të ndihmojë TND-të të identifikojë elementët që ju nevojiten në punën e tyre të përditshme.

Vlerësimi³⁴ i vitit 2011 – *Shpenzimet Publike dhe Përgjegjshmëria Financiare* (SHPPF), arrin në përfundimin që MFP është përmirësuar ndjeshëm për një gamë të gjerë të treguesve të performancës që prej vitit 2006³⁵. Themeluar në vitin 2001 nga shtatë partnerë, ku përfshihen

³³ <http://www.financa.gov.al/all/newsroom/ligje/ligji-nr-10-296-date-08-07-2010-i-ndryshuar-me-ligjin-nr-110-2015-date-15-10-2015-per-menaxhimin-financiar-dhe-kontrollin-i-unifikuar&page=1>
<http://docplayer.net/11584656-Republic-of-albania-ministry-of-finance.html>

³⁴ <https://pefa.org/SHPPF>: Përmirësimi i Menaxhimit Financiar Publik. Mbështetja e Zhvillimit të Qëndrueshëm

³⁵ Shiko SHPPF fq. 81- 82 dhe Planin e Veprimit të MFP- së dhe Strategjisë së Reformës të MFP- së fq. 84- 109

Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Bashkimi Evropian, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia dhe Zvicra, SHPPF është bërë tashmë struktura kryesore ndërkombëtare për vlerësimin e MFP-së. Një vlerësim i SHPPF-së mat shkallën në të cilën sistemet, proceset dhe institucionet e MFP-së kontribuojnë në arritjen e rezultateve të dëshiruara të buxhetit si: disiplina fiskale të përbëra, shpërndarja strategjike e burimeve, ofrimi efikas i shërbimeve ³⁶. Struktura për vlerësimin e MFP-së bazohet në:

Shtatë Shtyllat e Performancës të MFP-së



Besueshmëria
e Buxhetit



Transparenca
e Financave



Menaxhimi i
Aseteve dhe
Detyrimeve



Strategjia dhe
Buxhetimi Fiskal
i bazuar në politika



Parashikueshmëria
dhe kontrolli për
zbatimin e buxhetit



Kontabiliteti
dhe Raportimi



Shqyrtimi i Jashtëm
dhe Auditit

TND- të janë të përfshira në të shtatë shtyllat dhe ekspozimi i tyre në SHPPF duhet të fuqizohet.

Ata duhet të njihen me raportet e vlerësimit të FMN-së, SIGMA/ Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit ,2013 dhe raport progresin e BE-së për vitin 2014. Duke marrë parasysh të gjitha këto vlerësime, Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike thekson që "Për të siguruar stabilitet, Qeveria do të forcojë kuadrin e përgjithshëm fiskal, krijojë mekanizma për të garantuar që parashikimi të jetë realist dhe forcojë procesin e përgatitjes së PBA-ve tre-vjeçare" dhe që "Auditimi i jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit do të forcohet, me qëllim harmonizimin e rolit të tij, strukturës, dhe 'modus operandi' me standardet e përcaktuara nga ONISA ." ONISA është Organizata Ndërkombëtare e Këshillit të Lartë të Shtetit dhe TND-të, duhet të njihen me të, veçanërisht me projekt-planin e Strategjisë 2017-2022. Për të fuqizuar MFP- në, Shqipërisë i duhet një Sistemi Informatik i Integruar i Menaxhimit Financiar, një SIIMF që mbështet të gjitha proceset kryesore të përfshira në menaxhimin e financave dhe veprimeve të Qeverisë. Në mbështetje të funksioneve kyçe të menaxhimit financiar publik (funktionaliteti, platformat teknologjike, shkalla e integritetit, etj.), do të bëhet një rishikim i plotë i sistemeve ekzistuese. Në një hap të dytë, do të përgatitet koncept për të ardhmen e SIIMF, i cili do të bazohet në vlerësimin e nevojave dhe potencialit për arritjen e efikasitetit të ofruar nga Sistemet Moderne të Integruara të Qeverisë për Planifikimin e Burimeve. TND-të do të luajnë një rol të rëndësishëm në analizën e nevojave dhe në fazën konceptuale, prandaj edhe ata duhet të jenë të përgatitur në dhënien e këtij kontributi.

Gjithashtu kultura e MFP-së duhet të modernizohet duke i dhënë më shumë autoritet menaxherëve të linjës, ndërkohë që fuqizon

³⁶ <https://pefa.org/sites/default/files/PEFA%20pillars%20oP%20performance.png>

³⁷ <http://dx.doi.org/10.1787/5j22rqkqhqbq-en> "Raporti i Vlerësimit të Shqipërisë 2013", Raportet e Vlerësimit të Vendit- SIGMA, 2013/14, Publikime të MPQM- së

³⁸ Fq. 6 dhe <http://intosai.org/>

mekanizmat për të siguruar përgjegjshmërinë. Paralelisht, Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit është e ndërtuar në tri shtylla: (1) parandalimi, (2) ndëshkimi dhe (3) rritja e ndërgjegjësimit ³⁹, të cilat duhet të përforcohen. TND-të janë në vijë të parë për të dyja rastet.

Strategjia e Reformës MFP thekson rëndësinë e trajnimit. Progresi në reforma do të kërkojë një investim më të lartë në kapacitetet njerëzore. Ndërtimi i kapaciteteve do të marrë shumë forma: të vazhdueshme dhe programe trajnimi *ad-hoc*, transferime të aftësi brenda programeve të binjakëzimit të BE-së me organizatat simotra, vizita studimore, rotacion punësh, etj. Provimet e kualifikimit do të përdoren në një masë më të madhe në rekrutimin e stafit të ri. Qeveria do të kërkojë mbështetje nga partnerët e saj në zhvillimin dhe financimin e shumë prej programeve të trajnimit. Në aspektin e kapitalit njerëzor TND-të ⁴⁰ do të jenë në qendër të këtij investimi.

PBA-ja, një buxhet tre-vjeçar, do të zbatojë gradualisht marrëveshjet e LOB- së në lidhje me buxhetet e programit: përshkrimi i qëllimeve, objektivat, treguesit dhe synimet, produktet dhe efektet e arritura, etj. Duke qenë se pjesa më e madhe e TND-ve do të jenë përgjegjës për një (ose më shumë) programe buxheti, ata do të duhet të kenë aftësi për t'i zotëruar ato. Moduli do t'i ndihmojë ata për të arritur pikërisht këtë gjë. Audit i Brendshëm (AB) është i rregulluar sipas Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". Për momentin janë 124 njësi (10 njësi të tjera pritet të krijohen në qeverinë vendore) auditit të brendshëm të vendosura në ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore, dhe në disa entitete të tjera pjesërisht në pronësi të subjekteve publike. Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (NjQH/AB) është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e metodologjisë dhe standardeve ⁴¹ të AB-së. Në kuadër të

anëtarësimit në BE, TND-të do të jenë në qendër të gjurmëve të auditimit të BE-së dhe të ndërgjegjësimit të tyre për rëndësinë thelbësore të AB-së TND4 është një modul 5 javor që ndahet në 3 nën-module: Menaxhimi i Financave Publike, Prokurimi Publik dhe Partneriteti Publik-Privat.

Pamje e Përgjithshme: 7,5 ditë, 5 module nga 1,5 ditë, përfshirë vlerësimin dhe informimin paraprak

TND4.1	Menaxhimi Financiar Publik (MFP- 6 ditë apo 3 fundjava me nga 1,5 ditë)
TND4.2	Prokurimi Publik (1,5 ditë)
TND4.3	Partneriteti Publik Privat (1,5 ditë)

Bashkë me Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, fusha e Çështjeve Financiare Publike është një nga dimensionet më sfiduese në punën e TND-së. Për këtë arsye të gjitha temat e mësipërme do të adresohen për t'i ndihmuar ata të përballojnë sfidat e shumta, sidomos gjatë periudhës së para anëtarësimit në BE dhe në veçanti për negocimin e kapitujve të anëtarësimit.

Metodologjia do të jetë e përzier me disa të dhëna teorike nga trajnuesit mbi pjesët më teknike të MFP-së dhe sa më shumë raste studimore të jetë e mundur, shqiptare dhe nga vendet e BE-së, shkëmbime eksperiencash mes TND-ve, meqë disa prej tyre do të zotërojnë plotësisht temën dhe do mund të ndihmojnë të tjerët në këtë proces. Ndoshta TND-të nuk do të përfshihen në këtë mënyrë bashkëpunuese dhe pjesëmarrëse që ka të bëjë me përthithjen e njohurive dhe zbatimin e tyre dhe kjo gjë do të jetë një sfidë tjetër për ata!

³⁹ Aneksi 4

⁴⁰ Strategjia e Reformës së MFP- së fq.17

⁴¹ Strategjia e Reformës së MFP- së fq. 61

TND4.1 MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE

Prezantimi dhe Objektivat

Menaxhimi i Financave Publike është një nga modulet më të rëndësishme sidomos gjatë periudhës së Anëtarësimit dhe përfshin negocimin e 35 kapitujve me dimension financiar të madh apo të vogël.

Temat Kryesore

Pamje e përgjithshme e kuadrit ligjor Shqiptar ⁴²

Baza e përgatitjes dhe ekzekutimit të buxhetit, PBA dhe IFMIS

Politikat fiskale për nivelet qendrore dhe vendore të qeverisjes (decentralizimi)

Kriteret e BE- së për hyrje në Euro

Auditi dhe Kontrolli

Vlerësimi i SHPPF dhe shtatë shtyllat e performancës së MFP- së

Menaxhimi i Riskut

Strategjia për Reformën e MFP- së dhe përgjegjshmëria

Roli i TND në sistemin e menaxhimit financiar

Ligji Organik i Buxhetit dhe Ligji Nr.9936/ 2008, i ndryshuar, mbi Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë janë elementë themeltarë. Nëpërmjet rasteve studimore dhe diskutimeve në grupe të punës, moduli do të ndihmojë TND-të të identifikojnë elementet për të cilët ata realisht kanë nevojë në punën e tyre të përditshme.

SHPPF 2011- *Shpenzimet Publike dhe Përgjegjshmëria Financiare* - Vlerësimi ⁴³ ka konstatuar se MFP në Shqipëri është përmirësuar ndjeshëm që nga viti 2006 ⁴⁴ . Në vitin 2016, SHPPF ka identifikuar "Shtatë Shtyllat e Performancës", një strukturë vlerësimi shumë e rëndësishme që mbulon të gjithë gamën e çështjeve të MFP.

Rishikimi i bazave të përgatitjes dhe zbatimit të Buxhetit të Shtetit (i gjithë cikli buxhetor) do të jetë një rast për të shqyrtuar buxhetin e BE-së dhe të disa shteteve anëtare të BE-së. Ligji francez mbi ligjet financiare, i quajtur "LOLF" ⁴⁵, i votuar në vitin 2001 dhe hyrë në fuqi në vitin 2005, është një shembull i mirë. Ai ka revolucionarizuar MFP franceze, duke prezantuar buxhetin disa vjeçar dhe program buxhetor.

Buxheti disa vjeçar është prezantuar gjithashtu edhe në MFP shqiptare nga Strategjia e Reformës ⁴⁶ . Programi i Buxhetit Afatmesëm mbartet për tre vite. Kjo është një risi shumë e rëndësishme që ka si qëllim organizimin e angazhimeve të kontratave disa vjeçare duke shmangur mundësitë për zhvillimin e borxheve të reja dhe përmirësimin e cilësisë

⁴² <http://www.financa.gov.al/al/newsroom/ligje/ligji-nr-10-296-date-08-07-2010-i-ndryshuar-me-ligjin-nr-110-2015-date-15-10-2015-per-menaxhimin-financiar-dhe-kontrollin-i-unifikuar&page=1>

⁴³ <https://pefa.org/SHPPF: Përmirësimi i Menaxhimit Financiar Publik. Mbështetja e Zhvillimit të Qëndrueshëm>

⁴⁴ Shiko SHPPF fq. 81- 82 dhe Planin e Veprimit të MFP- së dhe Strategjisë së Reformës të MFP- së fq. 84- 109

⁴⁵ <https://www.legifrance.gouv.fr/affichTexte.do?cidTexte=JORFTEXT00000394028>

⁴⁶ <http://docplayer.net/11584656-Republic-of-albania-ministry-of-finance.html>

së kërkesave buxhetore. Gjithashtu, PBA-ja do të paraqes gradualisht programet e buxhetit me përshkrimet përkatëse për qëllimet, objektivat, treguesit dhe synimet, rezultatet e pritshme dhe rezultatet e arritura, etj. PBA do të sigurojë përgjegjshmërinë e Ministrave të Linjës/ Titullarët e institucioneve qendrore buxhetore para Parlamentit gjatë çdo faze të ciklit buxhetor. Ligji i Buxhetit vjetor (2016-2020) përfshin tashmë objektivat e politikave të institucioneve dhe nivelet e programeve. Ky ligj adreson buxhetimin me Bazë Gjinore (2014-2020) dhe angazhim për kontrollet shumëvjeçare.

Një nga çështjet kyçe në zhvillimin ekonomik është si vendet mund të financojnë rritjen e tyre. Kjo nënkupton politikat fiskale përkatëse dhe të mjaftueshme, me një përhapje të balancuar ndërmjet tatimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta dhe ndërmjet taksave qendrore kombëtare dhe taksave vendore, apo thënë ndryshe decentralizimit. Një menaxhim i mirë i presionit fiskal është gjithashtu thelbësor dhe programet njehsuese të paraqitura mund të sigurojnë kohezionin ekonomik, social dhe territorial të vendit. Fondet strukturore të BE-së janë të bazuara në parimin e barazimit të solidaritetit. Mbledhja dhe shpërndarja e të ardhurave tatimore dhe doganore është një çështje kyçe që TND-të duhet të adresojnë. Masat fiskale janë konsideruar shpesh si pengesa për zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe mund të rezultojnë në një rritje të sektorit jo formal. TND-të do të mundohen të shohin anën tjetër të taksave, stimujve të zhvillimit dhe të mendojnë gjithashtu rreth shmangies së evazionit fiskal.

Në kontekstin e para-anëtarësimit, duke qenë se Traktati i BE-së tashmë parashikon që Vendet Anëtare duhet të zbatojnë politikën monetare të BE-së dhe të miratojnë monedhën e BE-së, kriteret e Euro-s dhe Pakti i Stabilitetit do të studiohen së bashku me disa kriza, si rasti i situatës së borxhit publik të Greqisë dhe monitorimi nga Brukseli i mos-respektimit

të tavanit deficit prej 3% nga disa Vende Anëtare.

Auditimi dhe kontrolli janë në qendër të qeverisjes së mirë. Përballë deficitit në rritje dhe krizat ekonomike, autoritetet publike duhet të racionalizojnë MFP. Përdorimi i fondeve publike duhet të monitorohet më mirë dhe metodat e përdorura nga bizneset, si kontrolli financiar dhe analiza e kostos, duhet të adoptohen. Dallimi ndërmjet auditimit dhe kontrollit, të brendshëm apo të jashtëm, duhet të shpjegohet në mënyrë të qartë për TND-në, duke e mbështetur këtë shpjegim me shembuj. Auditimi i brendshëm është një aset i rëndësishëm për një organizatë duke qenë se ai mundëson identifikimin se diçka mund të kryhet gabim apo në mënyrë jo efektive që në një fazë të hershme dhe mundëson kryerjen e ndryshimeve të brendshme. AB është një instrument parandalimi. AB do të ndihmojë auditimin e jashtëm që të përmirësojë cilësinë e kontrollit të brendshëm në mënyrë që të reduktohen ndërrhyrjet e kontrollit të jashtëm si kontrole të detyrueshme. Në kontekstin e pranimit në BE, është e nevojshme një pasqyrë nga sistemi i auditimit të BE-së për TND-të, sidomos Gjykata e Llogarive e BE-së në Luksemburg - vendimet e së cilës zëvendësojnë gjykatat kombëtare të llogarive ose zyrate të auditimit të Vendeve Anëtare.

Në Shqipëri, AB rregullohet me Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". Ka rreth 124 njësi (10 njësi të tjera pritet të krijohen në qeverinë vendore) të AB në ministrinë e linjës, institucionet e qeverisë qendrore, qeveritë lokale dhe disa subjekte të tjera me pronësi pjesërisht publike. Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (DH/AB), e themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave, është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e metodologjisë dhe standardeve të AB. Kjo është një pasuri e madhe për Shqipërinë, por funksioni i AB-së duhet të profesionalizohet edhe më tej. Për këtë qëllim do të organizohet një program i vazhdueshëm zhvillimi

profesional (PVZh) dhe cilësia e funksionit të AB-së do të rishikohet në bazë të një udhëzimi për Sigurimin e Cilësisë. DH/AB do të krijojë një rrjet të titullarëve të njësive të auditimit të brendshëm. TND do të duhet të mbështesin këtë lëvizje për qeverisjen e mirë dhe të ndihmojnë iniciativat e AB-së në institucionet e tyre.

AB është gjithashtu një mjet i fuqishëm në luftën e parandalimit të korrupsionit dhe një nxitje e madhe për ndryshim në kulturën e MFP-së, duke i dhënë më tepër autoritet menaxherëve të linjës dhe kështu duke forcuar mekanizmat për sigurimin e përgjegjshmërisë. Paralelisht, Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit, është ndërtuar në tri shtylla: (1) parandalimi, (2) dënimi dhe (3) ndërgjegjësimi⁴⁷; kjo luftë duhet të forcohet. Transparenca, komunikimi, informacioni dhe një përqaasje e hapur do të jenë përgjigja. Gjithashtu, TND-të janë përsëri në plan të parë. Menaxhimi i riskut është gjithashtu nën përgjegjësinë e tyre dhe koncepti do të paraqitet me fazat e procesit të menaxhimit të riskut dhe disa ushtrime veçanërisht në vlerësimin e riskut dhe vendimet që do të merren pas analizës së riskut.

Së fundmi, Sistemi i Integruar i Informacionit për Menaxhimin Financiar (SIIMF) do të mbështesë të gjitha funksionet e MFP-së: planifikimin dhe buxhetimin, programin dhe menaxhimin e projekteve, menaxhimin e kontratave, transfertat brendapërbrenda qeverisë, menaxhimin e shpenzimeve dhe kontrollin, duke përfshirë menaxhimin e pagave, kontabilitetin, menaxhimin e thesarit, dhe parashikimin e likuiditetit. SIIMF do të menaxhojë gjithashtu integrimin me sistemet ekzistuese në administratën tatimore dhe doganore, Autoritetin e Prokurimit Publik dhe me sistemin e menaxhimit të borxhit. Një portal online do të krijohet për publikun.

Metodologjia

Pjesa më e madhe e TND-ve ka disa njohuri në Financat Publike dhe disa prej tyre mund edhe të jenë specialistë të fushës. Moduli do të përftojë nga njohuritë ekzistuese dhe mënyrën e zbatimit për të shkuar një hap më tej duke thelluar punën për pranimin në BE dhe për të përfituar nga ekspertiza e disa personave dhe përhapja e njohurive në disa persona të tjerë që mund të jenë specialistë në fusha të tjera. Informacion teknik do të alternohet me punën në grup, diskutimet dhe rastet studimore nga Shqipëria, Vendet Anëtare dhe BE. Pjesa më e madhe e shkëmbimit të njohurive do të ndodhë midis TND-ve, të cilët do të kenë një frymë pozitive të drejtuar ndaj arritjeve.

TND4.2 PROKURIMI PUBLIK

Prezantimi dhe Objektivat

Duke marrë në konsideratë prokurimin publik për të mirat materiale dhe shërbimet, u krijua Komisioneri i Prokurimit Publik (KPP) me qëllim koordinimin e sistemit të PP me sistemin e prokurimit të BE-së. KPP u krijua nga Ligji i PP si organi më i lartë në prokurimin publik, i cili siguron mbrojtje ligjore për tenderët dhe interesin publik gjatë të gjitha fazave të procedurave të Prokurimit Publik, si koncesioni, ankandet dhe licencat e minierave. KPP është një organ i veçantë shtetëror kuazi-gjyqësor që ofron mbrojtje ligjore. KPP aspiron të kryej veprimet e tij në përputhje me parimin themelor të PP - transparencës dhe të drejtën e aksesit të informacionit për çdo qytetar. Faqja e internetit e KPP paraqet gjithë legjislacionin e kësaj teme⁴⁸. Gjithashtu, tashmë po fillon edhe Prokurimi Elektronik.

⁴⁷ Aneksi 4

⁴⁸ <http://kpp.gov.al/ppadv/Legjisllacioni.aspx>

Duke qenë se tashmë Shqipëria është një vend kandidat për BE, Direktiva 2014/24/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 26 shkurt 2014 mbi prokurimin publik, e cila ka shfuqizuar Direktivën 2004/18/EC⁴⁹, do të aplikohet së shpejti dhe Shqipëria do të duhet ta transferojë atë në ligjin e saj kombëtar. Autoritetet shqiptare e konsiderojnë këtë hap të kryer. Negociatat mbi kapitujt do të përfshijnë një shikim të legjislacionin të prokurimit publik dhe, nëse është e nevojshme, do të mund të duhen disa ndryshime.

PP punon me shuma të mëdha parash të cilat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve publike kombëtare. Rregullorja e PP synon të sigurojë një përdorim efikas të fondeve publike dhe të garantoj korrektësi dhe drejtësi. E themeluar mbi respektimin e rregullave të konkurrencës, ajo garanton transparencë e cila nxit rritjen ekonomike.

Temat Kryesore

TND duhet të kenë një njohuri të përgjithshme mbi prokurimin publik. Moduli do të trajtojë çështje sipas këndvështrimit të TND-së, sidomos për sa i përket kontrollit të Termave të Referencës dhe Strukturave të Marrëveshjeve, të cilat duhet të jenë të përgatitura shumë mire:

Parimi i Shpërblimit

Përfshirje të Veçanta

Blerje të Centralizuara

Vendime kyçe mbi zgjedhjen e procedurës, duke përfshirë prokurimin elektronik, kualifikim tenderi, kriteret e dhënies së kontratave, anomali në tender dhe marrëveshja kuadër

Përfshirje

Rishikimi i Procedurës Administrative, hetime administrative dhe sanksione në lidhje me ligjin e prokurimit publik

Përgjegjësitë në Autoritetin Kontraktues- si bëhet ndarja ndërmjet zyrtarëve të ndryshëm

Mundësia për të diskutuar disa nga dilemat e drejtuesve të nivelit të lartë - si të zbatohen të gjitha detyrimet e vendosura nga ligji, por gjithashtu si të jemi efikas ndaj kostos?

Një rëndësi e veçantë do të vendoset gjithashtu mbi procedurat e blerjes dhe teknikat për një gamë të gjerë të pajisjeve dhe shërbimeve në fusha të tilla si ndërtimi dhe inxhinieria civile, shërbimet e IT-së dhe pajisjet, dhe shërbimet intelektuale. Gjithashtu, do të rishikohet zbatimi i rregullave dhe mjetet në dispozicion për të luftuar korrupsionin. Kontratat publike dhe partneriteti publik privat do të shqyrtohen në modulin tjetër. Do të paraqiten rekomandimet e hartuara nga organizatat ndërkombëtare dhe do të kryhet krahasimi i procedurave (ndërkombëtarizimi i thirrjeve për tender; harmonizimi i rregulloreve për VA të BE-së). Gjithashtu, do të jenë prezentë edhe rekomandimet e lëna nga organizatat ndërkombëtare dhe krahasimi i procedurave (internacionalizimi i thirrjeve për tender; harmonizimi i rregulloreve për VP BE). Do të përcaktohen edhe rregullat e konkurrencës.

Metodologjia

Duke qenë se Prokurimi Publik është një temë shumë teknike, do të përdoret mënyra tradicionale e transferimit të njohurive dhe raste

⁴⁹ OJ L 94, 28.3.2014, p. 65-242, <http://eurlex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32014L0024&from=EN>

studimore reale, nga Shqipëria dhe vendet e BE-së. Do të inkurajohen diskutime ndërmjet TND për të shkëmbyer ekspertizë dhe praktikat e mira duke përfutur qartazi nga shkëmbimet dhe ekspertiza e TND-ve të specializuar në prokurimin publik.

TMC4.3 PARTNERITETI PUBLIK PRIVAT (PPP)

Prezantimi dhe Objektivat

Ligji i PPP në Shqipërisë u zëvendësua në vitin 2013 me Ligjin 125/2013 "Për koncesionet dhe Partneritetet Publike Private", i ndryshuar në 2015 (Ligji 77/2015). Ligji parashikon një kuadër ligjor të qëndrueshëm për koncesionet e të gjithë sektorëve. Disa institucione ndajnë përgjegjësitë e politikave të lidhura të prokurimit. Një njësi koncesioni e njohur si ATRAKO⁵⁰ është në krye të shërbimeve këshilluese dhe monitoruese për çështjet teknike. Agjencia e Prokurimit Publik (APP) mbikëqyr projektet, promovon legjislaionin dhe ngritjen e kapaciteteve. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat dhe Mbrojtësi i Prokurimit Publik monitoron pajtueshmërisë procedurale. Pavarësisht kapacitetit dhe përvojës së këtyre institucioneve për planifikimin dhe prokurimin e PPP-ve, ndershmëria në dhënie dhe zbatimin e projekteve të PPP nuk është aspak e kënaqshme, veçanërisht në nivelin vendor.

Në 20 vitet e fundit, Qeveria Shqiptare ka mbështetur zhvillimin e sektorit privat kryesisht nëpërmjet privatizimeve, koncesioneve dhe procedurave rregulluese për të lehtësuar veprimet e biznesit. Investimet e sektorit privat në infrastrukturë janë inkurajuar që prej vitit 1996 dhe ndërmjet 2001-2011 Shqipëria ka zbatuar PPP në sektorin e energjisë,

transportit, dhe ujërave. Së fundmi, Qeveria ka kërkuar të arrijë qëllimet kryesore kombëtare të zhvillimit ekonomik përmes PPP-së në mënyrë që të sigurojë fonde brenda kufizimeve të buxhetit dhe të ul shpenzimet publike, për të zgjeruar investimet në infrastrukturë si një drejtues i zhvillimit ekonomik, për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, efikasitetit dhe promovimin e menaxhimit publik të sektorit dhe për të arritur efikasitet më të lartë në përdorimin e burimeve duke përfshirë një partner privat dhe vlerësimin komercial të aseteve publike.

Duke qenë se akoma nuk ka një strategji të qartë të dokumentuar zyrtarisht, prezantimi i politikës së Qeverisë mbi PPP-në dhe kuadri ligjor, është ajo çka drejton strategjinë e përgjithshme. Pjesa më e madhe e ministrive të linjës kanë hasur sfidë në arritjen e një progresi real për zbatimin e projekteve të PPP- së, duke qenë se nuk ka një politikë të qartë për nivelet e larta drejtuese, e cila përcakton sektorët, shërbimet, dhe format e PPP-së që do të mbështeten në Shqipëri.

Temat Kryesore

Në këtë kontekst, ajo çka duhet të dijë TND-ja mund të jetë:

Synimi i shërbimeve dhe punëve që do të mundësohen Brenda Koncesionit/ PPP

Procedurat e Koncesionit /PPP- cilat janë grackat e mëdha?

Roli i Njësisë së Koncesionit/ PPP në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencisë së Prokurimit Publik

⁵⁰ Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, ATRAKO u krijua në vitin 2007 dhe mbështeti autoritetin kontraktues gjatë procedurave nëpërmjet një studimi mbi fizibilitetin, hartimit të procedurave të tenderimit, vlerësimit të ofertave dhe në negocime. <http://www.atrako.gov.al/http://www.atrako.gov.al/wpcontent/uploads/2015/06/Albanian-ppp-key-aspects2.pdf> <https://pppknowledgegelab.org/countries/albania>


Rëndësia e një studimi të mirë mbi fizibilitetin – nevoja e madhe për të pasur ekspertë të mirë të fushës

Rregullat për dhënien e punëve shtesë dhe shërbimeve të koncesionarëve / partnerëve private

Rishikimi i Procedurave Administrative dhe kritereve të vlerësimit

Metodologjia

Duke qenë se PPP është një temë shumë teknike, do të përdoret mënyra tradicionale e transferimit të njohurive dhe raste studimore reale, nga Shqipëria dhe vendet e BE- së. Do të inkurajohen diskutime ndërmjet TND për të shkëmbyer ekspertizë dhe praktikat e mira duke përfutur qartazi nga shkëmbimet dhe ekspertiza e TND-ve të specializuar në PPP, dhe gjithashtu të kontribuojnë në Strategjinë e PPP-së për Shqipërinë.



TMC5 INOVACIONI I ADMINISTRATËS

Reforma e Administratës Publike dhe ajo e Menaxhimit të Financave Publike adresojnë çështjet e modernizimit të AP dhe MFP- dhe pjesa më e madhe e tyre kanë një dimension novator. Shqipëria ka një Ministri përgjegjëse për Administratën Publike dhe Inovacionin, e cila është në qendër të Strategjisë së BE-së 2020, dhe ka si qëllim të qenit “e zgjuar”. Shumë vende kanë modernizuar administratën e tyre për shërbime radhe, por inovacioni në administratë është një risi e sjellë nga prezantimi i kompjuterit personal nëpër zyra, 30 vjet më parë. Megjithatë, inovacioni nuk mbetet vetëm te kompjuterët. Menaxhimi Publik i Ri (MPR), i cili u prezantua në fillim të viteve 80 në Mbretërinë e Bashkuar, ishte kryesisht i fokusuar në organizim dhe menaxhim- kompjuterët mbetën ajo çka janë, thjesht mjete.

Objektivat e modulit të trajnimit mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Një prezantim i përgjithshëm i Qeverisjes Elektronike me shembuj të praktikave të mira nga Shqipëria, BE-ja dhe pjesa tjetër e Botës (si p.sh. renditja vjetore e shteteve më të mira nga OKB);
- Identifikimi i shërbimeve të administratës publike që duhet të kryhen për të zbatuar Axyhendën Dixhitale të Shqipërisë;
- Si të zbatohet në mënyrë të suksesshme një projekt elektronik dhe si të shmangen grackat;
- Ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve që qëllimi nuk është përdorimi i TIK; ato janë vetëm mjete;

- Për të prezantuar mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë ndryshimet në ligjin shqiptar me qëllim përafrimin me Rregulloren e Mbrojtjes së të Dhënave të BE- së, dhe Sigurisë së IT- së;

- Për të kuptuar rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave dhe përgjegjësinë e TND- së lidhur me këtë çështje;

- Për të ndërgjegjësuar TND-në mbi të dhënat që ata mbajnë përgjegjësi dhe çfarë mund të bëhet në rast se ata nuk kryejnë Sigurimin e IT- së ashtu siç duhet;

- Për të ndihmuar TND- në të kuptojë më tej si mund të përmbushen objektivat sektorial të tyre (arsimi, shëndeti, mbrojtja etj.) dhe detyrimet e tyre në lidhje me Sigurinë e IT- së dhe Mbrojtjes së të Dhënave.

Duke marrë në konsideratë dimensionin novator të kursit në perspektivën e përmbajtjes dhe metodologjisë, trajnuesit dhe menaxherët e trajnimit nga ASPA do të informohen për të maksimizuar të dhënat e marra nga të trajnuarit. Nëse është e mundur, e njëjta metodologji do të përshtatet për tre nën-module në mënyrë që pjesëmarrësit të mësohen me mënyrën e re të të mësuarit aktiv. Në të njëjtën mënyrë, nëse është e mundur, seancat e trajnimit do të jenë të ndara në dy pjesë për çdo lëndë: trajnimi fillestar në formën e një seance të mësuarit online (*e-learning*) dhe pas kësaj, një seancë ballë për ballë (*face-to-face*) të trajnimit. Përdorimi i internetit do të inkurajohej sepse do t'i ekspozonte ata ndaj gjuhëve të huaja, sidomos gjatë analizimit të rasteve studimore nga vendet e tjera të BE-së. Gjithashtu, trajnuesve do t'u lihet mjaft fleksibilitet për të kapitalizuar ekspertizën, pasi ata vetë mund të përfitojnë nga TND-të.

Pamje e Përgjithshme: 4,5 ditë, 3 module nga 1,5 ditë, përfshirë vlerësimin dhe informimin paraprak

TND5.1	Qeverisja Elektronike
TND5.2	Siguria e IT- së
TND5.3	Mbrojtja e të Dhënave

Ndryshimi midis të mësuarit në mënyrë elektronike dhe trajnimit tradicional ballë për ballë, do të organizohet nga trajnuesit sipas kushteve të trajnimit dhe audiencës. Është veçanërisht i rëndësishëm përdorimi i metodave ndërvepruese, diskutime në grupe të vogla, prezantime të shkurtra të praktikave më të mira, etj. Për shkak të specifikës së lëndës, mund të jetë e këshillueshme të kontrollohet së pari nëse TND-të zotërojnë konceptet themelore të përpunimit të të dhënave dhe të software bazë (WORD, Excel dhe PowerPoint), dhe nëse ata përdorin mediat sociale (LinkedIn, Facebook, Twitter , etj.) dhe në çfarë gjuhë.

Këshillohet gjithashtu dhe përdorimi i mjeteve TIK (film, platformë moodle, prezantim ndërveprues, MOOC, etj.) me një ekspert të fushës apo nëpërmjet një Zyre Shërbimi (help desk) për zgjidhjen e problemeve. Mjeti duhet të përgatitet në një mënyrë të tillë që lejon ASPA-n të menaxhojë trajnimin, jo vetëm për ta vendosur atë online, por edhe për ta ndjekur dhe monitoruar pjesëmarrjen në mënyrë që të sigurohet mbi marrjen e njohurisë nga të gjithë, në lidhje me trajnimin elektronik, para se të vijin në sesionin e zhvilluar nga ASPA.

TND5.1 QEVERISJA ELEKTRONIKE

Prezantimi dhe Objektivat

Disa TND tashmë mund të jenë profesionistë të Qeverisjes Elektronike, duke qenë se mund të kenë marrë pjesë në hartimin Strategjisë së Axhendës Digjitale ose Portalit Shqipëria Elektronike. Nga ana tjetër, ekspertiza e juristëve apo specialistëve financiar në grup duhet të kapitalizohet si një aset për sesionit e trajnimit në një frymë të favorshme për të gjithë ndaj punës në grup.

Administrata Elektronike tani është rreth 30 vjeç dhe disa vende janë tepër të avancuara në këtë fushë. Shumë prej gjërave do të mësohen nga përdorimi i internetit dhe nga praktikat më të mira. Kompjuterizimi i administratës publike - dhe "de- materializimi" i dosjeve, bashkë me thjeshtimin e procedurave dhe menaxhimin e tyre në mënyrë elektronike, kanë revolucionarizuar kulturën administrative. Renditja e OKB-së për vitin 2014 ka vendosur Francën në vend të parë, për sa i përket Evropës dhe në vendin e 4 në renditje botërore, pas Koresë së Jugut, Australisë dhe Singaporit ⁵¹. Shumë gjëra mund të bëhen në mënyrë elektronike, në mënyrë që të maksimizohet trajnimi.

Temat Kryesore

Sesioni 1 (online) - Çfarë do të thotë Axhendë Dixhitale për Administratën Publike Shqiptare?

1. Axhenda Dixhitale për Evropën - Strategjia 2020

⁵¹ OJ L 94, 28.3.2014, p. 65-242, <http://eurlex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32014L0024&from=EN>

2. Strategjia Ndër-Sektoriale "Akhenda dixhitale e Shqipërisë 2015-2020": (1) qeverisja online në Shqipëri sot, (2) Vizioni dhe objektivat e politikave, (3) Produktet kryesore të strategjisë, (4) burimet financiare, (5) Monitorimi dhe vlerësimi, (6) pozicioni i TND-ve?

3. Pamje e përgjithshme e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Qeverisjen Elektronike;

4. Disa shembuj të Qeverisjes Elektronike:

- a. Shërbimet G2G (nga Qeveria në Qeveri)– procesi ligjor pa dokumentacion
- b. Një portal i fokusuar në përshtatshmërinë e tij me qytetarin, portal i administratës publike franceze www.mon.service-public.fr, rasti i Singaporit www.gov.sg
- c. Pikat e Shërbimit me një ndalesë (në qeverisjen vendore të Mbretërisë së Bashkuar–Njësia Bashkiake Wirral)
- d. Zyra e Shërbimit– si mund të ndryshoj menaxhimi elektronik i dokumenteve punën e nëpunësve civil, dhe si do të mund të ndihmonte në strategjinë e antikorrupsionit
- e. Shembuj të tjerë mund të gjenden: <http://www.egov4dev.org/success/case/>

Seksioni 2 (në ASPA, ministri tjetër, apo organizatë) - Çfarë po ndodh në subjektin e ligjit për Qeverisjen Elektronike, Shërbimet Elektronike, etj. dhe cilat mjete TIK mund të përdoren nga TND-ja në mënyrë efektive?

1. Shërbimet Elektronike: si të përgatitën në mënyrë që mos të hasim "dixhitalizimin e burokracisë"? Cilat janë 4 nivelet e bashkëveprimit (informacioni online, transaksion i njëanshëm, transaksion i dyanshëm dhe ndërveprimi) dhe si do të duket?

2. Ndryshime në ligjin për Shërbimin Elektronik, Nënshkrimin Elektronik dhe ligje apo akte nënligjore të tjera– çfarë do të thotë kjo për TND-në, çfarë pritet prej tyre?

3. Mjetet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

për Menaxhimin në Shqipëri – prezantim sipas pikëpamjes së TND-ve:

- a. Sistemi elektronik i menaxhimit të dokumentacionit (faza pilot)
- b. GovNet (platform government gateway)
- c. e-Albania: portal për qytetarët dhe bizneset për më tepër transparencë dhe më pak korrupsion
- d. Një mjet për të menaxhuar projektet ("Microsoft Project" ose të tjera)
- e. Mjete të tjera TIK të përdorura në Administratën Publike në Shqipëri

4. Zbatimi i mjeteve të reja të TIK në organizatë – si duhet të duket procesi në mënyrë që të arrihen qëllimet e tij– diskutim në grup

Metodologjia

Informimi nga trajneri dhe sa më shumë trajnime elektronike të jetë e mundur, raste studimore, diskutime në grup, përdorim i gjerë internetit - me përfitim ekspozimin ndaj gjuhëve të huaja, sidomos ndaj gjuhës angleze dhe asaj frënge. Gjithashtu, mund të organizohet një vizitë në terren.

TND5.2 SIGURIA NË LIDHJE ME TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT

Prezantimi dhe Objektivat

Siguria e IT-së përballet sot me dy kërcënime, dështimi teknik dhe sulmet kriminale. Me progresin teknik kompjuterët, rrjetet dhe të gjithë IT hardware dhe software janë bërë të besueshme dhe elastike. Por, me sulmet masive kibernetike të fundit ndaj serverëve tepër të rëndësishëm në organizatat publike dhe private, siguria e IT-së është bërë një çështje strategjike dhe një sfidë menaxheriale për TND-të, të cilët jo gjithmonë janë të përgatitur mirë për t'u përballur me këtë dobësi të re.

Objektivat e trajnimit do të jenë:

- Për të ofruar njohuri mbi sigurinë e IT-së dhe për të ofruar kuptueshmëri të plotë të rregullave për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurisë së IT-së
- Për të dhënë një pasqyrë se si të punojmë në mënyrë efikase me menaxherin e IT-së dhe Specialistin e Mbrojtjes së të Dhënave (nëse ka);
- Për të bërë pjesëmarrësit të vetëdijshëm se mbrojtja e të dhënave personale dhe siguria e IT-së janë të rëndësishme në çdo pjesë të punës së bërë në administratën publike, pavarësisht nga ministria, mjedisi, arsimi, infrastruktura, shëndeti, etj.
- Për të ndihmuar menaxherët e lartë të vlerësojnë në mënyrë të paanshme raportet e menaxherëve të tyre të IT-së dhe të ndihmojnë ata të maksimizojnë kontributet e departamentit të IT.

Temat Kryesore

Trajnimi parashikon një hyrje të përgjithshme e cila krijon lidhjen midis mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë në IT:

Hyrje në të Dhënat e Sigurimit (siguria e IT-së) nga këndvështrimi i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues:

Kërcënimet e IT-së për të dhëna, kryesisht viruset dhe sulmet kibernetike –për çfarë jemi përgjegjës në të vërtetë?

Rëndësia e të dhënave të përpunuara nga institucionet publike - çfarë mund të ndodhë në qoftë se institucioni nuk i ka siguruar të dhënat? Sa mund të kushtojë për të marrë përsëri këto të dhëna (në qoftë se është e mundur!)?

Si mund të kontrolloj një Drejtues i Nivelit të Lartë nëse institucioni ka procedura të mira mbi sigurinë e IT-së (për shembull procedura për një sulm kibernetik, procedurat e backup, vazhdimësia e punës, menaxhimi i krizave që kanë të bëjnë me mungesën e sistemeve të IT- së), dhe në qoftë se ata punojnë vërtet? A mund të pyesin ata Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit apo ndonjë institucion tjetër për të kërkuar ndihmë (për të bërë auditimin e parë dhe pastaj për ta përsëritur atë një herë në vit)?

Si mund të kontrollojnë Trupën e Nivelit të Lartë nëse punonjësi i IT-së siguron të dhënat dhe sistemet në mënyrën e duhur?

Sa të mbrojtura janë procedurat e nënshkrimit elektronik ose pagesa elektronike (taksat), nëpërmjet IT- së si një mjet për dërgimin dhe marrjen e dokumentacionit të nënshkruar në mënyrë elektronike mes institucioneve publike)

Metodologjia

Informimi nga trajnuesi për më tepër tema teknike - me ndihmën e njohurive të TND- së lidhur me temën, nëse ka njohuri. Puna në grup për shkëmbimin e ideve dhe mendimeve.

Raste studimore të kohëve të fundit për të përshkruar situatat, analizuar dobësitë e sistemeve të IT- së të sulmuara, analizuar reagimet, përlogaritur koston e incidenteve (teknike, penale, etj.).

TMC5.3 MBROJTJA E TË DHËNAVE

Prezantimi dhe Objektivat

Mbrojtja e të dhënave ka filluar të shfaqet si një çështje e rëndësishme në mesin e viteve 70. Në Britaninë e Madhe u publikua një raport i rëndësishëm lidhur me "Kompjuterët dhe privatësinë". Kështu që, në të gjithë Evropën, qytetarët filluan të reagojnë dhe të kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre nga "Big Brother"⁵².

Rasti i Francës është i vlefshëm të studiohet. Në vitin 1973 u krijua Avokat i Popullit, fillimisht i quajtur Médiateur de la République, i zëvendësuar më pas nga Défenseur des droits në vitin 2011. Në vitin 1978, u krijua Komisioni Kombëtar për Përpunimin e të Dhënave dhe Lirisë⁵³ për të trajtuar çështjen e mbrojtjes së të dhënave - sot trajtohen në "mburojë të privatësisë" dhe CADA⁵⁴, Komisioni mbi të Drejtën e Aksesit të Dokumenteve Administrative, të krijuar me ligj. Gati 40 vjet më vonë,

këto dy komisione janë ende tepër aktive dhe kanë rol mbrojtës. Të gjitha vendet evropiane filluan të hartojnë një legjislacion të krahasueshëm dhe 10 vjet pas rënies së murit të Berlinit, vendet e ish-bllokut komunist bënë të njëjtën gjë. Kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave të BE-së u krijua për herë të parë në Direktivën 95/46 / EC, si dhe mbi të drejtat themelore për jetën private dhe mbrojtjen e të dhënave, siç parashikohet në Nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenet 7 dhe 8 të Kartës për të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian⁵⁵. Më shumë të drejta për të dhënat tuaja personale⁵⁶. Rregullorja e fundit e BE-së, Rregullorja (Eu) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, më datë 27 prill 2016 mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, si dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46 / EC (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave), së shpejti do të integrohet në ligjin shqiptar - siç thuhet nga Zyra e të Drejtës për Informim dhe nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave.

Hapi tjetër janë të dhënat e hapura (open data), për të cilin është përgatitur një ligj në Francë mbi shërbimin publik për të dhëna⁵⁸, një platformë e hapur për të dhënat publike franceze⁵⁹ është krijuar, dhe Partneriteti Qeveria e Hapur (OGP)⁶⁰ mban Samitin e 4-t Global gjatë periudhës 7-9 dhjetor 2016 në Paris, me krerët e shteteve nga 70 vende: *"OGP është e angazhuar për promovimin e parimeve të qeverisjes së hapur dhe transparente nëpërmjet konsultimeve dhe pjesëmarrjes civile, duke përforcuar integritetin publik dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe duke rritur qasjen në teknologjitë e reja për të nxitur demokracinë, duke nxitur risi dhe progres."*

⁵² Cf. George ORWELL's novel « 1984 »

⁵³ <https://www.cnil.fr/> Commission Nationale Informatique et Libertés

⁵⁴ <http://www.cada.fr/> Commission d'accès aux documents administratifs

⁵⁵ http://ec.europa.eu/justice/dataprotection/article29/pressmaterial/pressrelease/art29_press_material/2016/press_release_shield_en.pdf

⁵⁶ <https://www.cnil.fr/en/infographic-more-rights-your-personal-data>

⁵⁷ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TEXT/PDF/?uri=CELEX:32016R0679&from=EN>

⁵⁸ <https://www.etalab.gouv.fr/loi-pour-une-republique-numerique-lancement-dune-consultation-sur-le-service-public-de-la-dotnee>

⁵⁹ <https://www.data.gouv.fr/fr/> "Share, improve, use again public data"

⁶⁰ <http://www.opengovpartnership.org/events/ogp-global-summit-2016-paris>

Temat Kryesore

Struktura e Mbrojtjes të kuadrit ligjor dhe sfidat kryesore

Koncepti i të dhënave të hapura dhe operacioneve të tij

Roli i TND-së në mbrojtjen e të dhënave dhe zbatimin e të dhënave të hapura

Metodologjia

Prezantimet "Mbështetje për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP) me Trajnimin e Zyrtarëve për Mbrojtjen e të Dhënave në Sektorin Publik Shqiptar" mund të përditësohen. Rastet Studimore (të përpunimit të të dhënave nga Ministria si punëdhënëse, Zbulimi i të dhënave personale për forcat e policisë, Përpunimi i të dhënave personale nga organet tatimore, Europol, sistemet Cloud të përdorura nga një autoritet publik, Shërbime shkatërrimi të mediave të jashtme për dokumente të shkruara dhe bartës të të dhënave elektronike, Sfida të mëdha për sigurinë në pajisjet e lëvizshme, etj.) dhe hyn në rol dhe diskutime mbi Zyrtarin e Mbrojtjes së të Dhënave (OPAK) - background të BE-së, rolin dhe detyrat në Shqipëri, Ligjshmëria e Procesimit të të dhënave personale, Transferimi Ndërkombëtar i të dhënave, Delegimi i Procesimit të të Dhënave Personale, procesi i njoftimit në lidhje me bazat e të dhënave.

SHTOJCAT:

Shtojca 1: Kuadri institucional dhe ligjor i trajnimit të TND: Ligji nr. 152/2013 "Shërbimi Civil", ndryshuar sipas ligjit n° 178/2014; Rregullat mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Shkollës së Administratës Publike dhe Trajnimit të Nëpunësve Civil.

Shtojca 2: OBZHE/ OECD Struktura e Kompetencave Treguesit Kyç për Nivelin 5 apo TND.

Shtojca 3: Një rast studimor mbi metodologjinë bazuar në raste reale.

Shtojca 4: Raporti i OSBE-së Vlerësimi i Trajnimit Anti-Korrupsion Ekzistues për Administratën Publike Shqiptare dhe Kuadri për Propozimin e një Programi të Ri të Trajnimit në fushën e Anti-Korrupsionit, Modulet e Trajnimit për Zyrtarët e Nivelit të Lartë (fq. 16-18).

Shtojca 5: Lexime të mëtejshme mbi monitorimin dhe zhvillimin në karrierë pas trajnimit të menaxherëve të lartë.

Shtojca 6: Raporti PNUD 2016, Integrimi Gjinor në Projekt-Programin e Trajnimit të ASPA-s Projekt- Programi i Trajnimit të TND- ve Program.

Shtojca 1: Ekstrakt Përmbledhës mbi Mangësitë Gjinore të Identifikuara dhe Rekomandimet e Propozuara për Projekt Programin e Trajnimeve për Administratën Publike

Shtojca 2: Tabela Përmbledhëse mbi Vlerësimin e

Barazisë Gjinore dhe Rekomandimet për kurrikulën e Trajnimit të Trupës të Nivelit të Lartë Drejtues në Administratën Publike Shqiptarë, ekstrakt i tabelës.

Shtojca 7:

Një rast studimor mbi metodologjinë bazuar në raste reale.

SHTOJCA 1: KUADRI INSTITUCIONAL DHE LIGJOR I TRAJNIMIT TË TND

Ligji n° 152/2013 "Shërbimi Civil", ndryshuar sipas ligjit n° 178/2014

KREU VI

NËPUNËSIT CIVILË Ë NIVELIT TË LARTË DREJTUES

Neni 27

Trupa e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues

1. Nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore, të emëruar sipas nenit 28, të këtij ligji, përbëjnë trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (në vazhdim "TND").
2. Numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese, anëtarë të TND-së, është sa numri i pozicioneve të rregullta të kategorisë së lartë drejtuese ekzistuese në strukturat e miratuara apo të parashikuara për t'u miratuar brenda vitit buxhetor, në institucionet e administratës shtetërore, plus një rezervë prej 15 për qind e këtij numri.

3. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të TND-së përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit, ndërsa numri i anëtarëve, që do të rekrutohen çdo vit, përcaktohet në planin vjetor të rekrutimit.

4. Pranimi në TND mund të bëhet vetëm nga personat që kanë përfunduar formimin e thelluar në ASPA, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij neni dhe në nenin 30, pika 5/1, të këtij ligji.

5. Përjashtimisht, deri në daljen e grupit të parë të studentëve të ASPA-s apo kur prurjet nga ASPA nuk janë të mjaftueshme, pranimi në TND bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, sipas nenit 29 të këtij ligji.

Neni 28

Pranimi në TND nëpërmjet ASPA-s

1. Pranimi në programin e formimit të thelluar për TND-në në ASPA bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, i cili është i hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese dhe nëpunësit e nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura, si dhe për çdo individ tjetër, që nuk është pjesë e shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Procedura e pranimit në programin e formimit të thelluar organizohet nga DAP-i, në bashkëpunim me ASPA-n, sipas parimeve të nenit 20 të këtij ligji.

3. Vlerësimi i kandidatëve për pranimin në programin e formimit të thelluar për TND- në në ASPA bëhet nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes, i krijuar sipas nenit 31 të këtij ligji.

4. Vetëm kandidatët e vlerësuar mbi pragun minimal të 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit të konkursit kombëtar, sipas radhës së renditjes dhe brenda numrit të miratuar të pranimit në TND, sipas planit vjetor, pranohen të kryejnë studimet në programin e formimit të thelluar për TND-në.

5. Kandidatët, që përfundojnë formimin e thelluar, emërohen nga DAP-i si nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së, në bazë të renditjes përfundimtare.

6. Këshilli i Ministrave miraton kërkesat specifike për pranimin në TND dhe procedurën e hollësishme të pranimit në programin e formimit të thelluar në ASPA.

Neni 29

Pranimi i drejtpërdrejtë në TND

1. Pranimi në TND, në rastin e parashikuar në pikën 5 të nenit 27 të këtij ligji, bëhet drejtpërdrejt nëpërmjet një konkursi kombëtar, i cili është i hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND. Përgjatshimisht, Këshilli i Ministrave mund të vendosë që procedura e pranimit në TND të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Procedura e pranimit në TND organizohet nga DAP-i, sipas parimeve të nenit 20 të këtij ligji.

3. Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes, i krijuar sipas nenit 31 të këtij ligji.

4. Kandidatët e vlerësuar mbi pragun minimal të 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, sipas radhës së renditjes dhe brenda numrit të miratuar të pranimit në TND, sipas planit vjetor, emërohen nga DAP-i si nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së. Këshilli i Ministrave miraton kushtet dhe kërkesat specifike për pranimin në TND dhe procedurën e hollësishme të pranimit.

Neni 30

Caktimi i anëtarit të TND-së në një pozicion të rregullt

1. Anëtarët e TND-së mund të caktohen në çdo pozicion të rregullt të kategorisë së lartë drejtuese, të përcaktuar sipas pikës 4 të nenit 19 të këtij ligji, apo të caktohen koordinatorë të posaçëm.

2. Plotësimi i një vendi të lirë të kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore mund të bëhet vetëm me një anëtar të TND-së. Çdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm.

3. Një anëtar i TND-së mund të emërohet edhe në një pozicion të kategorisë së mesme drejtuese, me pëlqimin e tij dhe të DAP-it.

4. Anëtari i TND-së, i caktuar si koordinator i posaçëm apo në një pozicion të kategorisë së mesme drejtuese:

a) për dy vitet e para përfiton pagën e klasës më të ulët të kategorisë së nivelit të lartë drejtues;

b) nëse nuk është emëruar në një pozicion të rregullt për të paktën 6 muaj në 2 vitet e para, përfiton 50 për qind të

pagës së klasës më të ulët të kategorisë së nivelit të lartë drejtues, për një periudhë 2-vjeçare në vazhdim;

c) nëse nuk është emëruar në një pozicion të rregullt për të paktën 8 muaj në 4 vitet e para, ai mbetet anëtar i TND-së pa të drejtë page.

5. Një institucion i pavarur apo një njësi e qeverisjes vendore, me pëlqimin e nëpunësit dhe miratimin e Departamentit të Administratës Publike, mund të zgjedhë drejtpërdrejt një anëtar të TND-së dhe ta emërojë atë në një pozicion të kategorisë së lartë drejtuese në institucionin përkatës.

5/1. Departamenti i Administratës Publike, me kërkesë të nëpunësit të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe pas marrjes së pëlqimit të njësisë përgjegjëse në këto institucione, mund ta emërojë këtë nëpunës në një pozicion TND-je në institucionin e administratës shtetërore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të ndjekë programin e formimit të thelluar të kandidatëve për anëtarë të trupës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues në ASPA.

6. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për menaxhimin dhe lëvizjen e anëtarit të TND-së.

Neni 31

Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për TND-në

1. Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për TND-në përbëhet nga nëntë anëtarë:

- a)** një përfaqësues nga DAP-i, i cili kryeson komisionin;
- b)** dy përfaqësues nga ASPA, nga të cilët njëri jo nëpunës i ASPA-s.
- c)** një përfaqësues i TND-së;

ç) pesë personalitete të pavarura me përvojë profesionale dhe integritet.

2. Pesë personalitetet e pavarura emërohen nga Këshilli i Ministrave për një mandat 5-vjeçar, me përjashtim të anëtarëve të parë, njëri prej të cilëve, i zgjedhur me short, zëvendësohet çdo vit.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishtme për përbërjen, përzgjedhjen, vendimmarrjen dhe pagesën e anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në.

Neni 32

Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore

1. Pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore bëhet me konkurrim të organizuar për një apo disa pozicione të lira dhe është i hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese. Përjashtimisht, titullari/organi vendimmarrës i institucionit mund të vendosë që procedura e pranimit të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më shumë se 15 për qindtë numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për atë institucion. Çdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm.

2. Konkurrimi organizohet në përputhje me nenin 20 të këtij ligji nga njëjësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për krijimin, përbërjen dhe veprimtarinë e komiteteve të përhershme të pranimit, si dhe rregullat e hollësishme për procedurën e pranimit dhe vlerësimin e kandidatëve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr.138, datë12.03.2014

PËR

RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TE FUNKSIONIMIT TE SHKOLLËS SHQIPTARE TE ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNESVE CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 9 e 69, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave vendosi:

KREU III

PROGRAMET E OFRUARA NGA ASPA DHE TARIFAT

1. ASPA ofron programet e trajnimit të thelluar, të vazhdueshëm dhe të përgatitjeve paraprake për kandidatët jashtë shërbimit civil.

2. ASPA ofron programin e formimit të thelluar për kandidatët për kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së, pa pagesë. Ky program është i detyrueshëm të ndiqet.

3. ASPA ofron, pa pagesë, programin e formimit të thelluar për anëtarët e TND-së të pranuar sipas nenit 29, të ligjit nr.152/2013. Ky program është i detyrueshëm të ndiqet. Anëtarët e TND-së, të pranuar sipas nenit 29, të ligjit nr.152/2013, që ndjekin programin e formimit të thelluar, nuk i nënshtrohen testimit në përfundim të këtij programi.

4. Programi i formimit të thelluar zgjat 280 ore trajnimi dhe zhvillohet 2 (dy) ditë në javë. Ky program realizohet brenda 6 (gjashtë) muajve.

5. Trajnerët për programin e formimit të thelluar duhet të përmbushin kriteret e përmendura në pikën 3, të kreut 6, të këtij vendimi.

6. ASPA ofron program të formimit të thelluar dhe të vazhdueshëm, në baze të të cilit trajnohen në vazhdimësi dhe në lidhje me punën nëpunësit civilë të të gjitha kategorive, si dhe çdo individ tjetër jashtë këtij shërbimi, vendas ose i huaj.

a) Trajnimi i detyrueshëm gjate periudhës së provës, i përcaktuar në nenin 24, të ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil";

b) Trajnimi për zhvillimin e karrierës së nëpunësve të administratës publike dhe për përparimin në page;

c) Trajnimin për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës;

y) Trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta për nëpunësit e administratës publike.

7. Personat jashtë shërbimit civil që ndjekin programin e formimit të thelluar paguajnë për çdo ditë trajnimi 5,000 (pesë mijë) lekë.

8. Personat jashtë shërbimit civil që ndjekin programet e formimit të vazhdueshëm paguajnë 3 000 (tre mijë)- 7,000 (shtate mije) lekë për kurs trajnimi, në varësi të kohëzgjatjes së kursit.

9. Në programin e formimit të vazhdueshëm përfshihen:

10. ASP A ofron mundësinë e përgatitjes paraprake të kandidatëve për të marrë pjesë në konkurrimin e hapur për kategorinë ekzekutive, kundrejt tarifës prej 5 000 (pese mije) lekësh.

11. Kriteret dhe dokumentet e kërkuara për personat jashtë shërbimit civil, që dëshirojnë të ndjekin programet e ASPA-s, përcaktohen nga drejtori i ASPA-s dhe behën publike në faqen online të ASPA-s e të DAP-it.

SHTOJCA 2: STRUKTURA E KOMPETENCAVE PËR NIVELIN 5 APO TND

http://www.oecd.org/careers/competency_framework_en.pdf

Familja e Punëve

Klasifikimi i vendeve të punës në familje i lejon Organizatës të përcaktojë nëse zotëron aftësitë e nevojshme për të arritur ndikimin maksimal dhe të përcaktojë se ku janë të vendosura këto aftësi. Familjet e punës mund të përdoren për të përcaktuar kërkesat e punës në nivel të korporatës për punë të ngjashme, për të identifikuar përplasje dhe ura të mundshme për lëvizjen e brendshme, për të siguruar mundësi për të mësuarit e korporatave, dhe për të hartuar programe të strukturuar të zhvillimit të karrierës.

Në OBZHE, çdo punë përfshihet në një nga tri familjet e punës:

1. Udhëheqja Ekzekutive,
2. Politikat e Kërkimeve, Analiza dhe Këshilla,
3. Menaxhimi i Përbashkët dhe Administrimi.

Udhëheqja Ekzekutive

Punët në këtë familje përfshijnë hartimin, udhëheqjen dhe drejtimin e OBZHE- së dhe të punonjësve të saj për të arritur objektivat strategjike.

pozicionet tipike të punës në këtë familje përfshijnë Drejtorin, Zëvendës Drejtorin, Shefin e Divizionit dhe Këshilltarin.

Politikat e Kërkimeve, Analiza dhe Këshilla

Punët në këtë familje janë të përfshira direkt në analizat e politikave që prodhojnë rezultatet kryesore, të cilat mbështesin OBZHE- në në arritjen e objektivave të saj strategjike.

Pozicionet tipike të punës në këtë familje janë Ekonomistët, Analistët Politikë dhe Staticienët.

Menaxhimi i përbashkët dhe Administrimi

Punët në këtë familje menaxhojnë aktivitetet korporative të OBZHE-së në mbështetje të prodhimit efikas dhe efektiv, dhe të shpërndarjes së produkteve afat- shkurtër. Punët në këtë familje grupohen së bashku nën kategoritë e mëposhtme:

- Komunikimi (p.sh. Asistentët e Komunikimit, Menaxherët e Marketingut)
- Financa (p.sh. Asistentët e Financës, Menaxherët e Financës)
- Menaxhimi i Përgjithshëm dhe Administrimi (p.sh. Sekretaret/ Asistentet, Këshilltarët e Menaxhimit të Burimeve)
- Burimet Njerëzore (p.sh. Specialistët e BNJ, këshilltarët e BNJ)
- Teknologjia e Informacionit (p.sh. Asistent IT, Analist i Aplikacioneve)
- Shërbimet e Gjuhës (p.sh. Përkthyesit dhe Interpretuesit)
- Funksione Ligjore (p.sh. Avokatët)
- Shërbimet dhe Operacionet (p.sh. Specialistët e Logjistikës, Dokumentuesit dhe Menaxherët e Sigurisë)

Kompetencat Teknike

Kompetencat specifike zakonisht duhet të kryejnë një punë të caktuar në një prej familjeve të punës. Këto njihen gjithashtu si kompetenca teknike. Kompetencat teknike mbulojnë fusha të ndryshme të ekspertizës, të përshtatshme për punën e zbatuar në OBZHE. Kompetencat teknike janë në zemër të asaj që ne bëjmë. Kërkesat për kompetencat teknike për të kryer me sukses një punë të caktuar, janë të shpallura në lajmërimet e punës.

Kompetencat Thelbësore

Kompetencat thelbësore përmbledhin aftësitë që janë të rëndësishme në të gjitha punët dhe që ne besojmë në mënyrë kolektive se ato kontribuojnë në suksesin e përgjithshëm të OBZHE-së. Në të njëjtën kohë, rëndësia e kompetencave thelbësore mund të ndryshojë sipas detyrave specifike të punës dhe kërkesat.

Struktura e Kompetencave të OBZHE- se shfaq pesëmbëdhjetë Kompetenca Thelbësore të klasifikuara në tre grupe.

Klasifikimi blu grupon kompetencat e shpërndarjes

Klasifikimi lejla grupon kompetencat ndër- personale

Klasifikimi jeshil lidhet me kompetencat strategjike

Çdo nivel i kompetencave thelbësore ka tregues të sjelljes që shprehin/ theksojnë si një individ mund të paraqes këtë kompetencë. Treguesit e sjelljes janë të hartuar për të treguar kërkesat për një performancë të suksesshme.

Niveli 5 është i lidhur me punë të tilla si ato të Titullarëve të Departamentit, Këshilltarëve, Zëvendës Drejtorët dhe Drejtorët.

Të menduarit në mënyrë analitike

- Është kërkuar nga palë të tjera të ofrohen këshilla dhe zgjidhje mbi mënyrën më të mirë të interpretimit dhe përdorimit të informacionit.

- Dallimi I nivelit të presionit apo ndikimit të aplikuar në çdo aspekt të analizës, në lidhje me një kontekst më të gjerë.

Fokusi I Arritjeve

- Vlerëson punën në grup kundër qëllimeve dhe identifikon fushat për përmirësim.

- Përkthen mundësitë e biznesit në masa konkrete që janë të dobishme për Organizatën.

- Guxon të ndërmarrë rreziqe të llogaritura në mënyrë që të zhvillohet biznesi në mënyrë pozitive.

Hartimi i Aftësive

- Merret me krijimin e komunikimit strategjik të shkruar për Organizatën.

- Shqyrton punë komplekse dhe / ose të ndjeshme për të kryer identifikimin e ndikimit për Organizatën.

Të menduarit Fleksibël

- Është intelektualisht i shkathët në përgjigje të sfidave të brendshme dhe të atyre të jashtme.

- Kërkon ide dhe përgjigjet pozitivisht ndaj personelit, komisioneve dhe

Sekretarit të Përgjithshëm.

Burimet Menaxheriale

- Vendos dhe përcakton prioritetet dhe riorganizon personelin për të rritur kapacitetin e reagimit të grupit të brendshëm dhe kërkesave të jashtme.
- Vlerëson ndikimin financiar të vendimeve dhe zhvillon strategji për të adresuar çështjet e burimeve financiare.

Puna në Grup dhe Udhëheqja

- Bën detyrat e ekipit brenda dhe jashtë Departamentit / Drejtorisë për të lehtësuar punën horizontale.
- Deleton autoritet që të eci sipas përgjegjësi, dhe ka punonjës të përgjegjshëm për të rënë dakord për angazhimet.
- I përfshin të tjerët në mënyrë të përshtatshme në vendimet dhe planet që do ndikojnë ata.
- Promovon moral grupi dhe produktivitet duke qenë i qartë mbi rezultatet dhe pritshmëritë.
- Sheh konflikt që lind dhe ndërmerr veprime për Departamentin/ Drejtorinë / Organizatën.

Fokusi ndaj Klientit

- Ndërton besimin e klientit duke përdorur reputacionin e vet personal në komunitetin dhe ekspertizën ndërkombëtare.
- Di kur është e përshtatshme për të nxitur klientët të marrin në

konsideratë çështje të vështira dhe vepron në përputhje me rrethanat.

- Përcakton drejtimin strategjik dhe mundësitë afatgjata për të përmbushur nevojat e klientit, të cilat janë në zhvillim e sipër.
- Monitoron, vlerëson dhe, sipas nevojës, rinovon modeli e shërbimit ndaj klientit dhe standardet e shërbimit.

Ndjeshmëria Diplomatike

- Trajton një rast taktikisht, sidomos kur bashkëpunon me nivelin e lartë të zyrtarëve të Qeverisë.
- Di kur të mbajë qëndrim dhe kur të akomodojë.

• Dëgjon dhe kupton në mënyrë të përshtatshme mendime apo ndjenja të pathëna të të tjerëve dhe vepron ashtu siç e kërkon situata.

Influencimi

- Menaxhon çështje të komunikimit strategjik për organizatën, në situata me ekspozim të lartë.
- Menaxhon pyetje të vështira mbi pika të qarta (p.sh. Nga ekzekutivët e lartë, punonjësit publik, grupe interesi, apo media).
- Paraprin dhe ndërton ndaj veprimeve të të tjerëve për të mbajtur dhe për të mbështetur një qasje.
- Përdor ekspertë apo palë të tjera për të influencuar (p.sh. Ndërmerr disa veprime në të njëjtën kohë për të paraqitur argument, mbledh koalicionet politike, ndërton skenarë paraprakisht për të mbështetur idetë.

- Kryen veprime që lenë impakt për të fituar një argument apo për të arritur një marrëveshje.

Negocimi

- Punon në mënyrë konstruktive drejt një zgjidhje të favorshme gjatë negociatave.
- Hulumton zgjidhje kreative me të tjerët për të kapërcyer antagonizëm dhe për të zhvilluar partneritete.
- Udhëheq me sukses negociatat me impakt të lartë sipas parimeve të forta.
- Tregon më shumë se një stil të preferuar për negociata (p.sh. konkurruese, bashkëpunuese, duke shmangur, kompromis, akomodim) dhe përshtatet në varësi të homologut dhe kontekstit.
- Tregon aftësi për të bërë një hap mbrapa në procesin e negociatave, kur është e nevojshme, por duke qëndruar i fokusuar te objektivi.

Njohuria Organizative

- Përdor njohuri mbi politikat e korporatave në menaxhimin e situatave komplekse në mënyrë efektive dhe me maturi.
- Kupton natyrën dhe kufijtë e organizatave respektive dhe agjencive qeveritare, dhe e përdor atë njohuri për të ndikuar dhe për të udhëhequr.
- Merr pronësinë e pajtueshmërisë dhe çështjeve etike dhe të tjera, për të mbrojtur reputacionin e Organizatës dhe për të respektuar detyrimet e saj.

Zhvillimi i Talentit

- Deleton autoritet dhe përgjegjësi në kapacitetin e kryerjes së një detyre sipas mënyrës personale të një punonjësi dhe inkurajon të tjerët të udhëheqin dhe të mësojnë aftësi të reja.
- Promovon ndarjen e ekspertizës dhe mbështet mundësitë e mësimin midis Departamenteve/Drejtorive/Organizatës.
- Zhvillon një kuptueshmëri të përbashkët dhe është transparent për potencialin e punonjësve dhe ndërmarrjen e përgjegjësive të reja nga ana e tyre.
- Vendos një shembull për zhvillimin e punonjësve në Departament/Drejtori/Organizatë.
- Inkurajon të tjerët të zhvillojnë punonjësit e tyre përmes dialogut të zhvillimit dhe planeve të veprimit.

Përputhja Organizative

- Përdor disa mjete për të komunikuar nevojat e Organizatës dhe drejtimet strategjike.
- Zhvillon një drejtim strategjik për një nga njësitë që lidh rolin e grupit të punës me suksesin e Organizatës.
- Siguron që iniciativat dhe prioritetet në një fushë të jenë të integruara me njëra tjetrën dhe në përputhje me prioritetet strategjike të një Organizate më të gjerë.
- Organizon njerëz, procese dhe struktura në përputhje me drejtimin strategjik dhe nevojat Organizative.

Bashkëpunim Strategjik (Network)

- Menaxhon marrëdhëniet ndërmjet organizatave të rëndësishme të jashtme dhe entitetet qeveritare për të krijuar mundësi të gjera.
- Përdor rrjete të marrëdhënieve, që tashmë janë të themeluara, për të kërkuar informacion me rëndësi strategjike dhe për të siguruar një pozitë me influencë në forumet kyçe.

Mendimi Strategjik

- Kupton pozitën e OBZHE-së, në kontekstin e gjerë botëror; përcjell një kuptim të plotë të pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve; të Organizatës / Drejtorisë/ Departamentit, identifikon gjithashtu edhe pikat e forta që bëjnë diferencimin nga konkurrentët.
- Merr në konsideratë një pamje të madhe ndërkohë që vendos prioritetet dhe rrugën që do të ndërmerret.

SHTOJCA 3: NJË RAST STUDIMOR MBI METODOLOGJINË BAZUAR NË RASTE REALE

Disa element pedagogjik të kontekstit:

Normalisht, njohuria dhe kultura duhet të fitohen në universitet dhe në institutet kërkimore, aftësitë profesionale janë fituar në shkolla të specializuara teknike ose profesionale në nivelin e menaxhimit të mesëm dhe aftësitë e përgjithshme të menaxhimit më të lartë janë zhvilluar, forcuar dhe ushtruar dhe "shkolla praktike" si Shkolla Kombëtare e Administratës Publike (ENA) në Francë. Në Shqipëri, Shkolla e krijuar së fundmi për Administratën Publike, ASPA, ka për qëllim ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme për të gjitha kategoritë e nëpunësve

civilë. Kursi hyrës është një kurs i përgjithshëm që synon trajnimin e vazhdueshëm të nëpunësve civilë në nivel specialisti. Plani i Trajnimit për TND- të ka për qëllim drejtuesit e të lartë dhe zyrtarë që kanë potencial për t'u bërë TND në të ardhmen e mundshme, të përzgjedhur për aftësitë e tyre.

Ka dy metoda për trajnimin e nëpunësve të lartë në shërbimin civil:

1. Mësimi tradicional apo leksioni që ka të bëjë me kurse në të cilin "mësuesi" "jep mësim", duke dhënë një mesazh akademik të pavarur mesazh akademik- përmbytja, njohuria për t'u lexuar dhe mbajtur mend, të cilat mund të dorëzohen për grupe të mëdha në audiencës, nxënësit duke qenë pasiv, duke dëgjuar dhe duke mbajtur shënime, dhe vetëm në gjendje për të bërë pyetje për të sqaruar pika të ndryshme, debate që kufizohen nga numri i pjesëmarrësve;

2. Trajnimi profesional është privilegj për klasa të vogla, workshop-e, seminare, dorëzohet "me" (dhe jo "për ") grupe të vogla (jo më shumë se 25, më pak nëse është e mundur), gjatë së cilës nxënësit janë aktive: trajnuesi jep një informacion të shkurtër, mesazhe përshkruese dhe ngre pyetje, jep detyra dhe normalisht tërhiqet mbrapa duke i dhënë fjalën nxënësve / kursantëve.

Tabelë Krahasuese Mësimi / Trajnimi ndryshimet:

Mësimi	Trajnimi
AKADEMIK	PROFESIONAL
Njohuria për Administratën Publike	Kapacitet administrative dhe njohuria për ta aplikuar
Marrëdhënie Mësues/nxënës	Trajnues/i trajnuar- marrëdhënie e të mësuarit

Proces i njëanshëm	Proces i dy- anshëm ose i disa-anshëm
Pasiv / marrës	Aktiv/ prodhues
Dhënia e një produkti, të bërë gati, të përgatitur paraprakisht, i njëjtë për të gjithë	Transferim dhe pjesëmarrje në një proces krijimi të përshtatur, prodhim individual i rregulluar
Teori, Më tepër teorik	Praktikë, Më tepër praktik
Drejt rregullave universale, kërkim i modeleve	Me përjashtime, unike, shembuj real
Normalisht "perfekt", teorema në punë, rregulla pa përjashtime, et. Produkt i tipit "matematikor"	Me të gjitha im- perfeksionet e jetës reale, përjashtimet, prodhim i llojit "fizik"
Ligji, rregullorja, rregulli	Rasti i veçantë
Universiteti	ENA dhe Shkolla Kombëtare e Administratës Publike

Kjo tabelë na mundëson që të kuptojmë pse disa "studentë" nga ENA ndonjëherë thonë: "Në ENA, ne mësojmë asgjë". Nga njëra anë, kjo është e vërtetë. ENA nuk supozohet të mësojë njohuri të tipit akademik. Ajo u themelua në vitin 1945 nga gjenerali De Gaulle si një "shkollë e aplikuar" ose "shkolla për aplikim".

I diplomuari i ardhshëm është menduar të hyjë në këtë shkollë me njohuritë e nevojshme në mënyrë që të mësojë se si të përdori këto njohuri dhe si t'i transformojë këtë njohuri teorike në aftësi praktike. Në mënyrë që kjo të ndodh, d.m.th. të mësojnë se si të behet e mundur që të përdoren njohuritë e dikujt në kontekstin profesional ose jetën reale, ekzistojnë dy metoda:

1. *Periudha e trajnimit* DUKE BËRË atë gjë që nevojitet në një administratë dhe duke eksperimentuar dhe testuar njohurinë e dikujt me kërkesat dhe nevojat e veprimeve reale;

2. *Punimi me rastet studimore*, p.sh. Të bëjmë sikur jemi në atë situatë konkrete/ reale.

Në ENA të dyja metodat janë përdorur me sukses:

1. Së pari, periudhat e trajnimit kur mund të vlerësohet realisht niveli i njohurive akademike dhe aftësia për t'i "asimiluar" këto njohuri dhe për t'i bërë ato "të përdorshme" profesionalisht, për të parë gjithashtu dhe nëse i "trajnuari i ENA-s" është në gjendje për të analizuar problemet reale dhe për të transformuar njohuritë e tij/saj në mjetet e punës;

2. Gjithashtu, klasat e zhvilluara kryesisht janë të bazuar në workshop-e që përdorin raste studimore, me disa plotësime teorike nëse është e nevojshme, kur një çështje e re shfaqet.

Rastet Studimore janë të përdorura si nëpër universitete, por gjithashtu edhe në një shkollë si ENA edhe pse ndryshojnë në dy pika: rastet studimore janë me natyrë të ndryshme dhe normalisht përdoren në mënyrë të ndryshme.

1. Në një universitet të llojit të mësimdhënies, një rast studimor do të përdorej në mënyrë që të ilustronte apo të paraqiste një teoremë apo rregull të shpjeguar. Kjo mundëson studentin të mësojë si mësuesi/ profesori ka arritur në zgjidhjen e problemit të ngritur nga rasti studimor dhe si ky rast paraqet lëndën kryesore që është prezantuar në kurs/ leksion apo që është paraqitur si një përjashtim, dhe pse. Rasti Studimor Akademik shërben si një ushtrim për të mësuar si gjërat funksionojnë dhe për të mbajtur mend një rast. Ky është një mjet studimor i përshtatshëm dhe i fuqishëm. Ai mund të përdoret gjithashtu si një mjet testimi në kontekstin akademik dhe profesional (shiko më poshtë).

2. Përdorimi profesional i rastit studimor ka mjaft ndryshim në objektivat dhe përdorimin e tij. Rasti Studimor përdoret për të testuar aftësitë e atij që mëson për të zgjidhur një lloj problemi administrative nga një situatë reale dhe- gjatë procesit të zgjidhjes së problemit –personi që mëson do të mësojë gjithashtu si do të zgjidh një rast të tillë: Ky është një proces mësimi duke e praktikuar (learning-by-doing).

Ndryshimet mund të përmbliken në tabelën krahasuese si më poshtë:

Raste Studimore të Llojit universitar	Rast Studimor i Trajnimit Profesional
MËSIM AKADEMIK	TRAJNIMI PROFESIONAL
<p>Objektivi nuk është zgjidhja e një problem të ri real, por të mësohet një mekanizëm teorik, automatizimi dhe metodat që çojnë në zgjidhjen e problemit.</p> <p>Kështu që, mësuesit shpresojnë që studentët do të jenë në gjendje të aplikojnë apo përshtatin njohuritë e tyre në të gjitha problemet që do të hasin gjatë jetës së tyre profesionale apo personale</p>	<p>Objektivi është jeta reale profesionale, të zgjidhet një problem i ri, të kërkohen zgjidhje - dhe mund të ketë disa mundësi</p>
<p>Rastet studimore janë të vjetra, tradicionale dhe të përdorura nga gjenerata të shumta nxënësish/ studentësh,</p> <p>Nuk ka rëndësi nëse nuk janë të kohëve të fundit, ato mund t'i durojnë kohës,</p> <p>Ato kanë qenë duke u "pastruar" apo artificialisht "stabilizuara" / rishkruara</p>	<p>Rastet studimore duhet të jenë të kohëve të fundit- që të përditësoara shpesh,</p> <p>Duhet të ndiqen lajmet,</p> <p>Ato janë raste që nuk hyjnë në punë pas një kohe të shkurtër dhe që ndryshojnë shumë shpejt</p> <p>Në rast se përdoren sërish, duhet të përditësohen</p>

<p>Rastet studimore mund të printohen dhe të publikohen në libra</p>	<p>Rastet studimore janë të fotokopjuara dhe shpërndahen në mënyrë ad-hoc (p.sh. Produkte të reja, "më mirë se më parë...")</p>
<p>Mund të de- materializohen dhe të vendosen online</p>	<p>Mund të de- materializohen dhe të vendosen online</p>
<p>Produkte të Prodhuara, Rastet studimore mund të "përmirësohen" për të bërë "provat" / zgjidhjet më të dallueshme dhe të jenë pedagogjikisht më bindëse, por edhe më të lehta për të kujtuar; Ato nuk janë më materiale të vërteta, ato mund të thjeshtohen, rasti mund të bëhet më "i bukur" (p.sh. më i pastër)</p>	<p>Materiale të Papërpunuara, Për cilësinë më të mirë, dokumentet duhet të jenë të kohëve të fundit dhe të vërtetë, Dokumentet nuk duhet të ngatërrohen sepse realiteti nuk është ideal, por mund të jetë jo i plote, i pasaktë ose i tepërt, Komplexiteti i jetës së vërtetë dhe çrregullimi duhet të mbahen parasysht, në mënyrë që kandidati të mësojë se si të merret me të</p>
<p>Një mësues / profesor / shkrimtar kërkues/ autor, vetëm ose në një ekip, mund të prodhojë rastet një herë e përgjithmonë</p>	<p>Dokumentet duhet të mblidhen nga personi i cili, mënyrë profesionale, është me të vërtetë në krye të studimit / zgjidhjes së çështjes, Ato duhet të përditësohen në qoftë se mbahen për t'u përdorur përsëri</p>
<p>Rastet janë "të mbyllur", ka zgjidhje "ideale" dhe ato janë të gatshme</p> <p>Studentët duhet, zakonisht, të gjejnë zgjidhjen e propozuar për rastin</p>	<p>Rasti duhet të jetë "hapur", nuk ka përfunduar kur është studiuar Të trajnuarit duhet të jetë plotësisht e lirë të imagjinojnë zgjidhje, dhe zgjidhje të cilat mund të jenë krejt të ndryshme në bazë të grupeve të ndryshme</p>

<p>Kriteret e përzgjedhjes për rastin (objekti, çështje, problem, temë) duhet të analizohen me kujdes apo madje edhe të thjeshtëzohen në qoftë se kështu bëhen më të efikase pedagogjikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dokumentet përbërës të saj - Dhe si ato paraqiten: organizimi i sekuencave / tabela e përmbajtjes, struktura e rastit (renditja e dokumenteve), - Cilësia e shfaqjes, - Perfeksioni i metodave dhe mjeteve për të zhvilluar zgjidhjen, - "bukuria" e rastit (në gjuhën Frënge "c'est un beau cas d'école", ku çdo gjë është aty ku duhet), një mister me të gjitha pjesët e saj të përshtatura në mënyrë të përkryer, një arkitekturë klasike, e rregullt dhe e bukur 	<p>Kriteret e përzgjedhjes për rastin (objekti, tema, çështje, problem), dokumentet e saj përbërëse dhe se si ato paraqiten vlera / rëndësia:</p> <ul style="list-style-type: none"> - origjinaliteti, vërtetësia, - vështrësia, Kompleksiteti praktik <p>Rasti dhe dokumentet duhet të korrespondojnë me nevojat reale për trajnim, të fokusuara në njohuritë e vërteta dhe <i>know-how</i> boshllëqet e të trajnuarve. Mund të ketë mungesa në pjesë, arkitektura mund të jetë pak më vështirë-si në jetën reale!</p>
<p>Rritja e njohurive / masa e kontributit "të thithur" mund të matet në mënyrë sasiore dhe madje mund të testohet me një provim (me shkrim dhe / ose me gojë) me një para / pas testim</p>	<p>Rritja e kapaciteteve administrative duhet të jetë profesionalisht e matshme, d.m.th. në një situatë profesionale: i trajnuari e di si duhet bërë diçka ose nuk e di, ai / ajo ka fituar kualifikimin profesional ... ose jo!</p>
<p>Trajnuesi mund të jetë një profesor universitar / pedagog - që nuk e ka bërë kurrë diçka të tillë konkretisht si nëpunës civil profesionist në administratë, por duke e mësuar dhe analizuar atë - dhe çdo njëri mund të përdori këto raste</p>	<p>Trajnuesi duhet të jetë një profesionist, nëse është e mundur një person i ngarkuar me rastin, në administratën e tij/saj ose shumë mirë i informuar në lidhje me rastin nga ana e personit të ngarkuar nëse janë në të njëjtin grup pune, një "i brendshëm"</p>

SHTOJCA 4: RAPORTI I OSBE-SË MBI TRAJNIMIN ANTI-KORRUPSION PËR AP

Vlerësimi i Trajnimit Anti-Korrupsion Ekzistues për Administratën Publike Shqiptare dhe Kuadri për Propozimin e një Programi të Ri të Trajnimit të Anti-Korrupsionit, Modulet e Trajnimit për Zyrtarët e Nivelit të Lartë (fq. 16-18) ⁶¹

Moduli 7: Konflikti i Interesit

Moduli duhet të fokusohet në përcaktimin e konfliktit të interesave, parandalimin dhe rregullat që duhen ndjekur në rastet e konfliktit të interesave. Leksionet duhet të përfshijnë përpunimin e dispozitave të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe shqyrtimin praktik të konceptit. Diskutimet mbi konfliktin e interesave duhet të fokusohen jo vetëm në aspektet teorike që lidhen me interesat konkurruese, por edhe në zbatimin praktik të rregullave dhe politikave, duke përfshirë rryshfetit dhe pasurimin e paligjshëm. Edhe pse konflikti i interesit prek një spektër të gjerë, kursi duhet të jetë i hartuar kryesisht për të punësuarit në nivel vendimmarrjeje, pas përcaktimeve të parashikuara në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave.

Pjesëmarrësit: Zyrtarë të nivelit të lartë drejtues, Specialist të Burimeve Njerëzore

Kohëzgjatja: 1 ditë

Moduli 8: Vlerësimi i Riskut të Korrupsionit

Moduli për vlerësimin e rrezikut anti-korrupsion duhet të sigurohet për menaxherët e niveleve më të larta dhe mbikëqyrësit në nivel qendror dhe vendor. Gjithashtu, ky modul duhet të sigurojë trajnim mbi teknikat për

⁶¹ http://openaid.esteri.it/media/documents/1.Final_assesment_report_for_ASPA_.pdf

identifikimin dhe mundësitë për shkelje, por edhe ndikimin që kjo shkelje mund të shkaktoj. Kjo do të përfshijë analizën e shkaqeve të korrupsionit në nivele mikro dhe makro, si edhe qëndrimeve, presioneve, tundimet, shkaqeve kulturore, apo dhe çështjeve që lidhen me mosrespektimin apo dështimin e strategjive dhe politikave kundra korrupsionit. Trajnimet mbi vlerësimin e riskut zakonisht janë të bazuara në diskutime në grup. Një manual vlerësimi i riskut është përgatitur nga Projekti i BE-së / KE kundër Korrupsionit në Shqipëri (PACA) dhe mund të shërbejë si bazë për informacionin e këtij kursi. Ashtu siç argumentohet shpesh, shumë prej rreziqeve të anti- korrupsion kanë natyrë "lokale". Kështu që, duhet të ndërtohet një modul i veçantë për vlerësimin e riskut për punonjësit e qeverisjes vendore i projektuar në bazë të nevojave specifike për parandalimin e korrupsionit dhe analizën e riskut në nivelin e qeverisjes vendore.

Pjesëmarrësit: Zyrtarë të nivelit mbikëqyrës dhe njësitë qendrore të Anti-Korrupsionit

Kohëzgjatja: 1-2 ditë

Moduli 9: Trajnimi i Anti-korrupsionit për Zyrtarët Politik dhe Tjerë

Ndërsa është e qartë se ASPA nuk ka mandat për të trajnuar zyrtarët politikë, ata mund të marrin në konsideratë koordinimin e trajnimeve me zyrtarët e duhur të lartë dhe ata jashtë administratës publike, si zyrtarë të emëruar politikë dhe ndoshta prokurorë dhe gjyqtarë për të marrë trajnimet e duhura të specializuara. Këto trajnime duhet të kryhen në mënyrë të pavarur nga të tjerët për të siguruar një perspektivë të udhëheqjes për zyrtarët e lartë apo trajnime të orientuara në mënyrë të veçantë ndaj atyre që janë përfshirë me aktivitetet gjyqësore dhe që nuk janë pjesë e administratës publike. Materialet e zhvilluara për trajnimet e tanishme të ASPA-s për pjesëtar të administratës publike mund të japin

informacion për të edukuar edhe udhëheqësit politik.

Pjesëmarrësit: Zyrtarë të zgjedhur dhe zyrtarë jashtë Administratës Publike

Kohëzgjatja: 1-2 ditë

Moduli 10: Trajnimi i Anti-korrupsionit për pikat kyçe të lidhura me zbatimin e Strategjisë të Anti- korrupsionit dhe planit të saj të veprimit

Trajnimi duhet të fokusohet në politikatat anti-korrupsion, me fokus Strategjinë e Anti-korrupsionit, e cila do të jetë zbatuar nga Qeveria deri në kohën e zbatimit të programit të ri të trajnimit. Trajnimi duhet të jetë i projektuar për administratorët, duke synuar dhe për të vlerësuar rreziqet e korrupsionit në institucionet e tyre përkatëse, por gjithashtu dhe të kenë kuptueshmërinë themelore për të zhvilluar një plan veprimi që adreson detyra ndaj anti-korrupsionit dhe masat e bazuara në Strategjinë Kombëtare të Anti-korrupsionit. Trajnimi duhet të ofrojë udhëzime për zyrtarët publikë që ata mund t' i aplikojnë ato në institucionet e tyre përkatëse. Gjithashtu trajnimi synon si edhe t'i këshillojë ata mbi veprime të mundshme që mund të merren referuar fenomenit.

Lexime paraprake për pika kyçe në lidhje me korrupsionin:

1. Ligji nr. 152/2013 "Civil", i ndryshuar
2. Ligji nr.90/2012 "Mbi Organizimin dhe Funkzionimin e Administratës Publike"
3. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"
4. Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 "Mbi Rregullat e Etikës në Administratën Publike"
5. Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 "Mbi parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar

6. Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
7. VKM nr. 142, datë 12.3.2014 "Mbi përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës ne institucionet e administratës publike dhe në institucionet e pavarura.

Lexime të mëtejshme nga Strategjia Kombëtare e Reformës së MFP-së, faqja 12:

Qeveria Shqiptare është duke përgatitur një Strategji Kombëtare mbi Luftën Kundër Korrupsionit.

Strategjia do të bazohet në tre komponentë kryesore (1) rritja e ndërgjegjësimit (2) parandalimi, dhe (3) dënimi.

Strategjia Anti-Korrupsion do të përfshijë iniciativa dhe masat për:

- Përmirësimin e aksesit të qytetarëve në informacion
- Përmirësimin e komunikimit publik dhe konsultimit me publikun në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve rregullatorë (ligje, vendime etj.);
- Rritjen e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe auditimin e fondeve të buxhetit;
- Rishikimin dhe përmirësimin e sistemit dhe mekanizmave për ankesat e publikut;
- Përmirësimin e efikasitetit të auditimit të brendshëm dhe inspektimit;
- Legjislacion jo-korruptiv;
- Përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të investigimeve penale mbi krimet ekonomike dhe financiare (korrupsioni); Përmirësimin e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor ndërkombëtar në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar;
- Nxitjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile për projektimin, zbatimin dhe monitorimin e masave kundër korrupsionit.

SHTOJCA 5: LEXIME TË MËTEJSHME MBI MONITORIMIN DHE ZHVILLIMIN NË KARRIERË

Vlerësimi i Performancës dhe Zhvillimi

Vlerësimi i Performancës së Drejtuesve të Nivelit të Lartë përfshin vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kolektive dhe individuale të vendosura në fund të vitit x-1 për vitin x dhe gjithashtu aftësitë menaxheriale të drejtuesve të nivelit të lartë, nga një rrjet i përbashkët. Vlerësimi duhet të përcaktojë performancën e vitit të kaluar dhe të përcaktojë objektiva për vitin e ardhshëm në aspektin operacional. Ajo gjithashtu duhet të diskutojë nevojën për trajnim ose masat mbështetëse të personalizuar që do të jenë të nevojshme.

Programe Shoqëruese për fuqizimin e aftësive të TND-së:

- Seminare të nivelit të lartë për t'u mundësuar atyre fuqizimin e aftësive të tyre, si në aspektin e ekspertizës profesionale dhe në aspektin e aftësive menaxheriale
- Një Klub i Drejtuesve të Nivelit të Lartë, përtej rrjeteve të ndryshme profesionale që tashmë ekzistojnë, për të krahasuar rregullisht praktikat e tyre me personalitete nga jashtë. Ky Klub i TND-ve mund të udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë, me mbështetjen e DAP-it dhe ASPA-s.
- Mënyra të tjera të veçanta të zhvillimit, të tilla si ndihma e një eksperti këshilltar, stërvitja, programe specifike trajnimi, vizita në ministrinë e njëri-tjetrit, vizita studimore jashtë vendit (TAIEX).

Faktorët Kyç të Suksesit dhe rekomandimet: «Një udhëheqës i vërtetë nuk ka nevojë të drejtjohë. Ai duhet vetëm të tregojë rrugën». Henry Miller

Trajnimi mbi Udhëheqjen është shumë më tepër se një kuti me mjete menaxheriale. Do të ishte gabim nëse do të zhvilloheshin vetëm teknikat dhe proceset, në vend që të punohej në fusha më të ndërlikuara ku marrëdhëniet dhe emocionet zënë vendin e tyre. Në qoftë se udhëheqja perceptohet si drejtimi i të tjerëve, çështja e drejtimit që duhet ndjekur mbetet plotësisht e ngritur.

Një Shkollë e Administratës Publike mban vetëm përgjegjësinë e ofrimit nëpërmjet trajnimit të pikave kyçe të udhëheqjes efektive për Menaxherët e Drejtimit të Lartë, apo duhet edhe të përfshihen në (ri) mendimin e rolit të Shtetit dhe evoluimit të tij? (pyetje që kërkon përgjigje)

Një artikullim i trefishtë arsimor është sugjeruar fuqimisht - konsultimi, trajnimi dhe ushtrimi - projektuar për të ndihmuar TND-të të zhvillojnë strategji optimale për zhvillimin e menaxhimit dhe mbështetjen në zbatimin e tyre.

1. Këshillimi mund të adresohet përmes të menduarit strategjik dhe vlerësimit menaxherial në workshop. Çdo pjesëmarrës duhet të ketë mundësinë për të realizuar, gjatë një dite, një Vlerësim të Personalizuar Menaxherial, për të synuar më qartë aftësitë që kanë nevojë për përmirësim. Gjithashtu, një strategji e personalizuar mund të zhvillohet duke integruar rregulla të reja menaxheriale, praktika inovative të menaxhimit për të maksimizuar menaxhimin e aftësive kolektive dhe individuale brenda ekipit.

2. Faza e trajnimit duhet të ndërtohet nëpërmjet një «trajnimi ndërveprues» qasje kjo që lejon pjesëmarrësit të pozicionohen në një

rol drejtues, për të zhvilluar strategji për menaxhimin e krizës, ose për të vendosur risi në zemër të dinamikës ekipit.

3. Një ushtrim/ praktik mbi zhvillimin e aftësive dhe menaxhimin e ndryshimit duhet të zbatohet brenda ASPA-s në mënyrë që të jenë në gjendje t'ju sigurojnë menaxherëve mbështetjen e nevojshme gjatë fazës së konsolidimit të qëndrimeve të reja menaxheriale nga Drejtuesit e Nivelit të Lartë në administratën publike shqiptare.

Këto përshkrime të hollësishme do t'i lejojnë ASPA-s dhe DAP të kontribuojnë në një rikrijim të administratës shqiptare dhe në rritjen e një kulture të përbashkët të udhëheqjes në shërbimin publik shqiptar nëpërmjet zhvillimit të një «elitë të trajnuar mirë», të një grupi të nëpunësve publikë që do të drejtojnë procesin e Aderimit, duke negociuar dhe zbatuar kërkesat ligjore të BE-së.

SHTOJCA 6: RAPORTI PNUD 2016- INTEGRIMI GJINOR DHE TRAJNIMI I TND-VE

Shtojca 1: Ekstrakt Përmbledhës mbi Mangësitë Gjinore të Identifikuara dhe Rekomandimet e Propozuara për Projekt Programin e Trajnimeve për Administratën Publike

Module didaktike, njësi dhe përmbajtje për t'u zhvilluar dhe përfshirë.

Në lidhje me përmbajtjen e trajnimeve

- Udhëzimet mbi trajnimin dhe vlerësimin ndaj çështjeve gjinore të ndjeshme do të zhvillohen dhe do të shpërmdahen te të gjithë trajnuesit/ trajnerët e ASPA-s. Ato do të përfshijnë aspektet e mëposhtme: Barazia

gjinore, integrimin gjinor, si për të vlerësuar kapacitetet gjinore për integrim; si për të përfshirë çështjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme, etj.

Moduli i Përditësuar i Trajnimit Gjinor në fazën e Induksionit duhet të përfshijë përmbajtjen si më poshtë:

- Barazia gjinore në punësim dhe të drejtat në punë në të gjitha nivelet e funksionimit të administratës publike.
- Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë, veprime pohuese.
- Përfshirja politike e grave, kuotat.
- Paga dhe trajtimi në punë i barabarta, masat për të luftuar diskriminimin me bazë gjinore në vendin e punës, ngacmimi seksual.
- Dhuna me bazë gjinore, seksuale dhe trafikimi i grave dhe shfrytëzimi seksual.
- Trajtim i barabartë në shërbime.
- Të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe statistikave gjinore.
- Të dhëna gjinore në kontekstin shqiptar.

Moduli i Përditësuar i Trajnimit Gjinor në fazën **hyrëse** do të përfshijë, përveç komponentëve në kuadër kombëtar tashmë të përfshirë (Ligji mbi Barazinë Gjinore, Ligji I Mos- Diskriminimit):

- Zhvillime të fundit në legjislacionin Shqiptar: *VKM Nr. 465 / 2012 "Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në buxhetin afat- mesëm"*, Strategjia e Barazisë Gjinore 2016-2020 (pasi është adoptuar).

Modulet e reja të trajnimit gjinor për zyrtarët ekzekutivë të nivelit të mesëm dhe menaxherët e nivelit të lartë të punonjësve të qeverisë qendrore:

Barazia gjinore në kontekstin e Zgjerimit të BE-së: *acquis* Barazia Gjinore e BE- së, *sidomos* në fushën e mos- diskriminimit:

1. Parimi i pagesës së barabartë dhe trajtim të barabartë në punë, duke përfshirë parandalimin e ngacmimit seksual dhe ngacmimi në bazë të gjinisë (Direktivat e BE- së 2006/54, 79/7, 92/85, 2010/18).

2. Parimi i trajtimit të barabartë në aksesin dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve (Direktiva e BE- së 2004/113)

3. Konventa e Stambollit dhe Direktivat e BE- së 2011/36, 2011/99, 2012/29 & Rregullorja (BE) Nr. 606/2013.

4. Plani i Veprimit Gjinor 2016-2020, Angazhimi Strategjik mbi Barazinë Gjinore 2016-2019, Projekti i Binjakëzimit mbi Integrimin Gjinor.

• Angazhimet Ndërkombëtare për Barazi Gjinore: CEDAË. SDG. UNSC Res 1325.

• Instrumentet dhe Mjetet për Programimin e Përgjegjshëm Gjinor, duke përfshirë Analiza Gjinore, vlerësimin e ndikimit gjinor, monitorim dhe vlerësim të çështjeve të ndjeshme gjinore, Makineria Gjinore, treguesve gjinorë, etj.

• Treguesit Gjinor Ndërkombëtar.

• Integrimi Gjinor në praktikë, me shembuj të aplikimeve në disa fusha (ekonomisë dhe tregtisë, drejtësisë, sigurisë, Transportit, etj.)

• Njësia për buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor duhet të zhvillohet si një njësi ose modul më vete (në varësi të kohës që kërkon një modul ose njësi). Për aq kohë sa është detyrim ligjor, ajo ka nevojë për një sesion të veçantë trajnimi.

Në Modulet e Planifikimit të Integruar Strategjik dhe Menaxhimit Strategjik:

• Njësi e veçantë për instrumente dhe mjete për programimin e përgjegjshmërisë Gjinore (shiko më sipër).

• Strategjia e Barazisë Gjinore 2016-2020 (pasi është adoptuar).

Në Modulet e Menaxhimit të Shpenzimeve Publike dhe Reforma në Menaxhimin e Financave Publike:

• Njësi e veçantë në Buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, *duke përfshirë metodologjinë e GRB dhe VKM nr. 465 të vitit 2012 të integritit gjinor në buxhetin afatmesëm.*

Në Modulet e Punësimit dhe Politikave Sociale dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

• Njësi specifike për Integrimin Gjinor, Punësimin dhe aftësitë, duke përfshirë përmbajtjen e mëposhtme:

1. Gjinia në Punësim.
2. Mos-Diskriminimi (direkt& jo direkt).
3. Pagë dhe trajtim i barabartë.
4. Paga/ Fitimet/ Hendeku i pensioneve.
5. Direktivat e BE- së 2006/54, 79/7, 92/85, 2010/18.
6. Ngacmimi seksual dhe ngacmime të tjera të bazuara në gjini.
7. Ligji Kombëtar kundra diskriminimit.
8. Treguesit kombëtar të punësimit të ndarë, profesioni dhe treguesit e aktivitetit.
9. Kodi Kombëtar I Punës.
10. Procedurat Administrative dhe Diskriminimi në ambientet e punës të bazuara në gjini.

Në Modulet e Integritit Evropian dhe strukturat euro-atlantike; Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, NATO:

• Barazia Gjinore në Kontekstin e Zgjerimit të BE- së: acquis i barazisë gjinore në BE, sidomos në fushën e mos- diskriminimit:

1. Parimi i pagesës së barabartë dhe trajtim të barabartë në punë, duke përfshirë parandalimin e ngacmimit seksual dhe ngacmimi në bazë të

gjinisë (Direktiva e BE- së 2006/54, 79/7, 92/85, 2010/18).

2. Parimi i një trajtimi të barabartë në aksesin dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve (Direktiva e BE- së 2004/113)

3. Konventa e Stambollit dhe Direktivat e BE- së 2011/36, 2011/99, 2012/29 & Rregullorja (BE) Nr. 606/2013 për parandalimin dhe eliminimin e DKG.

4. Plani i Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020, Angazhim Strategjik për Barazi Gjinore 2016-2019, Integrimi Gjinor IPA.

Në modulin e Bashkimit Evropian për Përfaqësuesit e Njësisë Vendore:

• Njësi mbi Instrumentet dhe Mjetet për programimin e Përgjegjshmërisë Gjinore, përfshirë Analizën e Gjinive, Vlerësimi i impaktit të gjinive, Vlerësimi dhe Monitorimi i çështjeve Gjinore Delikate, "Makineri Gjinore", treguesit gjinor, etj.

Njësi e Kartës Evropiane për Barazi midis femrave dhe meshkujve në jetën vendore.

Rekomandimet në lidhje me metodat e Trajnimit

Çështjet e ndjeshme gjinore kanë nevojë për vlerësim dhe pyetësorët vlerësues duhet të zhvillohen për të gjitha modulet. Ndërkohë, që module specifike që nuk kanë përmbajtje gjinore, duhet të jenë pjesë e kriterëve vlerësues.

Shtojca 2: Tabela Përmbledhëse mbi Vlerësimin e Barazisë Gjinore dhe Rekomandimet për kurrikulën e Trajnimit të Trupës të Nivelit të Lartë Drejtues në Administratën Publike Shqiptarë, ekstrakt i tabelës

Kodi dhe Emërtimi i Modullit	Kodi dhe Emërtimi i Kursit	Temat e Sugjeruara
TND ₁	1.4. Ligji Administrativ i BE- së	Tema 1: Procedurat Administrative dhe Barazia Gjinore në vendin e punës
Politikat e BE- së dhe Çështjet Ndërkombëtare	1.3. Politikat Sektoriale të BE- së	Tema 2: Karta e BE- së për barazinë midis burrave dhe grave në jetën vendore.
	1.2. Institucionet dhe Qeverisja e BE	Tema 3: Ligji Kombëtar për Barazi Gjinore dhe Strategjia për Barazi Gjinore
		Tema 4: Punësimi gjinor dhe të drejtat e mirëqenies sociale
		Tema 5: acquis Gjinor i BE- së (BGj në traktatet e BE- së)
Totali i Punës Progressive TND₁		
TND ₂	01. Menaxhimi i Ciklit të Politikave	Tema 6: Konceptet e BGj në kontekstin e Politikave Publike.
Planifikimi Strategjik dhe Formulimi i Politikave		Tema 7: Parimi i trajtimit të barabartë në aksesin ndaj mallrave dhe shërbimeve.
Totali i Punës Progressive TND₂		
TND ₃	01. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore Udhëheqja dhe Modernizimi i Menaxhimit Publik.	Tema 8: Integrimi gjinor në funksionimin e Administratës Publike
Kompetencat në Menaxhimin Strategjik dhe Operacional		Tema 9: Integrimi gjinor në menaxhimin e BNj në entitete publike.
	02.Menaxhimi i Konfliktit	Tema 10: Integrimi gjinor në Sistemin e Integruar të Planifikimit.
		Tema 11: Parandalimi, Reagimi ndaj Gjinisë dhe Fatkeqësitë
Totali i Punës Progressive TND₃		

Kodi dhe Emërtimi i Modullit	Kodi dhe Emërtimi i Kursit	Temat e Sugjeruara
TND4 Çështjet Financiare Publike	01. Menaxhimi Financiar Publik 03. Partneritete Publike-Private	Tema 12: Buxhetimi Gjinor i Përgjegjshëm Tema 13: Sfidat e Pronës Private Publike në bashkëpunim me vis-à-vis diskriminimin gjinor Tema 14: Barazia Gjinore vis-à-vis Etika në Komunikim
Totali i Punës Progressive TND4		
TND5 Inovacioni i Administratës	01.Qeverisja Elektronike 02. Mbrojtja e të Dhënave dhe Siguria e IT- së	Tema 15: Integrimi Gjinor në Qeverisjen Elektronike Tema 16: Integrimi Gjinor në Mbrojtjen e të Dhënave dhe Politikat e Sigurisë së IT- së
Totali i Punës Progressive TND5		
Ditë dhe orë shtesë në Total		

SHTOJCA 7: KAPITUJT E ACQUIS TË BE-SË

Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e të mirave materiale

Kapitulli 2: Liri në lëvizjen e fuqisë punëtore

Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Kapitulli 5: Prokurimi Publik

Kapitulli 6: Ligji i Biznesit

Kapitulli 7: Ligji mbi Pronën Intelektuale

Kapitulli 8: Politikat e Konkurrencës

Kapitulli 9: Shërbimet Financiare

Kapitulli 10: Shoqëria e Informacionit dhe Media

Kapitulli 11: Zhvillimi Bujqësor dhe Rural

